

**Marius DOBRESKU**

***E NJOH DHE E DUA KOSOVËN, NJËLLOJ SI SHQIPËRINË***



# NACIONALIZMI KULTUROR DHE INTERNACIONALIZMI KULTUROR

**Urrejtja e një cilësie, e një virtyti, e një suksesi, e një të arriture internacionale të një etnikumi, është, mbi të gjitha, problem shpirtëror që i përket sferës së psikiatrisë. Ndërsa, nëse kjo urrejtje kodifikohet dhe normatizohet në kushtetutë, atëherë kemi të bëjmë me një nacionalizëm kulturor të institucionalizuar**

Nga Avni HALIMI

Në Maqedoninë e Veriut ka kohë që funksionon një Shoqatë me emrin "Manifesti maqedonas", në të cilën aderohet shkrimtarë, poetë, piktorë, teologë, gjuhëtarë, gazetarë, madje edhe akademikë të profileve të ndryshëm! Nëse politikën nacionale të ish-kryeministrit Nikola Gruevski mëtonin antikizimin e popullit sllav maqedonas, kjo Shoqatë "intelektualësh" maqedonas (në bashkëpunim dhe koordinim me ish-kryeministrin) i ka vënë qëllim vetes për ta "hyznizuar" popullin e vet.

Kjo Shoqatë "intelektualësh" që program të veten e ka idealizimin e "popullit të shenjtë" dhe ofendimin, përçmimin dhe mohimin e autoktonisë së shqiptarëve të këtuashëm, deri më sot ka botuar lloj-lloj librash kundër BE-së, kundër NATO-s, kundër euro-integrimeve të Maqedonisë së Veriut, sepse Evropa dhe NATO qenkan aleatë të "shqiptarëve të mallkuar"! Deri më sot kanë publikuar dhjetëra "manifeste" - apele për ngritje në këmbë të popullit maqedonas për t'i luftuar të gjithë "projektet shqiptare" që kanë për qëllim rrënimin e unitaritetit të "shtetit maqedonas" dhe që nuk e pranojnë statusin e pakicës!

## Paçvurat që shiten si "manifest kombëtar"

Kjo Shoqatë "intelektualësh" ka pasur dhjetëra apele për ta ngritur popullin maqedonas në shkatërrim të tërë shtetit nëse arrihet zyrtarizimi i gjuhës shqipe, kjo gjuhë e "terroristëve" që në aleancë me shtetet evropiane dhe të NATO-s, më 2001 për një qime të kokës i shpëtuan shfarosjes totale nga ushtria maqedonase!

Shih për këtë, në prag të invazionit rus mbi Ukrainën, "Manifesti maqedonas" doli me një ultimatum të fundit që ua drejtoi instancave shtetërore, por edhe mbarë popullit maqedonas. Kërkuan prerazi: ushtria maqedonase jo të vihet në shërbim të NATO-s për të luftuar kundër popullit vëlla rus nëse vjen deri te ndonjë luftë në mes të Rusisë dhe Ukrainës! Për dy arsye: "populli rus dhe ai maqedonas janë i njëjti pip nga dega e trungut të popujve të botës dhe, e dyta, NATO i paska borxh shumë popullit maqedonas, meqë i paska ndihmuar "terroristët shqiptar" për ta nëpërkëmbur krenarinë dhe dinjitetin e këtij populli!

A nuk është kjo Shoqatë një "organizatë raciste" e cila, veç tjerash, shqiptarët i ka porositur ose të harrojnë gjuhën shqipe dhe ta idealizojë maqedonishten si gjuhë të shenjtë, ose, t'i lëshojnë "tokat maqedonase" dhe le të jetojnë atje ku do t'i lejojnë ta krijojnë shtetin e tyre! Kjo Shoqatë natë e ditë punon për t'i minuar të gjithë angazhimet dhe sukseset e arritura ndër-kombëtare për një stabilizim dhe paqe në vend e në rajon. Garancën e sigurisë e mori me inkuadrimin e shtetit në NATO, angazhim dhe kërkesë kjo permanente e të gjithë spektrit politik shqiptar në Maqedoninë e Veriut. Në ushtrinë e Maqedonisë ka edhe oficerë e ushtarë shqiptarë, të cilët jo vetëm që kanë nderin, por edhe ëndërrojnë që të jenë krah për krah me ushtrinë e NATO-s në luftë për të siguruar paqe dhe mirëqenie kudo në botë!

Nëse shqiptarët me insistimin e tyre për zyrtarizimin e gjuhës shqipe paskan



mëtuar "federalizimin e Maqedonisë", këta akademikë maqedonas, kjo "ajkë intelektuale" e popullit maqedonas, me kërkesën për fragmentarizëm pikërisht të faktorit më të rëndësishëm të një shteti, ushtrisë, a nuk është në fakt angazhim akademiko-politik për ta "federalizuar Maqedoninë"? Sepse, nuk ka fije dyshimi: shqiptarët gjithandej në botë e ndejnë për detyrim të shenjtë për të qenë krah për krah me NATO-n sa herë që do ta dojë nevoja! Ata që do të dëshirojnë që ta ndihmojnë "vëllain e madh" të tyre (Rusinë) - ja ku e kanë, le të shkojnë! Natyrisht, Rusia nuk ka nevojë për shoqata të këtuila pseudo-intelektualësh, nuk kanë nevojë as për ndihmën e tyre "ushtarake" dhe as akademike, thjesht, ata duhet ta ushqejnë urrejtjen antishqiptare dhe ta kryejnë detyrën që e kanë nga "vëllai i madh" - të provokojnë konflikt ndërretnik e ndërfeetar, sepse vetëm në situata të tilla do të mund të ndjehet prezenca dhe influenca politike ruse në vend dhe në rajon! A nuk është ky manifest idiotik i shoqatës së akademikëve dhe intelektualëve të diskutueshëm maqedonas?! Dhe, të të pëlçasë barku nga e keqja - asnjë intelektual, asnjë profesor, asnjë akademik shqiptar nuk e tha një fjalë kundër këtij "Manifesti" që vetëm maqedonas nuk mund të jetë, ndonëse flet në emër të maqedonizmit! Një "digë gjigante" para shtetit, i cili, përveçse që duhet t'i kryej obligimet dhe detyrat për t'u futur në familjen e madhe evropiane, gjithsesi që do të duhet ta dekonstrukttoj shpejt e qetë edhe këtë "digë" të stërm-bushur me llum e mbeturinash! Shqiptarët me gjithë kulturën e tyre janë realitet i pazhbërë në këtë nënqiell.

## Favorizimet dhe diskriminimi kulturor

Favorizimet kulturore janë dukuri që shprehen si pasojë e urdhrave politiko-partiake dhe të njëjtat mund të përjetojnë në Shqipëri dhe në Kosovë, pra në shtetet që drejtohen nga qeveritë shqiptare. Ministria e Kulturës, përveç që ka obligim të kujdeset për mbarrëvajtjen e punëve nëpër institucionet kombëtare kulturore, është e obliguar që në programin e vet nacional vjetor të përfshijë edhe organizata e shoqata që merren me aktivitete kulturore. Pa dyshim, edhe kulturën e kemi komercializuar deri në përmasa të "firmave fitimprurëse" dhe, fatkeqësisht, për këtë posh-

tërsi përkuajdesen partitë tona, pastaj individë nga legjislativi dhe ekzekutivi kombëtar, të cilët, gjejnë mënyra se si t'u dalin nga borxhi militantëve dhe përkuajdesë të vetë! Le të formohen sa më shumë shoqata e organizata, nga të gjitha fushat e kulturës se, fonde ka mjaftueshëm për të gjithë militantët! Kjo është logjika e diletantëve dhe snobëve që nuk dinë se si të dëshmojnë si "intelektualë" dhe "akademikë" të kombit! Jo gjithnjë ndahen të kënaqur të gjithë!

Që të gjitha organizatat dhe shoqatat varen nga koalicionet qeveritare! Në të dyja shtetet tona, ministrinë gjegjëse gjenden edhe nën presionin partiak të strukturave të ndryshme të pushtetit, por edhe nën presionin e favorizimeve të udhëheqësve (dhe komisioneve partiakë) të dikasterëve përkatëse. Si rrjedhojë e këtyre qëndrimeve imorale në raport me jetën kulturore, kemi subjekte e persona të favorizuar dhe, të tjerët, "të diskriminuar"! Këtu kemi ankesa e "protesta" nga ata që ngelin jashtë sferës së favorizimeve si pasojë e pozicionimit opozitar dhe, në raste të tilla, absolutisht nuk kemi kurrfarë "diskriminimi"! Jeta kulturore institucionale është në nivel dhe, përtej mundësive, subvencionohen edhe dy-tri e më shumë ansamble, shoqata, organizata, botues etj! Për ta kuptuar diskriminimin kulturor, mjafton që të hidhet një sy në viset e tjera etnike, te shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, të Luginës së Preshevës e të Malit të Zi! Çuditërisht, edhe nga

këto vise shpesh kemi dëgjuar "për diskriminime kulturore", dhe këta zëra nuk vijnë nga subjektet politike, nuk vijnë nga institucionet dhe asociacionet që e llogarisin veten si bartës të jetës kulturore shqiptare. Fatkeqësisht, konstatime të tilla faktike vijnë nga individë që përfaqësojnë një shtëpi botuese, nga ndonjë "ansambël", nga ndonjë shoqatë jo-fitimprurëse, nga artistë që, thjesht, kanë ngelur jashtë "tavolinës së kekut" kulturor! Të tjerët që kanë marrë ndonjë kockë sa për ta lëpirë, ndahen të kënaqur me politikën nacionale kulturore si të dikasterit gjegjës të qeverisë maqedonase, ashtu edhe të dikasterit kulturor qeveritar serb e malazez! Të pakënaqurit, nëse subvencionohen pas ndonjë ankese eventuale për diskriminim kulturor, shumë shpejt e harrojnë këtë diskriminim institucional!

Kjo lojë e ndyrë e artdashësve dhe

kulturodashësve si dhe mungesa e politikave të qarta kulturore që do të duhej të ishin diga të pakalueshme përgjatë formimit të koalicioneve qeveritare, na bëjnë të dukemi jo seriozë, qaramanë dhe politikisht të papjekur e të pangritur. Të hamë tortën e "Korridorit 8" e ta heshtim dhe ta fusim nën cergë tortën e turpit të gatuar me inferioritetin dhe diletantizmin tonë karshi jetës institucionale kulturore, kjo flet për një primitivizëm të llojit të vet! Pa dyshim, botës i duhen korridore e autostrada, por shqiptarëve të viseve etnike, mbi çdo gjë tjetër, i duhen institucione kulturore si dhe zhvillim të jetës kulturore institucionale. Diskriminimi kulturor shtetëror që i bëhet shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut, Luginës dhe Malit të Zi, nuk kompensohet me asnjë sukses në infrastrukturën rrugor. Për kulturën shqiptare nuk ka buxhet, sepse po e orientojmë në ndërtimin e infrastrukturës hekurudhore! Ndërsa institucionet nacionale kulturore të maqedonasve, të serbëve apo malazezëve, duhet të funksionojnë, sepse ato ekzistojnë, nuk guxojnë të mbyllën! Shkurt, mosfinancimi i një libri, mosfinancimi i një shfaqje, i një koncerti, i një ekspozite etj., nuk është diskriminim kulturor, por, thjesht, politikë favorizuese apo disfavorizuese subjektive e personave që drejtojnë ministrinë për kulturë. Financimet sporadike e të papërfillshme janë për do shqiptarë "të mirë" e "të ndershëm", ndërsa refuzimet e projekteve u bëhen do shqiptarëve opozitarë "që kanë tipare të njerëzve të egër e të këqij", ndonëse këta mund të jenë përfaqësues reprezentativ apo ajka e kulturës shqiptare në viset ku jetojnë! Mospasja dhe moszhvillimi institucionalisht i jetës kulturore shqiptare, ky po që është diskriminim politik shtetëror kundër kulturës nacionale të një etnie!

## Nacionalizmi kulturor i fotokopjuar

Urrejtja e një cilësie, e një virtyti, e një suksesi, e një të arriture internacionale të një etnikumi, është, mbi të gjitha, problem shpirtëror që i përket sferës së psikiatrisë. Ndërsa, nëse kjo urrejtje kodifikohet dhe normatizohet në kushtetutë, atëherë kemi të bëjmë me një nacionalizëm kulturor të institucionalizuar. Një akt më i lartë normativ, i cili ngërthen në vete urrejtje dhe pengesa të zhvillimit shoqëror për komunitetet e ndryshme, vetëm kushtetutë nuk mund të quhet, por, mbi të gjitha, mund të llogaritet si një pamflet politik i cili në plan të parë ka mohimin, diskriminimin dhe shtypjen! Në fillim të viteve nëntëdhjetë të shekullit të kaluar, bazuar në materien kushtetuese maqedonase e të refuzuar nga shqiptarët, në sferën e arsimit sillëshin ligje që e vulosnin mësimin sipëror ekskluzivisht në gjuhën maqedonase. Pra, me kushtetutë shqiptarët mësonin shqip se ishin shqiptarë që nga fillorja e deri në shkollë të mesme. Pastaj, në shkollimin sipëror, për të qenë "shqiptar" duhej të vazhdoje studimet në gjuhën maqedonase! Me këtë miopi politike shpresohet në krijimin e një etnie të re, të "shqiptarëve maqedonas", siç ia dolën në krijimin e komunitetit "maqedonas myslimanë"! Këto ligje diskriminuese, në fakt i hapnin terren mohimit të gjuhës shqipe. Dhe, si rezultat sot kemi gjuhën e "popullit 20%" si dhe nacionalizmin kulturor të shtetëzuar maqedonas! Është



po ai "ambient" politik që mbisundonte atëbotë kur kishte filluar procesi i themelimit të universitetit shqiptar në Maqedoninë e asokohshme me dy universitete në gjuhën maqedonase (i Shkupit dhe Manastirit)! Ishte projekti më serioz kombëtar, në duart e personaliteteve këmbëngulës, deri në vetëmohim, të cilët ditën ta bëjnë shqiptarin për vete dhe t'i detyrojnë edhe "zotët" të gjunjëzohen para këtij projekti më jetik për një komb dhe të detyrohen që të pranojnë ta fusin në sistem shtetëror shkollimin sipëror në gjuhën shqipe.

Në këto hapësira të "Ballkanit të hapur" kemi edhe nacionalizmin kulturor serb që shprehet hapur nga populli serb, ndonëse kjo urrëjtje nuk është aq hapur e normalizuar! Janë elaborate, projekte e programe nacionaliste që për efekt të

"demokracisë së jashtme" nuk kodifikohen në letra të bardhë, porse ruhen si "formula të shenjta" në gjenin serb. Prandaj, serbëve historikisht ju ka penguar populli shqiptar, kultura, tradita, lashtësia shqiptare, shteti dhe trojet shqiptare. Prandaj, sot mund të hasen toponime sllave, madje edhe në Jug të Shqipërisë! Një vend i pushtuar mund të emërtohet në gjuhën e pushtuesit vetëm pasi ta ketë shkruar atë vend dhe të ketë plane për t'ia filluar gjithçka nga e para, natyrisht sipas termit të pushtuesit! Sot, në shtetin serb llogaritet tradhti e rëndë kombëtare dëgjimi i një kënge në anglisht të Rita Orës, të Bebe Rexhës, të Dua Lipës, të Era Istrefit etj. Llogaritet blasfemi e pafalshme lejimi që veshi serb të kapë në mes të Beogradit një llaf në gjuhën shqipe! Llogaritet "ndotje

kulturorë" promovimi i një vepre shqiptare apo artisti shqiptar, i cili të pranishmëve do t'u drejtohej në gjuhën shqipe!

Natyrisht, në shqiptarët kurrë nuk e kemi pasur në gjak urrëjtje e tjetrit që është "jabanxhi", që nuk është i yni, apo që i përket etnisë dhe kulturës tjetër! Gjithnjë të huajin e kemi respektuar dhe nderuar, sepse na e imponon normativa e mikpritjes nën moton "bukë e krip e zemër", të cilin nuk e gjen te asnjë popull tjetër! Këtu zë fill internacionalizmi kulturor i shqiptarit! Përkundër qëndrimit serb ndaj vlerave kulturorë shqiptare, shqiptarët kanë zemër t'ia ndajnë çmimin "Çelësi i Tiranës" antishqiptarit Goran Bregoviç, të cilin pastaj mund ta nderojmë edhe duke e ftuar që të na e hapë ndonjë festival tradicional shqiptar

(siç ishte rasti në Korçë). Përkundër qëndrimit të prerë kombëtar që shtëpitë botuese maqedonase të mos botojnë asnjë shkrimtar shqiptar të vendit, aq më pak ndonjë libër në gjuhën shqipe, shqiptarët promovues të "multi-kultit" e që i japin zor për ta arritur shkallën e "internacionalistit kulturor", ftojnë shkrimtarë serbë e maqedonas, madje nacionalistë të papërmisuar antishqiptar, nëpër festivale e orë letrare, fatkeqësisht, të përkrahur edhe nga institucionet shtetërore! Po pse kur ftohet një krijues serb apo maqedonas, nga Beogradi apo nga Shkupi, nuk ftohet edhe një krijues shqiptar nga Lugina e Preshevës dhe nga Shkupi?! Apo kjo u diktohet nga të ftuarit "e respektuar"? Ky institucionalizim kulturor "shqiptar" gjithsesi që është i tepërt, madje me shumë tepëri, pa dyshim!

## Midis nesh

# PSE MUNGON KRITIKA PËR TEATËR?!

**Mungesa e kritikës profesionale ka ndikuar në humbjen e nuancave të përshkrimit të shfaqjes, të aktrimit, të elementeve skenike dhe ka humbur rrënjësisht diskutimin elitë për teatrin**

Dr. Luljeta ISAKU

Teatri si investim na lidh me njëri-tjetrin dhe forcon aftësinë për të përballuar sprovat e ndryshme të jetës. Për më tepër, nuk ka asnjë metodë që thyen barrierat dhe angazhon vlerat e përbashkëta më shumë sesa teatri. Njerëzit e teatrit nuk duhet ta shohin veten si elitë për të cilën flitet, por si popull i cili vepron.

Shfaqja teatrale është një ngjarje publike, e cila zgjon kureshtjen te njerëzit duke i zgjuar ata, për një arsye ose një tjetër. Atë e bën të suksesshme estetika dhe efekti i saj në shoqëri. Prandaj, qëllimi i teatrit nuk është vetëm të argëtojë, por të vetëdijesojë dhe të krijojë shqetësim të çdo qytetar. Mes teatrit dhe publikut qëndron kritika, e cila çmohet si disiplinë artistike e veçantë e dijes teorike estetike. Ajo respekton dhe duhet të riartikulojë të vërtetat që na vijnë nga vepra dhe produksioni teatror. Kritika artikulon mendimin e krijuar për shfaqjen dhe artistët duke përcjell vlerën e krijuar për vepra të ndryshme teatrale. Duke qenë mendim tejet i kualifikuar dhe me nivel sipëror, sot për sot kjo nuk ekziston.

"Kritika është një gjykim i bazuar në rregullat e shijes së edukuar, të paanshme dhe të lirë. Lexon një poezi, shikon një foto, dëgjon një sonatë, ndjen kënaqësi ose pakënaqësi, kjo është shija; analizoni arsyen për të dyja - kjo është kritika," shkruan V. Zhukovsky.

Kritika është promotori i artit dhe pa kritikë të mirëfilltë arti, është një event në vetvete dhe humb misionin. Te shqiptarët kritika asnjëherë nuk është kuptuar si diçka që qytetërimin i ka ndihmuar në zhvillimin e gjithanshëm. Çdo kritikë qoftë edhe konstruktive, është kualifikuar si tendencioze. Kjo është ndjerë në të gjitha fushat e jetës, në letërsi, art, teatër. Frika për ta thënë të vërtetën ka tkurr rrjedhat normale të kulturës sonë.

Hapësira e kritikës për teatër është zvogëluar shumë. Rrallë, shumë rrallë dikush i qaset me profesionalizëm



kësaj udhe jo të lehtë që kërkon njëherësh shumë dije, shumë guxim dhe shumë karakter. Një situatë e tillë e lë teatrin pa asnjë gjykim profesional. Kritika, veç tjerash, ka qëllim ta ndajë të mirën nga e keqja, dhe kjo hap rrugën për prurjen e vlerave të qëndrueshme. Ç'është e mirë duhet vlerësuar dhe ç'është e keqe duhet kritikuar. Kritiku i teatrit ka nevojë të shndërrohet në një medium të kualifikuar midis teatrit dhe publikut. Në teatër nuk mund të bëhet çfarëdo dhe të mos ketë kush ta kritikojë, kush të shkruajë për të.

Për të shkruar kritikë teatri, nuk mjafton të jesh gazetar. Kritiku duhet të jetë psikolog, historian, regjisor, aktor. Mungesa e kritikës profesionale ka ndikuar në humbjen e nuancave të përshkrimit të shfaqjes, të aktrimit, të elementeve skenike dhe ka humbur rrënjësisht diskutimin elitë për teatrin. Aty ku nuk ka zhvillim dialektik të kritikës mbinë injoranca dhe subjektivizmi merr forma afirmative. Duke e shikuar në nivelin profesional dhe sipëror, ka dekada që zëri kritik për teatrin nuk ekziston. Kultura e urimit dhe komplimentimit që kultivohet në shoqërinë tonë fill pas premierave, bën të pamundur përmirësimin e shfaqjeve në aspektin artistik. Kritika heziton ta thotë të vërtetën për punën e teatrove, sepse luhat marrëdhëniet kolegjiale midis

artistëve. Kur mungon qasja objektive e të shkruarit kritikë nuk risim ndërgjegjen e ekipit teatror, po përkundrazi, mundësojmë një komoditet për të vazhduar me gabimet, në shfaqjet tjera të radhës. Ndodh që festivalet teatrore nisin dhe përfundojnë pa asnjë gjykim profesional. Të njëjtat për shpërblimet që duhet dhënë kanë juri vlerësuese jokompetente. Teatrot tona sillen rreth vetes, apo krahasohen me një teatër të ngjashëm me vetveten. Aktorët nuk fitojnë përvoja loje jashtë teatrit të tyre, jashtë mjedisit në të cilin performojnë. Atëherë si ta kultivojnë aktorët elementin krahasues mes lojës së tyre dhe lojës së aktorëve diku në teatrot e avancuara botërore. Mungesa e stabilitetit ekonomik ka tension të natyrishtëm në përvojën profesionale të teatrove tona dhe njëkohësisht edhe në rolin e kritikut.

Ka kohë që megjulla ka rënë mbi kulturën shqiptare. Gjendja e këtyllë dëshpëruese, erdhi si pasojë e trajtimit të saj në mënyrë më të vrazhdë të mundshme, nga ana e atyre që kulturën e kuptuan si një orkestrinë që duhet dirigjuar nga politika. Politika dhe kultura janë dy skaje të kundërta dhe çdo përpjekje për t'u afruar pranë njëra tjetrës është me pasoja. Kultura nuk bëhet me improvizime dhe me mjeshtrit e manipulimeve që ruajnë pozicionet e tyre në hierarkinë e

posteve politike. Pikërisht ata që do të duhej ta parandalonin këtë, janë vënë në shërbim të politikave ditore të pushtetit.

Sot publiku i ri shqiptar nuk i njeh dramaturgët e vet bashkëkohor, sepse drejtuesit e teatrove tona për shumë arsye e kanë bërë modë më tepër të vënë në skenë shfaqje të huaja klasike duke anashkaluar dramaturgjinë shqiptare. Teatrot nuk janë as një për qind në atë nivel si para tre a katër dekadave. Në atë kohë kishte shfaqje që përjetonin të reprizoheshin për të qindtën herë. Sot, pasi shfaqet premiera, gjithë publiku ngritet në këmbë duke duartrokur 5-10 minuta duartrokitje frenetike, përulen aktorët para publikut, fiken dritat, dhe me këtë akt "fiket" edhe shfaqja. Edhe nëse shkruhet rrallë herë një kritikë profesionale për shfaqjen, ajo nuk luan rolin motivues për të frekuentuar teatrin. Profesionalja është e rëndë për ta kuptuar.


Sot mungojnë organet e shtypit që duhet të jenë të specializuara për kritikën. Mungesa e tyre ka bërë që tashmë çdo vepër teatrale të jetë më shumë vetëm si lajm. Kritika duhet të bëhet pronë e publikut. Prandaj, duhet të ketë revista të përbashkëta të specializuara për gjithë hapësirën shqiptare, Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e veriut, Luginë e Preshevës, Mal të Zi, që me profesionalizëm të trajtojnë problematikën e teatrit. Kriza e kritikës në shoqërinë shqiptare është shkaktuar edhe nga mosunifikimi dhe mosuniteti i subjekteve kulturore kombëtare. Këtu nuk duhet përjashtuar edhe rrugët jo të drejta të përfitimave materiale të organizatorëve të festivaleve që lindin si kërpudha pas shiut. Në këtë mënyrë, në tërë hapësirën kombëtare, avancimi i mendimit kritik, kultivimi i temave dhe perfeksionimi i formave skenike, mbetet në plan të fundit. Këto gjecje tejet të dëmshme e bëjnë teatrin, dramën dhe skenën tonë të ngelet më e varfra në rajon. Nëse institucionalisht nuk veprohet për mbrojtjen e këtij zëri të rëndësishëm për kulturën e kombit, gjithnjë e më shumë kritika e mirëfilltë për teatrin do të bëhet barrë dhe jo vlerë.



**Intervistë:** Marius Dobresku, përkthyesi i autorizuar i veprës së Kadaresë

# E NJOH DHE E DUA KOSOVËN, NJËLLOJ SI SHQIPËRINË

Mund të them se isha me fat. Mbarova shkollimin e mesëm në një kohë kur marrëdhëniet shqiptaro - rumune ishin të një niveli të mirë. Pra, s'kishte asnjë armiqësi mes Rumanisë dhe Shqipërisë



**Fehmi AJVAZI**

Marius Dobresku, është një nga njohësit brilant të gjuhës, letërsisë dhe kulturës shqiptare. U lind në Braila më 23 prill të vitit 1951, aty ku rreth një shekull e gjysmë më parë, jetoi Naum Veqilharxhi. Mbaroi studimet për Gjuhë dhe Letërsi Shqipe në Universitetin e Tiranës në vitin 1975. Ka qenë drejtor i Bibliotekës Kombëtare të Rumanisë, e më pas është orientuar në sferën e përkthimeve, të gazetarisë etj. Krijuesi, publicisti, studiuesi Marius Dobresku, ka vite që drejton edhe revistën "Prietenul albanezului/ Miku i shqiptarit" që botohet në Bukuresht dhe është autor i shumë shkrimeve dhe librave dedikuar Shqipërisë. Mbi të gjitha, Dobresku është përkthyesi i autorizuar i dhjetëra veprave të Ismail Kadaresë në gjuhën rumune. Përmes prezantimit të Kadaresë, ai është nga emrat më të njohur të krijimtarisë kulturo-letëre në Rumani. E kundërta: Dobresku, për mbi 40 vite ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në prezantimin, njohjen dhe eksportimin e vazhdueshëm - sistematik të kulturës, letërsisë dhe arteve shqiptare në Rumani dhe te qytetarët rumunofon. Miku i ynë pakontestueshëm, Marius Dobresku, ndonëse njihet shumë më pak në Kosovë dhe në Maqedoni, mund të themi se Shqipërinë e ka shtëpinë e dytë! Prandaj, është nga të rrallët e huaj që meriten respektin dhe nderimin tonë pa limit. Tamam si një ambasador në diplomaci, me punën e tij të palodhshme e sistematike, Dobresku është ambasadori brilant mes ndërlihdjes, njohjes dhe zhvillimit të dy kulturave tona, asaj shqiptare dhe rumune. Prandaj, i njëjti, edhe është vlerësuar me shumë e shumë çmime

në Bukuresht, e në Tiranë. Dobresku mori pjesë në Seminarin Ndërkombëtar të Gjuhës Shqipe (edicioni i 41), që tradicionalisht u mbajt gjatë verës në Prishtinë.

**HEJZA: Z. Dobresku, faleminderit që gjetët kohë, pavarësisht agjendës suaj të ngjeshur që ua imponon seminari, të jepni këtë intervistë. Prandaj, më lejoni që fillimisht t'ju pyes: s'i ndodhi që u "shqiptarizuat"...**

**MARIUS DOBRESKU:** Faleminderit. Mund të them se isha me fat. Mbarova shkollimin e mesëm në një kohë kur marrëdhëniet shqiptaro - rumune ishin të një niveli të mirë. Pra, s'kishte asnjë armiqësi mes Rumanisë dhe Shqipërisë. Dy vendet ose dy kombet jetonin në të njëjtin sistem dhe ideologji, prandaj kishte edhe gjëra të njëjta, pse jo edhe të përbashkëta, ndonëse shtetet e bllokut komunist kishin ndarë edhe armiqësi të rrezikshme, sidomos armiqësi historike, territoriale dhe ideologjike dhe kështu kishte ndodhur "Hungaria", "Çekosllovakia", të cilat në një farë mënyre u pushtuan nga Moska. Siç thash në fillim, isha me fat meqë përgjatë studimeve, pas gjimnazit, nuk u ndala të studioj në Rumani, por zgjodha një gjuhë dhe një vend të huaj. Ndodhi çuditshëm: unë isha nxënës i shkëlqyer, dhe shteti favorizonte studimet jashtë vendit. Kam një tregim rreth asaj se si vendosa, por është personal dhe, pavarësisht hezitimeve fillestare, qoftë të familjes dhe qoftë të miat, ndodhi që unë u përcaktova të studioja në Tiranë. Dorën në zemër, nuk kisha njohur të paracaktuara për Shqipërinë, por meqë isha i pasionuar ndaj historisë, mësova konkretisht ato që i kisha dëgjuar më parë se


rumunët dhe shqiptarët ndanin gjëra të përbashkëta. Dikur, përgjatë shekujve XIX dhe XX, në qytete të ndryshme, kryesisht në pjesët jugore të territorit të Rumanisë, kishte pasur koloni të mëdha shqiptarësh që kishin lënë gjurmë të pashlyeshme në jetën dhe në historinë e kombit dhe të shtetit rumun. Madje, deri në vitet e 80-ta kishte mbi 30 mijë shqip folës. Fatkeqësisht, sot nuk është një panoramë e këtyllë për shumë arsye...

**HEJZA: Si e kujtoni atë kohë si student?**

**MARIUS DOBRESKU:** Siç thashë, në Tiranë u adoptova mirë, ndonëse si çdo fillim që ka "keqkuptimet" e veta në atë moshë, i kisha edhe unë, e ato ishin: largësia nga vendlindja, njerëzit e panjohur, mungesa e familjes, e shokëve etj. Kjo gjendje kishte ndikim se isha i ri në moshë! Por, kjo nuk zgjati shumë, sepse historia mes dy popujve tanë ishte çuditërisht mjaft e përafërt, miqësore. Ne kishim në krye të historisë, politikës, kulturës, letërsisë, figura eminente me prejardhje shqiptare. Në Rumani, kolonia shqiptare e Bukureshtit, Konstancës etj., përgjatë shekullit XIX dhe XX kishte qenë nga më të fuqishmet e shqiptarëve në emigracion. Ata kishin qenë bërthama e "Rilindjes kombëtare shqiptare"! Në Rumani janë nxjerrë gazeta dhe kanë krijuar veprat e tyre më të bukura Lasgushi, Mitrush Kuteli, kurse Naimi ka botuar shumë nga librat e tij. Naum Veqilharxhi e ka hartuar alfabetin e tij të shqipes etj. Mund të konstatoj se Rumania ishte në këtë kohë atdheu i dytë për shqiptarët! Epo, poeti i njohur Asdreni, tekst-shkruesi i himnit nacional shqiptar, jo vetëm që kishte jetuar, por edhe varrin e ka në Rumani. Por,

duhet thënë që edhe ne rumunët kishim "Mihail Eminsekun" tonë, "Victor Eftimiun tonë", që të dy me origjinë shqiptare që janë, të pandashëm nga kultura dhe letërsia rumune. Kështu, mua disa njohuri për vendin e shqipeve nuk më mungonin, prandaj edhe nuk e ndjeja vetën aq të huaj. Por, edhe Tirana aso kohe ishte një qytet në evoluim e sipër, pastaj i qetë për nga siguria, dhe me njerëz të dashur. Mundësonte kushte për studim dhe unë s'pata asnjë problem për t'i mbaruar me sukses studimet. Dua të them se kombi me një të kaluar të varfër e me halle të mëdha historike, në këtë kohë investonte shumë në superstrukturë (arsim, kulturë, arte, letërsi etj.), dhe kjo më pëlqeu shumë. Kështu, për pak kohë, ndoshta për më pak se një vit, ndjeva në thellësi të vetëdijes e shpirtit tim se po filloja të lidhesha ngushtë me gjuhën shqipe, por edhe me historinë e shqiptarëve, me letërsinë, në përgjithësi me kulturën shqiptare etj. Sigurisht, nuk mund të gjykoja aso kohe se do të bëhesha edhe një përkthyesi i përkushtuar, gjithsesi i pandashëm me gjuhën - letërsinë shqipe. Madje, ndodhi diçka e papritur për mua: ndërsa unë ende isha në fakultet, pra me studime, në Bukuresht u përkthye romani i parë i Ismail Kadaresë. Cila vepër tjetër pos romani "Gjenerali i ushtrisë së vdekur"! Ky roman, i kishte dhënë qysh në fillim, pastaj edhe vazhonte t'i jepte famë sistematike autorit të tij: Kadaresë. Romani u përkthye më 1973 edhe në rumanisht nga Foqion Miçaços, i cili rridhte nga një familjeje e vjetër me prejardhje shqiptare në Bukuresht. Ishte me të vërtetë një përkthim i bukur, madje shumë i bukur. Pas vdekjes së tij, pasi ishte në moshë të madhe kur e






përktheu romanin, e mora unë përsipër veprën e Kadaresë për ta përkthyer në gjuhën rumune.

**HEJZA: A mund të na e shpjegoni më detajisht se si u gjendët në vorbullën e letërsisë sonë. Ju nuk dolët kurrë nga ky vorbull. Pra, a kishte një, dy e më shumë shkaqe që filluat me zhanrin e vështirë, me shemrën e letërsisë: përkthimin...?**

MARIUS DOBRESKU: E them pa modesti se u përshtata shumë mirë në Tiranë. Jeta studentore për secilin ishte mbresë e veçantë dhe më duket se vitet ikën aq shpejt, sa çelë e mbyllë sytë. Në përfundim të ligjëratave dhe studimeve, unë u përcaktova që për temë të diplomës ta kem veprën e Ismail Kadaresë. Ky shkrimtar me të cilin pastaj do të miqësohem e bashkëpunoj deri më sot e në këto çaste kur po flasim, që me veprat e para dha shenja të pakontestueshme se do t'ishte i veçantë, produktiv, cilësorë. Kështu, kur erdhi momenti i diplomimit, unë zgjodha temën historiko-letrare me titull: "Rezistenca e popullit shqiptar para pushtuesve të huaj, e pasqyruar në veprën e Kadaresë". Nuk isha përcaktuar rastësisht për këtë temë. Në vitin e tretë, në fillim të tetorit, shkrimtari i madh erdhi të na ligjëronte. Ai, Kadare na e mbajti lëndën: „Letërsi dekadente botërore“. Ne studentët, ishim të privilegjuar, sepse Kadare ishte njëri prej shkrimtarëve më të arrirë qysh në këtë kohë! Dua të kujtoj këtu diçka, meqë m'u dha rasti: Leksionet e tij nuk qenë aspak në atë frymën partiake - romantike, me të cilën edukoheshim ne të gjithë në atë kohë për shkak të sistemit politik në të cilin jetonim edhe ne në Rumani. Leksionet e Kadaresë ishin thjesht tregime mbi Kafkën, Xhojsin, Prustin, Ioneskon etj. Kështu, e njoha edhe personalisht Ismail Kadarenë dhe veç tjerave, pasioni im pas historisë më afroji me romanet historike të Kadaresë, që do të thotë edhe me letërsinë me motive historike.

Mbasi që u ktheva në atdhe, u punësova në Bibliotekën Kombëtare, por Shqipërinë dhe shqiptarët nuk i harrova. Përkundrazi. Kështu, artdashësit

dhe lexuesit rumun "ia solla" ta njihje e shijonte kulturën e lashtë, poezinë shqipe të Agollit, të Fatos Arapit, Nata-sha Lakos, Xhevahir Spahiut etj. Në përgjithësi, krahas punës në bibliotekë, fillova të shkruaj dhe të bashkëpunoj edhe me gazetatat në Bukuresht dhe një ditë u bëra edhe gazetar. Në anën tjetër, iu qasa njohjes dhe studimit të kulturës, të artit, letërsisë e çka jo tjetër që lidhej me shqiptarët dhe Shqipërinë. Në vitin 1983 e përktheva romanin "Kronikë në gurë" të Ismailit. Lexuesi albanofon, kudo, e mirëpriti këtë roman si nga më



të mirët e tij. Romani u prit mirë edhe nga lexuesi ynë. Si të thuash, me kalimin e kohës Kadareja u shndërrua në një ambasador të letërsisë shqipe në botë. Kështu, në vitin 1986 unë e përktheva në rumanisht edhe romanin "Kështjella", më 1989 përktheva "Nëntorin e një kryeqyteti", dhe në vitin 1990 romanin "Prilli i thyer". Pastaj, këtu po përmendi faktin se kam përkthyer me radhë: "Dosja H" dhe "Përbindëshi" (2000), "Pallati i ëndrrave" (2001), "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" (ribotim: 2003) etj.

**HEJZA: Ju keni përkthyer pothuajse gjithë veprën e Kadaresë në rumanisht. Si e vlerësoni figurën e Kadaresë?**

MARIUS DOBRESKU: Mund të them lirisht se Ismail Kadare është përfaqësuesi më i denjë i letërsisë shqipe, është ambasadori më i mirë i kulturës, i gjuhës dhe i identitetit popullit shqiptar sot në botë. Ai, është botuar në dhjetëra gjuhët kryesore të botës. Tirazhet e novelave dhe romaneve të Kadaresë, përfshijnë qindra mijëra kopje. E kam thënë shpesh e po e them edhe për lexuesit tuaj: Për shembull, në Rumani vështirë e gjeni një njeri që di ta thotë emrin dhe mbiemrin e ambasadorit shqiptar, kurse për Kadarenë kanë dëgjuar të gjithë rumunët dhe ai ka sot me mijëra lexues në Rumani. Kadare, pa diskutim është shkrimtari më i mirë i letërsisë moderne shqipe, më i pa arritshm! Por, ai është edhe një shkrimtari i madh i Ballkanit, sepse i përfaqëson në botë ballkanasit kokëfortë, e kështu edhe rumunët e mi.

**HEJZA: Z. Dobresku, shekulli i kaluar ishte një shekull i një renesance të madhe globale, pra edhe në kulturë e letërsi. Kjo ka ndikuar në shtimin e konkurrencës dhe me automatizëm edhe në evoluimin e cilësive, vlerave kulturo-letrare. Cili është mendimi juaj për arritjet, cilësitë, vlerat e letërsisë shqipe?**

MARIUS DOBRESKU: Arti, letërsia, piktura, muzika etj., janë "ambasadorët" më sublim për secilin komb e shtet, për secilën gjuhë! Këto janë të vjetra sa edhe njerëzimi, kanë ecur paralelisht me civilizimet. Nuk janë zhvilluar e arrirë në mënyrë të njëjtë, por roli dhe rëndësia e tyre përputhet edhe me interesat e njerëzve, pavarësisht nga gjuha e vendi. Edhe letërsia shqipe, arti, kultura etj., kanë histori dhe kudo gjenden gjurmë të lashta të identitetit e trashëgimive të këtilla. Ai që njihet si libri i parë, "Meshari" i Gjon Buzukut, fletë për vjetërsinë dhe origji-

një garë të vazhdueshme. Falë mjeshhtërisë krijuese të Kadaresë, letërsia shqipe është bërë shumë më e njohur dhe më cilësore në përmasa botërore, dhe ai e ka merituar që moti shpërblimin "Nobel" për letërsi. Ama, ka edhe krijues të tjerë të respektuar, si për shembull Teodor Laço, Fatos Kongoli, Ramiz Gjini, Fehmi Ajvazi etj.

**HEJZA: Këtë verë ju morët pjesë në Seminarin Ndërkombëtar të Gjuhës Shqip (edicioni i 41), që tradicionalisht mbahet në Prishtinë. Si e vlerësoni rolin e këtij seminari, meqë jeni nga njohësit e rrallë të kulturës dhe hapësirave albanofone?**

MARIUS DOBRESKU: Ky seminar bëri që dy javë rresht gjuha shqipe të jetë gjuhë ndërkombëtare. Është një nga mjetet e depërtimit të kësaj gjuhe, të historisë dhe të kulturës shqipe në mjedise dhe shoqëri të ndryshme të disa kontinenteve. Është një moment shumë i vlefshëm për një shtet të ri, si Kosova, i cili promovon identitetin dhe identifikon miqtë e vet. Në të njëjtën kohë, këtu formohen pak a shumë albanologët e ardhshëm. Dhe mund të them, sipas pikëpamjes sime, se vit për vit seminari është më i mirë, më interesant nga ana shkencore, më i plotë.

**HEJZA: Ndryshe nga Shqipëria, çfarë ju lidh me Kosovën. Sa e njihni të kaluarën e këtij vendi, kulturën dhe letërsinë, historinë?**

Marius Dobresku: Kam udhëhequr 22 vjet revistën mujore "Drita" të komunitetit shqiptar të Rumanisë si kryeredaktor i saj. Revistë që publikon artikuj për historinë, kulturën, letërsinë, folklorin dhe spiritualitetin shqiptar, pavarësisht nga trevat ku shqiptarët banojnë. Kam publikuar, pra, materiale të ndryshme jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për Kosovën, Maqedoninë dhe diasporën shqiptare. Në revistën tonë u botuan proza apo vjersha e poetëve kosovarë, portrete të disa shkencëtarëve dhe albanologëve shqiptarë (si Rexhep Ismajli, p.sh.). Kemi shkruar për historinë e Kosovës dhe në shkurt 2008 kemi pasur disa faqe për evenimentin historik të atëhershëm. Përveç këtyre, kam marrë pjesë në tre seminare të tjera si ky, në vitet 1978, 1990 dhe 2005. E njoh dhe e dua Kosovën njëjloj, siç e njoh dhe e dua Shqipërinë. Fatkeqësisht, komuniteti shqiptar i Rumanisë përfaqësohet sot nga disa qytetarë rumunë, disa mashtrues që jepen si shqiptarë dhe të cilët harxhojnë për interesat e veta paratë që shteti rumun ia ofron këtij komuniteti.

**HEJZA: Në kontekst të kësaj, sigurisht ju vazhdoni me ngulm të punoni në shumë fusha të ndryshme informative, kulturore, letrare etj.**

MARIUS DOBRESKU: Vazhdoj të punoj me letërsinë shqipe, duke përkthyer vepra të ndryshme të autorëve shqiptarë. Sidomos, veprat e Kadaresë. Sapo kam dorëzuar te shtëpia botuese "Humanitas" romanin "Koncerti" dhe po punoj për një roman tjetër të këtij autori, romanin "Pesha e kryqit". Por miku im i hershëm, poeti dhe prozatori Eqrem Basha, së fundi më ofroi në ditët e seminarit disa nga librat e tij të fundit dhe shpresoj ta njoh publikun rumun me këtë autor kosovar të talentuar. Pastaj, merrem intensivisht me promovimin e vlerave historike dhe antropologjike shqiptare, siç janë kullat e vjetra, p.sh., duke organizuar eventimente shkencore në Bukuresht dhe jashtë tij.



Intervistë me Laura Stamps, shkrimtare amerikane

# FORMULA PËR T'U BËRË SHKRIMTAR I MADH

**Lexoni! Lexoni gjithçka që ju vjen në dorë. Sidomos, poetët e shkrimtarët e mëdhenj që kanë shkruar para jush në zhanrin që ju keni zgjedhur. Mësoni nga poezia e tyre duke i copëtuar poezitë e tyre fjalë për fjalë. Studioni mënyrën e formimit të fjalive dhe strukturimin e rreshtave për të arritur një efekt të caktuar. Çdo poet duhet të jetë lexues i mirë, të studiojë autorët e mëdhenj, të shkruajë çdo ditë**

Intervistoi: Irma KURTI

Laura Stamps është një poete dhe romanciere e vlerësuar me çmime. Poezitë dhe tregimet e saj të shkurtra janë botuar në mbi 2000 revista dhe revista letrare në mbarë botën. Ajo ka botuar 65 romane, novela, përmbledhje me tregime të shkurtra e libra poetikë me botues të ndryshëm. Libri i saj me poezi "The Year of the Cat" (Viti i Maces) u nominua për çmimin Pulitzer në vitin 2005. Ka marrë 7 nominime për çmimin Pushcart dhe ka fituar çmime të shumta, duke përfshirë edhe Muses Prize. Për më shumë se 30 vjet, librat e saj janë pjesë e këtyre koleksioneve të përhershme: Koleksioni Poezi & Libra të Rrallë i Universitetit Shtetëror në New York (Buffalo, NY); Koleksione të veçanta në Bibliotekën James B. Duke, Universitetin Furman (Greenville, SC); dhe Koleksioni i Përhershëm, Biblioteka Gandhi (Mbretëria e Bashkuar). Mund ta gjeni çdo ditë në Facebook (Laura Stamps) si dhe në faqen e saj të internetit: [www.LauraStampsFiction.blogspot.com](http://www.LauraStampsFiction.blogspot.com).

**Ju keni botuar 65 libra me poezi dhe prozë. E mbani mend çastin kur shkruat poezinë e parë?**

Po! Nuk do ta harroj kurrë. Asokohe isha një artiste e suksesshme. Por atë ditë, ditën kur shkrova atë, poezinë e parë, ishte dita kur përfundoi karriera ime artistike. Në shkollë të mesme dhe në kolegji mësuajt e anglishtes më thonin gjithmonë se kisha talent për të shkruar. Por unë jam disleksike. Kisha vështirësi me gramatikën, drejtshkrimin dhe pikësimin. Kisha gjithashtu edhe talent artistik. Të pikturoja ishte më e lehtë dhe kisha fituar shumë çmime të artit në shkollë. Kjo më dha nxitje për t'u diplomuar në Artet e bukura në kolegji dhe për të ndjekur artin si karrierë. Në vitin e fundit në shkollë e mesme fillova t'i shes pikturat e mia në festivale arti dhe vazhdova ta bëja këtë në dymbëdhjetë vitet e ardhshme. Pas kolegjit, pikturat po më shiteshin në galeri të ndryshme në të gjithë vendin. Printime të pikturave m'u botuan nga botuesi im i arteve të bukura në Kaliforni (Haddad's Fine Arts, Inc.) duke u shitur në mbarë botën në galeri, dyqane kornizash si dhe një sërë dyqanesh si Bed, Bath, and Beyond, Target, K-Mart, etj. Pra, deri atëherë kisha ndërtuar një karrierë të suksesshme artistike. Por një ditë bleva një revistë "Writer's Digest" në librarinë lokale Waldenbooks. Më pëlqeu çdo fjalë në të, veçanërisht rubrika me poezi që drejtohej nga Judson Jerome. Ishte ajo që më frymëzoi të shkruaj poezinë time të parë. Ç'poezi e tmerrshme ishte! Nuk e kisha idenë se ç'po bëja. Por isha e magjepsur nga dëshira për të shkruar. Nxora të gjithë librat e mi të gramatikës së anglishtes në kolegji, studiova si e çmendur dhe



porosita disa libra nga "Writer's Digest Book Club" lidhur me atë se si të shkruaj poezi, prozë dhe dokumentarë. Lexoja, studioja, shkruaja çdo ditë, u dërgoja krijime revistave dhe përfundimisht e kapërceva disleksinë time. Mund ta imagjinoni se sa shumë do të thoshte për mua nominimi për çmimin Pulitzer 2005 për librin me poezi "Viti i maces", duke marrë parasysh pengesat që m'u desh të kapërceja për ta arritur atë! Sot kam botuar mbi 65 libra me poezi, përmbledhje me tregime të shkurtra, romane e novela me botues të ndryshëm. Shumë nga romanet dhe novelat e mia kanë qenë muaj apo vite në listat e librave më të shitur në Amazon. Tregimet dhe poezitë e mia janë botuar në mbi 2000 revista dhe antologji letrare në mbarë botën. Kam marrë 7 nominime për çmimin Pushcart dhe kam fituar çmime të panumërta. Këtë vit novelat e mia "The Good Dog" (Qeni i mirë - Prolific Pulse Press) dhe "Addicted to Dog Magazines" (I varur nga revistat për qentë - Impired) u botuan në prill dhe në maj. Në tetor shtëpia botuese Kittyfeather Press do të botojë librin tim me poezi "Shoqja ime më thotë se dëshiron një qen".

**A shkruani çdo ditë dhe sa orë i**

dhe jam në ankth derisa të filloj.

**Çfarë i bën poezitë tuaja unike?**

Unë shkruaj me një stil të rrjedhës së vetëdijes. Edhe pse ky stil mund të duket kaotik, në të vërtetë është mënyra sesi nëndërgjegjja i lidh mendimet së bashku. Dhe kjo është arsyeja pse merr kuptim në mendjen e lexuesit. Më pëlqen ta shtyj këtë stil sa më tepër që të jetë e mundur. Është perfekt për krijimin e formave eksperimentale, të cilat më pëlqejnë gjithashtu. Mendoj se arsyeja pse ky stil më tërheq është sepse është i strukturuar në të njëjtën mënyrë që një artist pikturon një pikturë abstrakte. Dhe unë patjetër e gjej veten në këtë! Gertrude Stein është e famshme për poezitë dhe tregimet e saj me këtë stil. Virginia Woolf ka shkruar një roman të tërë në këtë stil ("Dallgët"). Megjithatë, poetja ime e preferuar është Anne Carson. "Autobiografia e së Kuqes" dhe "Bukuria e burrit" janë disa nga librat e saj. Çdo libër i saj është shkruar në stile dhe forma të ndryshme. Është një poete e mahnitshme. Gjithmonë novatore. Gjithmonë argëtuese.

**A keni përjetuar ndonjëherë bllokun e shkrimtarit?**

Jo. Asnjëherë. Në momentin që mbaroj një libër, jam gati të filloj tjetrin.

**E konsideroni veten një poete të suksesshme?**

Askush nuk ma ka bërë këtë pyetje më parë. Sa pyetje e bukur! Në shumë mënyra mendoj se jam. Unë kam pasur gjithmonë fatin të jetoj nga shkrimet e mia. CV-ja ime e të shkruarit është mbi 80 faqe e gjatë me libra të botuar, kredite botimesh revistash, çmime etj. Atë e mbaj në një fletore të madhe me 3 unaza. Ky është një tregues i suksesit. Mendoj se një tregues tjetër është fakti se më pëlqen ajo që bëj. Më vijnë vazhdimisht në mendje ide e poezi të reja. Ende më pëlqen t'i shkruaj dhe t'i modifikoj ato. Ende më pëlqen t'ua dërgoj revistave dhe të botoj libra. Dhe dua të eksploroj akoma më shumë në zanatin e poezisë.

**Çfarë u këshilloni poetëve dhe shkrimtarëve të rinj?**

Lexoni! Lexoni gjithçka që ju vjen në dorë. Sidomos, poetët e shkrimtarët e mëdhenj që kanë shkruar para jush në zhanrin që ju keni zgjedhur. Mësoni nga poezia e tyre duke i copëtuar poezitë e tyre fjalë për fjalë. Studioni mënyrën e formimit të fjalive dhe strukturimin e rreshtave për të arritur një efekt të caktuar. Çdo poet duhet të jetë lexues i mirë, të studiojë autorët e mëdhenj, të shkruajë çdo ditë dhe t'u dërgojë çdo muaj krijime revistave. Kjo është në të vërtetë gjithçka që duhet të bëni për të qenë një shkrimtar i mirë.



Jon Fosse, Nobel i Letërsisë, 2023

# NJE "MBRET" I NDJESHËM "FSHIHET" NE FJORDET NORVEGJEZE

I katërti norvegjez që po e fiton këtë titull, me diferencë gati një shekullorë nga i fundit, pikërisht ngaqë gjatë gjithë veprimtarisë së tij krijuese i shmanget "si djalli temjanit" publicitetit dhe lavdisë



Grigor JOVANI

Edhe sivjet, si në më të shumtën e rasteve, "Nobeli" i Letërsisë ndoqi ligjin e pashkruar të futbollit: nuk fiton gjithmonë i shumë-sponsorizuar i shoqërive të basteve, por një "i pa parashikuar" ose më saktë, përafërsisht "shkrimtari më pak i mundshëm" për t'u dalluar mbi të tjerët. Dhe nëse sipas një risie të vjetër, "futbolli është një sport ku luajnë 22 futbollistë, por fitojnë gjithmonë... gjermanët", "Nobeli" është një garë letrare ku startojnë një grusht autorësh të famshëm dhe fiton gjithmonë... shkrimtari fitues, me shumën e majme të parave në xhep (lavdia nuk u bën edhe kaq përshtypje, pasi që të arrijnë gjer këtu, e kanë të siguruar prej kohësh). Sa për titujt e nderit: "i merituar 100 për qind" dhe "sipas kriterëve rigorozë letrarë", kjo është një bisedë që ka nisur prej kohësh dhe që ende nuk ka përfunduar... Me përjashtime, natyrisht. Rasti i sivjetmë, me fitimtar norvegjezin Jon Fosse, duket se i përket "përjashtimit" në statut-kuonë e përgjithshme rreth "Nobelit". I katërti norvegjez që po e fiton këtë titull, me diferencë gati një shekullorë nga i fundit, pikërisht ngaqë gjatë gjithë veprimtarisë së tij krijuese i shmanget "si djalli temjanit" publicitetit dhe lavdisë (për përfitimin ekonomik nuk mund të vë dorën në zjarr, thjesht nga padija), duket se me të vërtetë e meriton këtë nder. Froni bosh i dramaturgjisë së sprovuar norvegjeze ngjan të ketë gjetur më në fund zëvendësuesin e "mbretit të skenës" Henrik Ibsen: hegjemonin e saj të tanishëm, dramaturgun, romancierin dhe poetin Jon Fosse. Këshilli përzgjedhës i Çmimit "Nobel" i akordoi stemën përkatëse, me arsyetimin lakonik: "Për veprat dhe prozën e tij novatore, që u japin zë të pathënave". Të paktën, përcaktimet i qëllon ky komision teknokratësh të Letërsisë: janë gjithmonë koncize dhe përgjithësuese për veprën e shkrimtarit.

NJË MBRET NE FRONIN E TIJ  
U lind më 29 shtator 1959, në Haugesund

të Norvegjisë. Krahina ku erdhi në jetë dhe u rrit shkrimtari i ardhshëm, thotë shumë për të. Vend idilik për një shkruar: Izolim, heshtje absolute, madhështia e fjordëve dhe qetësia e detit. Ç'të kërkojë më tepër një shkrimtar? Nëse do të pohojmë se talentin ia dhuron Krijuesi, të tjerat vijnë vetë, natyrshëm.

Fosse i kaloi vitet fëmijërore dhe rininë në një fshat të vogël në fjordet e brigjeve perëndimore të Norvegjisë. Atje gjeti frymëzimet për prozën dhe veprat teatrore. Cilësinë e kësaj krijimtarië "bruto" skandinave e dëshmon fakti se është përkthyer ndërkohë në 40 gjuhë të botës dhe është paraqitur me shumë sukses në skenat e mëdha ndërkombëtare, qysh nga mesi i dhjetëvjeçarit 90-të të shekullit të kaluar.

Për bashkëpatriotët, Fosse konsiderohet shkrimtari më i suksesshëm norvegjez i teatrit në kohërat që rrojmë. Të gjithë janë të bindur se "froni" bosh i Henrik Ibsenit nuk mund të gjente zëvendësues më të denjë. Është nderi më i madh që mund t'i bëhet aktualisht një shkrimtari në këtë vend me tradita në Letërsi, veçanërisht në atë të skenës.

Nga e enjta e parë e tetorit të 2023-shit, këtë "fronëzim" e ligjëroi ndërkombëtarisht edhe Stokholmi, duke i dorëzuar njëkohësisht "kurorën" e sivjetme të Akademisë Mbretërore Suedeze, "Nobelin" e përbotshëm të Letrave.

Ç'thotë vetë "hegjemoni" i ri për këtë fronëzim? Do të ngajë paksa e çuditshme, por nuk duket ta ketë marrë edhe me kaq... optimizëm. Shkaku është karakteri i tij. Megjithatë lavdinë që e shoqëron, vetë ai preferon qetësinë e qytezave të vogla të periferisë, se sa zhurmën e metropoleve. Ka gjetur strehën e vetë të rehatisë në afërsi të Bergenit. Shpesh izolohet tek qyteza e vogël austriake Hainburg, në brigjet e Danubit, ku rron periodikisht me të shoqen slovake. Është martesë e tij e tretë, prej të cilave ka fituar pesë fëmijë. Pa llogaritur "fëmijët" e tjerë të shumtë por të ligjshëm, që i ka fituar nga marrëdhëniet e tij të një jete me letërsinë.

## SEKRETI

Gjashtëdhjetë e katër vjeçari Fosse (ia kam llogaritur saktë moshën, pasi të vetmen gjë e ka të njëjtë me mua!) mban si pasionin të parë gjuhën. Lëndën e parë të veprave të veta. Ky është sekret i tij. Qoftë në poezi, në skenë apo tek proza tjetër e tij, gjuha zë vend primar në jetën e vetë. Aq shumë është përkujdesur dhe njësuar me të, sa që krijimtaria i ka fituar një origjinalitet të patjetërsueshëm. Romanet dhe veprat teatrore i kanë dhicka melankolike, qoftë edhe të errët, të thuash edhe mistike. Karakteristik për çka thashë, romani i tij më i fundit, "Emri tjetër...". E filloi rrugëtimin letrar me "E kuaja, e zeza" (1983). Dhe vazhdoi me romane, vëllime poetike, studime letrare dhe libra për fëmijë. Por ajo çka e fluturoi në majat e letërsisë norvegjeze ishin veprat e tij për teatrin. Elementet mistike dhe fetare në dramën që shkroi - shenja dalluese të talentit të tij të jashtëzakonshëm, i burojnë nga thellësia e shpirtit. Feja i ka preokupuar vazhdimisht krijimtarinë, por edhe jetën. Pasi braktisi kishën protestante, Fosse u bë katolik më 2013. Për këtë ndryshim besimor në situatat përkatëse. Protagonistët e veprave të tij shpesh janë karaktere me depresion të thellë, që kanë dëshuar në jetë.

## KARAKTERISTIKAT

Veprat e Fosse-së zhbirojnë tema që kanë të bëjnë me vetminë dhe vetizolimimin (thua se në çdo vepër bën autoportretin e vetvetes), të introspeksionit dhe të gjendjes njerëzore në situatat përkatëse. Protagonistët e veprave të tij shpesh janë karaktere me depresion të thellë, që kanë dëshuar në jetë. Për sa i përket gjuhës (arma e vetë më e fortë dhe efikase), siç shkruan edhe një kritik tek "Frankfurter Allgemeine Zeitung": "... regjisorët dhe aktorët e veprave të Fosse-së mrekullohen nga gjuha e tij e pastër, e cila ka një rezonancë

shumë muzikore me përsëritjet dhe pauzat e saj. Padyshim, ky shkrimtar të mahnit me gjuhën e tij."

Kjo e fundit ka shpjegimin e saj. Qysh i ri, Fosse luante muzikë, shkruante vetë këngë, ishte dashuruar veçanërisht pas kitarës. Më vonë - siç u rrëfye tek "Neue Zürcher Zeitung", më 2014: "E lashë këtë pasion, pothuajse nuk dëgjoja fare muzikë, me përjashtim të Bahut". Por, muzika e kishte bërë punën e saj. Si një orkestër e padukshme brenda vetes, i kishte transformuar gjuhën e krijimtarisë letrare në një simfonitë marramendëse, që të mrekullon, në çdo kohë ta lexosh.

## ÇMIMET

Është një shkrimtar i shumëvlerësuar. Çmimet që ka fituar përbëjnë një galeri të tërë. Vepra teatrore "Emri" i solli Çmimin "Ibsen" dhe Çmimin Shtetëror Austriak të Teatrit. Dramat "Nata këndon këngët e saj" dhe "Ëndërr vjeshte" njohën sukses të madh dhe u nderuan me çmime të ndryshme në vend dhe jashtë. Më 2002, Fosse fitoi edhe Çmimin Teatrit Kombëtar Skandinavik për veprën "Variacionet e vdekjes". Një vit më vonë, iu akordua ky çmim për tërësinë e veprës.

## ALTER EGO

Le të kthehemi tek personaliteti i tij. Gjithmonë shfaqet publike e bezdisnin. Nuk i duronte blicet dhe prozhektorët e lavdisë. Mendo tani si do të durojë pas pak kohësh ato në Stokholm...

Qysh më 2014, prestigjiozja "NZZ", shkruante: "Fosse është një njeri shumë i ndjeshëm. Presioni shoqëror e ngacmon. Vazhdon t'i durojë shfaqjet publike vetëm në sajë të alkoolit - kur nuk mundet më të kontrollonte alkoolin, e ndaloi - por ndaloi mandej edhe shfaqjet publike."

Rehatinë personale e gjen tek proza dhe poezia e tij. Dhe, natyrisht, tek teatri - "alter egoja" e vetë. Kjo punë e përkushtuar sjell edhe përfundimet e saj: më 2014 iu akordua Çmimi Evropian i Strasburgut për Letërsinë, me motivacionin: "Për tërësinë e veprës si shkrimtar teatror, romancier, poet dhe eseist, për stilin e fortë, të guximshëm dhe novator të shkrimit, në të gjitha gjinitë letrare."

Tre vite më parë këtij akordimi, më 2011, Norvegjia kishte nderuar qytetarin e saj të famshëm, duke i dhuruar Banesën Shtetërore artistike "Grotto", brenda parkut të Kështjellës së Oslos, një shtëpi që në të shkuarën e banonte poeti tjetër i famshëm Henrik Vergeland (1808-1845). Nder i madh ky! Tani, pas "Nobelit", nuk mbetet gjë tjetër veçse të bëhet banues i... Pallatit Mbretëror në Oslo. Asgjë e panatyrshme! Edhe ai, Jon Fosse, mbret i Letërsisë është kurorëzuar.

## BIBLIOGRAFIA


Jon Fosse, përveçse shumë cilësor, është një shkrimtar pjellor. Ka shkruar një mori veprash, përfshirë ato teatrore, si edhe romane, përmbledhje poetike dhe libra me eseistike.

Disa nga më të njohurat e krijimtarisë së tij: VEPRAT PËR TEATRIN: "Dikush do të vijë" (1995), "Nata këndon këngët e saj" (1997), "Një ditë vere" (1999), "Burri i kitarës" (1999), "Këngë nate" (2001), "Variacionet e vdekjes" (2003), "Ëndërr vjeshte" (2005), "Jam era" (2010), "Gjumë" (2012) ROMANE: "Melankolia I" (1995), "Melankolia II" (1996), "Melankolia III" (1997), "Melankolia IV" (1999), "Emri tjetër: Septologjia I-II" (2019) POEZI: "Karrigia e gurtë" (1996), "Një hije në borë" (2006).



# NOBELI MË SHUMË U DUHET SHQIPTARËVE SE SA KADARESË

Kadareja ka 20 vite i nominuar për çmimin Nobel dhe 52 vite që botohet në Perëndim e në botën mbarë, ku 20 vite krijimtari i përkasin kohës së diktaturës



## Fatbardh AMURSI

Askush tjetër nuk e mishëron thënien e Naim Frashërit "Dielli lind andej nga perëndon" nga Ismail Kadare, për më tepër në kohën kur propagandohej "Lindja e kuqe". Germat latine të gjuhës sonë, në latinisht u këndoi Barleti bëmave të Gjergj Kastriotit, kordhëtarit të kontinentit mëmë, si e vetrnja rrugë, që, mendjet e ndritura të kombit e mbajtën hapur, pavarësisht pushtimeve, rrethimeve e izolimeve. (Si bejtexhinjtë dhe ndikimin i letërsisë sovjetike nuk prekën identitetin e letërsisë, prirjen evropiane të saj. Pashko Vasa ishte guvernator i Libisë, por romanin e parë shqiptar e shkroi në gjuhën frënge.)

Pukvili, duke udhëtuar për në Përmet përmend një rast interesant. Në rrugë e sipër një përmetar i drejtohet në frëngjisht, i cili, më pas do t'i fliste për miqësinë që ai kishte me shkrimtarë të njohur të Francës, midis të cilëve përmend dhe Emil Zolanë. Të asaj France nga ku do të nis rrugëtimin fama e shkrimtarit tonë Ismail Kadare, i cili ka 20 e ca vite që nominohet për çmimin Nobel. Nëse do të bënim një krahasim me futbollin, prej vitesh arrin në çerekfinale dhe në gjysmëfinale. Pak po ju duket?! Ndryshe nga Pasternaku, i cili e nxori fshehurazi romanin "Doktor Zhivako", i financuar nga CIA dhe M6 angleze i jepet çmimi Nobel, ndërsa Kadareja botohet jashtë me miratimin e shtetit shqiptar. (Shihni si lumturohen, me të drejtë, poetë e shkrimtarë, kur u botohet jashtë ndonjë poezi, libër apo marrin ndonjë çmim, ndërsa mosmarrjen e Nobelit,

për fat të keq, disa poetucë, shkrimtarucë, shqiptarucë, shtrigologë e gjithologë ia llogarisin shkrimtarit tonë më të famshëm të të gjitha kohërave, si dështim?! As më shumë e as më pak, janë po ata, që vuajnë nga deliri i shkurorëzimit, përngjashëm me dërgatën, që i dorëzoi Viktor Emanuelit III kurorën e mbretit të Shqipërisë, si e si të mos e shihnin në kokën e mbretit të tyre. Studiuesit thonë: pavarësisht se ari zë vendin e parë, vlera e argjendit është më e madhe. Kadare me argjendin i ka të përmbushura ambiciet e veta, por, ja që Nobeli u duhet shqiptarëve më shumë se atij vetë. Një medalje ari merr një sportist i jepen grada në ushtri, ndërsa gjeneralizmi i letrave shqip me "Gjeneralin e ushtrisë së vdekur" pushtoi botën letrare.)

Nuk e teprojmë nëse themi se sjellja ndaj Kadaresë: është një test për të dalluar të talentuarin nga mediokri, të kulturuarin nga pseudoja, mendjen e hapur nga kritizerin delenxhi, pse jo: atdhetarin nga pseudopatrioti. Këta të fundit i gjen me shumicë nëpër parti, medime dhe portale. U duket se Kadare u ka marrë kështimet. Dje e luftonin shkrimtarin në emër të dogmave, si "i shitur tek Perëndimi", kur librat botoheshin me pëlqimin e shtetit shqiptar. (Pushtetarët i akuzojnë se kanë vjedhur floririn që nga mbreti Zog e deri tek këta të sotmit, por më shumë u dhimbset floriri, që, me gjasa, paska shpenzuar Enver Hoxha për botimin e librave të Kadaresë në Perëndim, e cila shkon si kompliment për diktatorin, i cili e derdhka paranë për artin, kur sot shumica dërrmuese e autorëve i paguajnë nga xhepi i tyre

librat e botuara. Na dilka se i interesuar për ta shitur shkrimtarin në Perëndim paske qenë shteti, kur kryeministri i kohës e akuzonte për "agjent të Perëndimit", sikurse akuzoheshin Koliqi dhe Camaj deri vonë?! Tani kanë ndërruar pllakë, jo të shitur tek Perëndimi, por të blerë nga regjimi, si beniamin i Hoxhës dhe oborrtar i tij, duke na kujtuar poezinë e Kadaresë për kuajt nga lufta vijmë dhe në luftëra shkojmë. (Ku qëndron sukcesi i Kadaresë jashtë, e pyetën dikur kritikun Razi Brahimi në Lushnje. Se shkruan sipas shijeve të borgjezisë, ishte përgjigjja e tij. Raziun e kishin sjellë në Lushnje me dënim, si redaktor i librit të Dritërofit "Zhurma e erërave të dikurshme", i hequr nga qarkullimi për gabime ideologjike (!) Edhe kur i zinte e keqja, prapë nuk u rrihej pa e prishur gojën?! Të shajë Kadaren të merrej si një mundësi për të rregulluar biografinë.)

Skematikët nuk kanë tjetër njësi matëse nga politizimet. Ndërsa vetë mbanin nofka dhe pseudonime të tjerët i etiketonin me "shfaqje të huaja", "lakra në kokë", dekadentë apo izmaxhi. (Reliken, dikur e mbanin për vete si hajmali, ndërsa të tjerëve ua vënë poshtë rrobave si magji.) Kush nuk shkroi për partinë dhe Enverin, ja që të Ismailit binin në sy për shkak të artit. Dikur ky soji mburrej me "shqiptonjat që fluturonin lart", ndërsa tani: ku t'i kërkojmë rrënjët e tua, i thonë shkrimtarit. Në librat e shenjtë thuhet se nuk mund të dënohesh dy herë për të njëjtin faji, ndërsa Kadare u sulmua me të njëjtin zell dy herë për romanin "Dimri i madh". Këta të parrënjët, të pa krahet, që janë mësuar të ecin zvarrë,

duke u ankuar se nuk i kanë lënë të fluturojnë, u duhet një armik imagjinar. Për dështimet e tyre fajësojnë atdheun, do thotë diku shkrimtari për ta. (Simpatia e shkrimtarit austriak Peter Hanke për Millosheviçin, nuk e pengoi jurinë që t'i jepte atij Nobel. Ka në botë autorë komunistë që kanë marrë çmimin Nobel, ndërsa Kadare u dashka ndëshkuar pse në roman ka personazh Enver Hoxhën, apo ka shkruar vargje për të. Për Stalinin kanë shkruar edhe disidentë sovjetikë.)

Kadareja ka 20 vite i nominuar për çmimin Nobel dhe 52 vite që botohet në Perëndim e në botën mbarë, ku 20 vite krijimtari i përkasin kohës së diktaturës. Prej gjysmë shekulli të botohet rregullisht në Perëndim, shoqëruar dhe me çmime prestigjioze, një shkrimtar ardhur nga një vend diktatorial, ku shumë e shumë evropianë nuk e dinin nga binte Shqipëria, për më tepër një shkrimtar i trajtuar si heretik, me një rol të jashtëzakonshëm në emancipimin e letërsisë provinciale të vendit të tij, vlera këto që nuk manifestohen prej asnjërit nga të kurorëzuarit e Nobelit, do ishin të mjaftueshme që shkrimtari ynë të kurorëzohej me Nobelin. Nuk mund të habisë fakti, që, ishin të huajt që e promovuan shkrimtarin tonë kundrejt shijeve dhe standardeve të tyre. I dolën krahet, kur këndeje nga ne donin ta izolonin. Në mos ta ndëshkonin.

Rexhep Qosja, që vetë s'i kursen lëvdatat për Enver Hoxhën, në një botim të tijin për censurimin e filmave të diktaturës, krejt pa lidhje, xhiron fjalë krejt të padenja për Kadarenë: "Po ndaluan filmat e para '90-ës, duhet të ndalojnë dhe Kadarenë", "Ç'është romani Dimri i madh? Padyshim "zgjatim i natyrshëm i komunizmit", në të vërtetë "zgjatim i natyrshëm i stalinizmit"! Ç'është romani Dasma? Padyshim zgjatim i natyrshëm i maoizmit, domethënë i politikës dhe ideologjisë së revolucionit kulturor kinez!" Ta zëmë për një moment se kërkesa për censurim miratohet: bashkë me filmat ndalohen dhe librat e Kadaresë. Por, a do t'i ndalojë Perëndimi veprat e "agjentit" të saj? A nuk është e turpshme të mendosh, që në demokraci të kërkohet censurimi dhe ndalimi i librave, sikurse i ndodhi shkrimtarit dhe në diktaturë? Ngjarjet në Ukrainë a nuk e kanë aktualizuar romanin "Dimri i madh"? Shkrimtari mbështet në libër shkëputjen e Shqipërisë nga Moska, gjë që po ndodh dhe me Ukrainën, me një luftë nga më heroiket të historisë moderne. Sovjetikët për të nënshtruan shtetin shqiptar ndaluan furnizimin me grurë, bllokada e grurit u shfaq dhe në luftën e sotme në Ukrainë dhe shpëtimi erdhi nga Perëndimi, Franca, aty ku botohej krijimtaria e Ismail Kadaresë. Meqë financimet ruse sponsorizojnë politikën, median, a ka të ngjarë që sulmet ndaj shkrimtarit tonë perëndimor të kenë sponsorizim lindor? Por ta mbyllur: Nobeli më shumë u duhet shqiptarëve se Kadaresë.



# VEÇANTITË KULTURORE DHE MONDIALIZMI

**Bajroni u distancua nga kombi dhe u bë një poet evropian. Hygo mbrojti "kombësinë evropiane". Stendali e shpalli ndjenjën kombëtare "contre nature". Pushkini e pa atë si një "ves". Për një besimtar të "artit të pastër", siç është Gustave Flaubert, një vepër arti "nuk ka atdhe"**



**Nga Metin IZETI**

Disa forma të bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar janë bërë të pashmangshme: teknologjitë moderne aplikohen në të gjitha pjesët e botës; informatika u bë një disiplinë e përgjithshme; pranohen terminologji të ndryshme si të zakonshme; mbrojtja e mjedisit nuk mund të zbatohet vetëm në kuadrin kombëtar ose rajonal; Interneti përdoret nga njëri skaj në skajin tjetër të planetit. Forma të tilla mondializimi - ndoshta do të ishte më mirë t'i quanim thjesht integritime - nuk mund të identifikohen me ato që sapo u përmendën. Ai që i heq dorë me çdo kusht, duke mos pyetur për natyrën dhe qëllimin e tyre, do të vendnumërojë dhe do të vonohet. Në një debat që është mbajtur në Romë, Umberto Eco ka sugjeruar që të bëjmë dallimin midis "mondializmit si fakt dhe mondializimit si vlerë". Të gjithë flasin për mondializimin pa pyetur se çfarë do të thotë në të vërtetë. Ndoshta edhe kjo është nga paqartësitë ndaj së cilës është i prirur post-modernizmi. Terminologjitë e reja i lënë pas ato më të vjetrat - ato humbasin, për shembull, fjalët, kozmopolit-anizëm ose internacionalizëm humbin kuptimin e tyre.

**Kultura kombëtare si mjet në luftën për çlirim**

Standardet e vlerave mund të ndihmojnë në shmangien e rreziqeve të caktuara ose të paktën të zvogëlojnë rreziqet. Të gjitha pjesët e botës - ato në të cilat të drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit kanë arritur nivele më të larta dhe ato që po përpiqen të shpëtojnë nga prangat e prapambetjes ose varfërisë - nuk mund të mondializohen, padyshim, ato nuk janë, siç thuhet zakonisht, "i mondializueshëm" në të njëjtën masë, me të njëjtën metodë...

Përvoja tregon se veçoritë në fushën e kulturës janë të vështira për t'u harmonizuar me vlerat. Në një letër, në fillim të shekullit që do të lindte Evropën (1801), Hölderlin shkroi një paralajmërim profetik: "Ne nuk mësojmë asgjë më të vështirë se sa përdorimin falas të të veçantës (der Besondere)". Veçantitë, ndonjëherë në mënyrë krejt të padukshme, kthehen në partikularizma. Autarkia dhe relativitetet paraqiten si kategori vlerash. Egoizmi dhe

vullneti për pushtet fshihen pas utilitarizmit dhe efikasitetit. Duke iu kundërvënë instrumenteve korruptive të mondializimit, kultura kritike nuk përballon presionet e ushtruara mbi të. Rregullat e lojës botërore janë më të forta se ajo vetë. Mbështetja që merr nuk i mjafton.

Veçantitë kulturore nuk kanë rëndësi të njëjtë në çdo periudhë të historisë. Meritat që ato kanë fituar nuk mund të mohohen. Në botën e sotme, projektet e saj dallohen për atë se sa i ruajnë nocionet tradicionale të kulturës dhe kombit. Para Revolucionit Francez, në të cilin lindi kuptimi modern i kombësisë, sigurisht që kishte komunitete me karakteristika pak a shumë të dallueshme: popullore, etnike, fetare, tradicionale, historike. Nga Rilindja deri te Iluminizmi, kultura evropiane adoptoi dhe transmetoi modele dhe aspirata universale dhe kozmopolite. Kombet me shtetin e tyre kishin më shumë mundësi për të mbështetur kulturën e tyre dhe për t'i siguruar asaj një pavarësi më të madhe sesa ato që ishin të përfshira në shtetet e huaja si subjekt i organizimit të tyre. Nga një pozicion i tillë vareshin liritë që ofroheshin dhe realizoheshin. Bajroni u distancua nga kombi dhe u bë një poet evropian. Hugo mbrojti "kombësinë evropiane". Stendali e shpalli ndjenjën kombëtare "contre nature". Pushkini e pa atë si një "ves". Për një besimtar të "artit të pastër", siç është Gustave Flaubert, një vepër arti "nuk ka atdhe". Marksi ëndërronte gjithashtu një klasë punëtorë pa atdhe. Eksperiencat nuk i kanë dhënë të drejtë as njërit dhe as tjetrit. Avangarda artistike dhe politike mund t'i afroshin njëra-tjetrës në një mënyrë më të lumtur se ajo që i kishte paraparë historia. Në kulturat e kombeve (popujve) pa shtetin e tyre, çështja e përkatësisë dhe e detyrës shtruhej në një bazë tjetër. Aty ku hapësira politike është e kufizuar, e ndarë ose e pushtuar, kultura kombëtare është e ekspozuar ndaj kufizimeve dhe varësisë më të madhe: ajo duhet të ishte, ndër të tjera, një mjet në luftën për çlirim, një mbështetje e kombit, një shprehje e aspiratave të tij. "Kultura për liri" (Kultur zur Freiheit), slogani i Fichte nga fundi i shekullit të 18-të në Gjermani, e cila ende nuk ishte bashkuar në shtetin e vet, u miratua në pjesë të ndryshme të Evropës që ishin në një pozicion të ngjashëm. Dhe

Josip Juraj Strossmayer, reformatori më i rëndësishëm kulturor në shekullin e nëntëmbëdhjetë, përdori një slogan të ngjashëm: "Edukimi i lirisë".

**Arti do të jetë kombëtar vetëm kur të jetë brend botëror**

Veçantia kulturore vlen në parim aq sa është në të vërtetë kulturë. Për vetë kombin të cilit i përket dhe për të cilin synohet, ai ka edhe kuptime të veçanta, të cilat ndonjëherë është e vështirë të përcaktohen jashtë vetë kombësisë. Gjithashtu duhet pasur parasysh edhe dallimi midis veçorive dhe vlerave. Kulturat e kufizuara krijojnë standarde po aq të kufizuara që i vërtetojnë ato para vetes. Nacionalizmat harrojnë paralajmërimet që u dërgojnë shpirtit më të mëdhenj të kombit. Forca e kulturës kombëtare nuk është në aftësinë për të refuzuar, eliminuar, por në fuqinë e procesit duke marrë, thithur sa më shumë elementë kulturorë të huaj (...). Arti do të jetë kombëtar vetëm kur të jetë brend botëror. Alternativat midis të qenit i "rrënjësor" në qenien e kombit, kombësisë (Barrch) dhe ndjenjës së "të pastrehit" (që sipas Heidegger-it është pjesë e "fatit botëror") shkaktojnë mosmarrëveshje. Malli për atdheun dhe freskimi që ofron "brumi amtari" jo gjithmonë garantojnë begati intelektuale apo krijuese. Marrëdhëniet me të tjerët sjellin rreziqe që ndonjëherë nuk i dëshirojnë vetë kultura, sfida që prishin rendin dhe qetësinë e saj. "Në momentin që zbulojmë se ka kultura dhe jo vetëm kulturë" - vëren Paul Ricoeur - "kur njohim përfundimin e një lloji monopoli kulturor, iluziv apo real, zbulimi ynë kërcënon të na shkatërrojë". Të përgatitur për sfida dhe rreziqe të këtij lloji, shumë preferojnë të vendosin - veçanërisht ata që nuk mund të heqin dorë nga mbështetja dhe siguria e ofruar nga mjedisi - të jenë thjesht vetvetja në mënyrën e tyre, edhe nëse mbeten në skaj ose në hije.

Kultura planetare, e cila diskutohej shpesh përpara se të hynte në modë mondializimi ose globalizimi, kërcënon të unifikojë veçoritë (vlerat) kulturore. Përballë llojeve të ndryshme të asimilimit, dominimit të më të fortit ndaj më të dobët, të më të zhvilluarit ndaj më pak të

zhvilluarve, mendoj se duhet të theksohet e drejta e dallimit dhe njohja e pluralizmit, ose thënë ndryshe, bashkësia e veçantive kulturore. Në diskutimin për bashkëpunimin e kulturave dhe sintezave në nivel botëror, antropologu Claude Levi-Straus formuloi një parashikim që duket ende i pranueshëm sot: "Qytetërimi botëror nuk mund të ishte asgjë tjetër veçse një koalicion, në nivel botëror i kulturave që ruajnë origjinalitetin e tyre". Veçantia kulturore mbetet baza e çdo kulture të veçantë në masën që konfirmon dhe shpreh identitetin e njerëzve të cilëve u përket dhe i lidh me kulturat e botës. Detyrat e saj nuk janë më të njëjta si në kohën kur kishin filluar të formoheshin kombet. Është e detyruar, duke hyrë në "koalicione" ndërkombëtare, të çlirohet nga mitet e vjetra dhe spektrat e ngurta. Në masën që e arrin këtë, ai konfirmon cilësinë e vet dhe justifikon çështjen e saj. Në diskutimin për kulturën dhe konfliktin nuk mund të lihet vepra që, me sfida të saj, na shtyu të mendojmë për "përplasjen" që çojnë dallimet kulturore dhe fetare midis qytetërimeve. Vepra e profesorit amerikan Samuel Huntington, me titull "Përplasja e qytetërimeve dhe ribërja e rendit botëror". Megjithatë, është e vështirë të pajtohesh me disa nga përfundimet e tij. A është "imperializmi një pasojë e pashmangshme e universalizmit"? Është e mundur të ndryshohet ky gjykim: mosrealizmi i projekteve universale të Iluminizmit shkaktoi shtrembërimet që po shohim. Kjo ka qartë në situatat kundër të cilave Huntington paralajmëron. Ajo e privoi një kulturë të caktuar nga bota. Deficiti i laicizmit në kuptimin fetar të kombit ose, nga ana tjetër, në pranimin dhe praktikimin e ideologjisë së fe, rezultoi katastrofik. Duhet të merret parasysh kur bëhet fjalë për "përplasjen e qytetërimeve" - mund të ndihmojë në korrigjimin e supozimeve të caktuara: nuk përplasen kulturat si të tilla, por ideologjitë që dolën prej tyre dhe që i shtrembërojnë ato. Pra, këta dyja nuk janë çështje të njëjta.

**Kriteret e qytetërimit bashkëkohor**

Në fund, dua të theksoj disa përvoja ose njohuri që mund të ndihmojnë: është e vështirë të pushtosh të tashmen nëse nuk zotëron fillimisht të kaluarën; shpesh na është dashur të mbronim trashëgiminë tonë, e kuptuam se ndonjëherë është e nevojshme ta mbrojmë veten nga trashëgimia; duhet të kursejmë kujtesën, ka raste kur duhet të shpëtojmë nga shumë gjëra çfarë përmban kujtesa; vetëdija kombëtare nuk është forma e vetme e vetëdijes, ajo është e dëmshme për vetë kombin nëse mbetet e vetme; është e rrezikshme kur energjia kombëtare bashkon dhe barazon të gjitha energjitë e tjera, individuale dhe kolektive, ose anasjelltas; liritë lindin dhe ne nuk dimë gjithmonë çfarë të bëjmë me to, ose tundohemi dhe abuzojmë me to; ndarjet janë të imponuara, dhe gjithsesi se duhet të menaxhohen, përndryshe na mbytin. Kontakti i kulturave, rrjedhja e ideve dhe transmetimi i përvojave, takimi me krijuesit dhe njohja me veprat e tyre janë bërë kritere të qytetërimit bashkëkohor. Ato nuk duhet t'i pakësojnë identitetet dhe nuk duhet të kërcënojnë pavarësinë e veçantive kulturore. Ky konstatim duhet të vlejë edhe për ata që jetojnë "në të kaluarën", por edhe për ata që jetojnë vetëm "në të tashmen". Paragjykimi nuk duhet të mbizotërojë gjykimin. Realiteti ekzistencial e pret secilin prej nesh, në të tashmen duke logaritur në trashëgiminë dhe kujtesën. Duhet të merremi me të kaluarën, e cila ndonjëherë na duket e përhershme. Të merremi me veten, ashtu siç jemi. Nuk duhet të lejojmë edhe një herë që "miti dhe fitorja mbi mitin" të shkatërrojnë me njëra-tjetrën.



Në shiritin e kohës

# KARANTINA E LASGUSHIT

Pas vitit 1944 ai refuzoi të shkruante dhe të jetonte, siç ia kërkonin të tjerët. U mbyll në një karantinë që vazhdoi gati gjysmë shekulli

Bardhyl LONDO

Pas vitit 1944 Lasgushi pothuajse nuk shkroi asgjë të rëndësishme me përjashtim të Kamadeves, e cila për mua është e dyshimtë të jetë shkruar pas 44. Në rast se po përse nuk e botoi, por pa dritën e botimit aq vonë? Po të këtë ndodhur kështu është dhe me domethënëse: poeti s' ka dashur t'i japë asaj kohe një poemë aq të bukur ose ka pasur frikë ta botojë. Të vetmet vargje që ka shkruar Lasgushi në atë kohë janë një tallje dhe ironi e hapur. Kështu e doni poezinë ju? Ua jap unë: Republika Popullore/ mori Shqipërinë për dore/ dhe e çoi në fitore. Është proverbiale pyetja që i drejton Lasgushi Kadarese duke pirë kafe në Turizmin e Pogradecit: "Në ç' sistem jetojmë, z. Ismail?"

Karantina e Lasgushit ishte aq e thellë sa atë pothuajse për vite të tëra nuk e kishte parë kush. Në vitin 1986 Aurel Plasari me gazetarë të "Dritës" shkoi ta intervistonte pas kaq vitesh tek shtëpia në Tiranë, sepse ai gjysmën e vitit e jetonte në Tiranë, gjysmën në Pogradec. Pasi i la rreth gjysmë ore të prisnin se çelësin e kishte e shoqja dhe kishte shkuar në pazar (e shoqja kishte nja njezët vjet që kishte vdekur) porta më në fund u hap dhe filluan pyetjet. Përgjigjet ishin të

gjitha njëlloj. Kush është poeti më i madh i shqipes. Po këtë e dinë të gjithë. Po kush? Po këtë e di dhe Cuci, qeni im. Po kush? Lasgushi bre. Po pas tij? Rituall fillonte nga e para. E dinin të gjithë, e dinte dhe qeni i tij se nuk kishte tjetër. Po i njëjti format edhe për përktyesin. E dinte dhe Cuci që Lasgushi ishte më i miri dhe pas tij nuk kishte tjetër.

Pak kohë para vdekjes në Lidhjen e Shkrimtarëve u vendos të festohej përvjetori i Lasgushit për herë të parë. Interesim i jashtëzakonshëm deri në oborr. Në orën 10 ai që mungonte ishte Lasgushi. Pas rreth dy orësh më në fund e gjejnë. Lasgushi hyri, me kostum të zi, me barsolinë, mbështetur mbi bastunin, i zbehtë sikur sapo ishte ngritur nga varri (hollësisht e përshkruaj tek libri im "Jeta që na dhanë"). Gjatë gjithë kohës që flitej për të ai shikonte vetëm tavanin. Në fund kur i thane se, sipas zakonit të atëherëshëm, duhej të falënderonte Partinë dhe organizatorët, ai goditi me bastun dyshtemenë dhe tha vetëm dy tre fjalë: dëgjoni këtu, poeti është Zot, është mbi gjithçka. Kjo ishte hera e parë dhe e fundit që e pamë Lasgushin. Pas vitit 1944 ai refuzoi të shkruante dhe të jetonte, siç ia kërkonin të tjerët. Prandaj u mbyll, ose më saktë e detyruan të mbyllet në një karantinë që vazhdoi gati gjysmë shekulli.



Kryefjala

## TË FALËSH!

**Lajmëtarët do prisnin gjatë në odën e tij që të merrte një vendim, të jepte besën ose në rastin më të mirë t'i falte ata që i kishin bërë keq, do prisnin aty dhe asnjërit prej tyre nuk i vinte mendja t'i thosh: na i trego plagët, ose thjesht një ohh sa të paskan vrarë!**

Fatmir GJATA

Në prezantimin e librit "Në rrugët e ferrit" të Visar Zhitit mbeti kryefjalë, nuk e di përse, fjala FALJE. Pas shqiptimit të saj dhe mbasi Zhiti u mundua të sqaronte çka ndiente në

shpirt, nuk e di përse më dukej sikur kjo fjalë nuk u tret, nuk u largua nga salla, por mbeti pezull në ajër dhe askush nuk po e largonte dot t'u bënte vend argumenteve dhe diskutimit mbi veprën e tij. Një perde e zezë binte e hapej dhe po ashtu rimbultonte ambientin me

një tingull gjinkallor që rikujtonte se ishte aty akoma. Ndoshta ishte përshtypja ime ose më saktë mbeti në mendjen time dhe çfarëdo flitej në sallë më sillje rrotull ajo fjalë - FALJE. Ndërmend më vinin disa njerëz të veshur me tirq që iknin nëpër dimër e kalonin në shpatet të thepisur për të vajtur te shtëpia e të vrrarit, për të përcjellë një mesazh ngushëllimi dhe njëkohësisht për të kërkuar besën 30 ditësh për njeriun e tyre, të cilin natyrisht nuk e quanin vrasës, kriminel apo diçka të ngjashme. Imagjinoja Zhitin duke fërkuar mjekrën e parruar ndoshta që nga koha e burgut dhe kokulur do mudohej mos t'i shihte në sy. Duam besë mos na vrisni. Lajmëtarët do prisnin gjatë në odën e tij që të merrte një vendim, të jepte besën ose në rastin më të mirë t'i falte ata që i kishin bërë keq, do prisnin aty dhe asnjërit prej tyre nuk i vinte mendja t'i thosh: na i trego plagët, ose thjesht një ohh sa të paskan vrarë! Do ishin njerëz të mësuar me gjak të rrjedhur nëpër korijet apo në mes të fshatit, tek kroi duke pirë ujë apo duke ngritur mullarin me kashën e gurit. Do ishin mësuar duke parë vrimat e plumbave dhe i vetmi shqetësim do ish vrima e hyrjes dhe ajo e daljes, në gjoks a në shpinë, në krahë a në këmbë. Asnjë prej tyre nuk e ka

idenë që shpirti vritet, bile plagët që mbeten atje janë shumë herë më të këqija e më vdekje-ndjellëse. Ndërsa Visari fliste mudohesha të krijoja idenë se si do ish përgjigjur njeriu paqësor me atë kantilenë të bukur zëri. Ndoshta ka shkruar një poezi ose më saktë e mban në mend që nga koha kur mudohehin t'ia grisnin trupin edhe shpirtin njëkohësisht por nuk besoj se e ka recituar para tyre. Ata nuk besoj se e donin poezinë, do kenë qenë armiq të betuar të poezisë, do mudohehin t'ia kyçin gojën mos dilte nga goja e tij, t'ia lidhnin kokën mos ta mbante në mendje. Dhe poeti do t'u kthente shpinën për një çast për t'u menduar çfarë lajmi do përcillnin. Ndoshta do merrte një lot nga faqja edhe do ta fuste në xhep me dorën e dridhur për ta fshehur nga bashkëbiseduesit. Të falësh është fisnike, fal miku im. Por, në dhomë ka mbetur vetëm dhe s'ka kë të falë. Lajmëtarët nuk erdhën kurrë, u dyndën në vendin e kriminit të fshihnin gjurmët. Janë ata që merren me vendin e kriminit dhe s'kanë nevojë për falje. Nis përtyt frazën e famshme "rruga për në ferr është e shtruar me qëllime të mira". Dhe Visari vërtitet nëpër botë duke mbartur me vete një falje të padhënë.

Thekse

## KULTURA DHE POLITIKA

Tomas MAN

(...) Fakti që unë arrita të bëhem ihtar i demokracisë është rezultat i bindjeve që nuk e pata të lehtë t'i përvetësoja, madje që fillimisht ishin të huaja për mua, ngase isha rritur dhe edukuar me traditat shpirtërore të filistinizmit gjerman. Por unë formova bindjen se politika, socialja janë pjesë përbërëse dhe e pandashme e Njerëzores, se intelektin ynë duhet t'i përfshijë ato tek problemat unik i humanizmit, sepse, përndryshe, nëse ne do të shpërfillnim elementin politik, social, të pandashëm prej humanizmit, mund të na shfaqej një humnerë e rrezikshme dhe vdekjeprurëse për kulturën. Mos vallë duket e

çuditshme kur them se unë thjesht e barazoj demokracinë me politikën, duke e përcaktuar demokracinë, si aspektin politik të Shpirtërores, si gatishmëri të Frymës ndaj politikës? Njëzet vjet më parë, në librin voluminoz Meditimet e një apolitiku, që më kush-toi përpjekje aq të mundimshme, i dhashë këtij përcaktimi një theks polemik mohues. Në emër të kulturës e madje të lirisë, iu kundërvura me të gjitha forcat asaj që e quajta demokraci duke pasur parasysh me këtë politizimin e jetës shpirtërore. Sipas botëvështrimit tim të asaj kohe koncepti liri do të thoshte liri etike, ndërsa për bashkëlidhjen e saj me lirinë qytetare unë pothuaj nuk dija dhe nuk doja të

dija asgjë. Por vetënjohja, nëse i kushtohesh asaj me seriozitet të mjaftueshëm, përfaqëson, në shumicën e rasteve, hapin e parë drejt rilindjes së brendshme. Unë kuptova se njeriu, duke njohur veten, nuk mbetet kurrë plotësisht sikundër që më parë. Vetë ai libër, me synimin e tij të spikatur për të folur njëherësh për të gjitha, ishte shprehje e krizës, pjellë e rrethanave të reja të krijuara nga ngjarjet e jashtme katastrofike. Problemi i Njeriut, problemi i humanizmit ngrihej përpara vështrimit shpirtëror të brezit tonë me tërë ndërlikimin e tij dhe me një ngutshmëri të paparë deri atëherë. U bë e qartë se jetën shpirtërore nuk mund ta ndaje si më sëpatë nga politika; se men-

dimi që mund të krijohen vlera kulturore duke ruajtur apolitizmin përfaqëson lajthitjen e ideologjisë borgjeze gjermane; se kultura do të vihej përballë një rreziku kolosal sikur asaj t'i mungonte instinkti dhe vullneti politik. ...Pretendimi për pavarësinë e kulturës ndaj politikës është lajthitje, vetëmashtrim. Është e pamundur të ikësh politikës në këtë mënyrë. Më e mundshme është të gjendesh në anën tjetër të barrikadës... Apolitizmi nuk është gjë tjetër veçse antidemokratizëm e, se çdo të thotë kjo pikërisht, në ç'mënyrë vetëvrasëse një pozitë e tillë sfidon gjithë arritjet shpirtërore, zbulohet me qartësi të jashtëzakonshme në kthesat e forta historike. (1939)



# KULTURA PRIN KOMBIN DHE GJUHËN!

**Vërtet, a mjafton gjuha e unifikuar, a mjafton shqipja jonë e dashur të jetë veshje e përhershme dhe e pandryshuar e brendisë së gjithë strategjive kombëtare për kulturën?**



**Durim TAÇI**

Ndër sfidat e viteve '90 në strategjinë kulturore në Shqipëri, ishin editoria e pavarur, tregu i librit, ligji i librit, e drejta e autorit, etj, pra politika që lidheshin kryesisht me librin shqip, pra me gjuhën kombëtare. Ishin domosdoshmëri, por këtu nuk ka asgjë të re: kjo ndodh tash e njëqind vjet! Mirëpo, nga një vështrim i sotëm, a mund të kufizohet kultura brenda gjuhës kombëtare, për rrjedhojë vetëm librit shqip? Sigurisht që jo. E them që në fillim, do parapëlqej

promovimin e leximit si i tillë, si proces, më shumë se gjuhën në të cilën ai kryhet, qoftë kjo edhe gjuha kombëtare. Sidomos për diasporën, nuk janë kamionët me libra shqip dërguar nga vendi armë që do e bëjnë atë më të kulturuar, por ndërveprimi e prosperimi në vendet ku jeton e në gjuhët e tyre. Sa i takon mbajtjes së saj lidhur më shtetet tona shqiptare, do ishte më mirë siguri i të drejtave që u sjell dështetësia, si e drejta e votimit dhe e pjesëmarrjes në jetën politike atje, vendimmarrja për fatet e atdheut.

Vërtet, a mjafton gjuha e unifikuar, a mjafton shqipja jonë e dashur të jetë veshje e përhershme dhe e pandryshuar e brendisë së gjithë strategjive kombëtare për kulturën? Për shqiptarët fjala "kombëtare" është e shenjtë, por le të përqendrohemi pak më shumë edhe në idetë se si pasurohet sot "kombëtarja". Është e vërtet që kombi shqiptar është formuar mbi gjuhën, flasim 'shqip' e për rrjedhojë jemi shqiptarë. Në rregull, gjatë historisë sonë kjo na ka ndihmuar të ruajmë ekzistencën, por a na duhet të mendojmë në pafundësi thjesht për mbijetesën? A na duhet vetëm një prani e shtuar thjesht numerike shqiptarësh? A mundet që sa më shumë shqiptarë që flasin shqip të na garantojnë më shumë kulturë e identitet në zhvillim? Cili është sot roli i gjuhëve kombëtare në prosperitetin e vendeve të ndryshme, kur vetë rasti i shqiptarëve është i veçantë, sikurse i shumë popujve të tjerë të vegjël? Çfarë, do presim të bëhemi më të mëdhenj se ç'jemi?

Pastaj, a janë shqiptarë ata që nuk po flasin më shqip, fëmijët tanë nëpër botë, ata që po këndojnë anglisht, si Dua Lipa? Ata po prosperojnë duke përdorur gjuhë tjetër, duke u zhvilluar e lënë gjurmë me gjithçka që ofron integritet në kulturat e popujve ku jetojnë. Cilësia, suksesi i tyre, na bën ta harrojmë menjëherë në ç'gjuhë janë shprehur, u gjejmë rrënjë e degë nga janë e s'janë dhe pastaj krenohemi me ta si shqiptarë. A mos vallë vetë gjuha dhe kombi vijjnë e bëhen pengesë kur vihen me patjetër në themel të strategjive të zhvillimit duke errësuar gjithçka tjetër? Se kështu i bie, ta lëmë jashtë atëherë

konceptin e gjerë të kulturës me prerje universale, se nuk vlen, na bën të vegjël numerikisht! Mirëpo, strategjitë kulturore duhen kërkuar përtej këtyre kufijve, na pëlqen ne ose jo! Kultura, ai kompleks manifestimesh i jetës materiale, shoqërore dhe shpirtërore në marrëdhënie me fazat e ndryshme të një procesi të gjatë evolutiv, tani ndodhet në një periudhë tjetër historike. Për një shkrimtar shqiptar sigurisht nuk është më e rëndësishme se në çfarë gjuhe e ka shkruar veprën, se sa vetë cilësia e saj. Pakësohen instrumentistët popullorë, por shqiptarët nga ana tjetër kanë filluar të mbushin orkestrat më të famshme të Evropës, pakësohen vallet, shtohen talentet në baletet klasike e moderne. Diaspora, sidomos, manifeston në vendet ku jeton kryesisht me mjetet shprehëse që gjen aty, kjo është sfida e saj, përditshmëria e saj, aty zhvillohet kultura e saj, jo në festimet e zhurmshme një herë në vit për Ditën e Flamurit.

E di, është një trend provokativ ky, ta shtrosh çështjen në këtë mënyrë, megjithatë duhet arsyetuar përtej identitetit në gjuhë, një shekull më vonë, pa e mohuar atë, përkundrazi duke e zhvilluar atë. Të kuptojmë se sot nuk na duhet shumë të unifikojmë, por të ndjekim, të pranë-vëmë, të harmonizojmë, të zhvillojmë e ushqejmë prirje e tendenca në kulturë. Sot jemi shumë më mirë nga saç e mendojmë, por duhet të përpiqemi ta kuptojmë arsyen përse kjo ka ndodhur, e të vetëdijesuar të ecim përpara. Kultura vetë, do na çojë kah shqipja e kombëtarja!

*Ese*

## RRENË E KAM DËGJUAR, RRENË PO E TREGOJ...

**A nuk ju ka ndodhur që një ngjarje që e keni përjetuar, ta keni ndjerë fenomenin "deja vu"? Të keni përshtypjen se e keni përjetuar edhe një herë tjetër, sikur keni qenë në atë vend, sikur keni takuar po atë person?**

**Aziz MUSTAFA**

"Rrenë e kam dëgjuar, rrenë po e tregoj." Kjo fjali më ka mbetur në mendje, që nga koha kur kam mësuar të dëgjoj. Kam menduar me vete: nëse e kam ditur se është rrenë, pse të tregoj rrenë? Pse mos ta pres zinxhirin e asaj rrene? E kam dëgjuar një rrenë, por nuk po e tregoj hiq. Po e mbajë për vete, se nuk më bën gjë dëm. Apo është një kleçkë tjetër: ai personi që thotë "rrenë e kam dëgjuar, rrenë po e tregoj", është në fakt vetë një trillues i lindur si ai baroni gjerman Münchhausen, të cilit shumë shpesh ia harroj emrin, ai baroni pra që imagjinon gjërat, i zmadhon dhe i zbukuron ato. E bën mizën buall. A nuk njohin shumë njerëz që rrejnë në mënyrë patologjike? Nuk po flas për politikanët, se ata profesion e kanë rrenën dhe premtimet që nuk i mbajnë, por po flas për njerëz që në pamje dhe sjellje duken krejt normal, ashtu që as psikiatri më i aftë nuk mund të gjejë një pikë të sjelljes jonormale,

por e kanë një shtysë të brendshme, si të alkoolistët, që të rrejnë në mënyrë sa më të përsosur. Për më tepër, nuk dihet këta njerëz a besojnë në atë që rrejnë, apo vetë e dinë të vërtetën, por të tjerëve ua tregojnë rrenën, apo e gënjejnë edhe veten, edhe botën.

Po arti i të rrëfyerit, a është rrenë apo i vërtetë? Akti i krijimit, i fiksionit, ai momenti kur truri yt punon në një nivel tjetër, disa i thonë frymëzim, a është pra momenti kur sinapsat e qelizave nervore kanë një mënyrë pak më ndryshe të funksionimit, kur krijon heronj fluturues, njerëz e qenie mbinjerëzore, a është ai një moment i krijimit të një farë lloj rrene? Rrenë e kam dëgjuar, rrenë po e tregoj.

Kur tregonte për gjyshin tim, im atë nuk thoshte kështu. Babai, më sa e kam njohur, nuk ka qenë nga ata tipat me sindromin e Baronit Münchhausen. Së paku unë nuk e kisha vënë re e vërtetur se im atë rren në mënyrë patologjike. Por, mua, si djalë i ri, si tip dyshues nga natyra, gjithmonë më

shkonte mendja se mund të kishte diçka të shtuar, diçka të paramenduar e të zbukuruar në rrëfimet për jetën e Gjyshi Ali. Gjithmonë, si fëmijë, kur dëgjoja ngjarje të jetës së të parëve të mi, gjithnjë iu jepja një ngjyrë përrallore. Kur e pata kuptuar se e vërteta historike dhe përrallat kishin të përbashkët vetëm kohën e shkuar, kisha filluar të mendoja se cilat ishin historitë e cila përrallat që kisha dëgjuar. A ishin përralla apo të vërteta ato që Gjyshi Ali i kishte treguar babës, e ai mua? Mundet që edhe në mendjen time të jenë ndryshuar, sepse edhe unë njeri jam. Nëse në kohën kur babai tregonte se si Gjyshi Ali kishte shëtitur bregut të detit në Selanik në vitet e para të shekullit njëzet, ka mundësi të kem qenë duke lexuar një roman romantik, romancë të një romancierit që mu kanë përzier fiksioni i tregimit me fiksionin e romanit në lexim, e të mos mund ta dallojë si njeriu që nuk mund ta dallojë me sy sheqerin kur tretet në sherbet, por e dallon vetëm kur ta shijojë?

E mandej, a nuk ju ka ndodhur që një ngjarje që e keni përjetuar, ta keni ndjerë fenomenin "deja vu"? Të keni përshtypjen se e keni përjetuar edhe një herë tjetër, sikur keni qenë në atë vend, sikur keni takuar po atë person? Ndoshta kjo ka ndodhur në ëndrra, ndoshta ka ndodhur në pjesën e ndërdisjshme të funksionit të trurit tënd.

Rrenë e kam dëgjuar, rrenë po e tregoj. Pastaj, vjen diçka që e përligj: "Çdo ngjashmëri me persona dhe ngjarje është e rastësishme", ia futë autori në fillim të tekstit, për të arsyetuar përzjerjen e së vërtetës me rrenën në kështin që pason. Hamamin e Hyrës, asgjë nuk është e rastësishme. Gjithçka është e planifikuar dhe e qëllimshme, si pjesë e një Plani të Madh. Vetëm se ne nuk duam të jemi të vetëdijshëm për këtë, prandaj kemi shpikur artin, procesin e krijimit, për të arsyetuar këtë lloj kryengritje ndaj kufizimeve që na jep realiteti. Prandaj, tregoni rrena, le të jenë të bukura dhe të mos bëjnë dëm...



Shënime nga udhëtimet në memorie

# MITRUSH KUTELI, SHKRIMTARI I PËRJETSHËM

Proza e tij shkëlqente në sënduk, ai ishte i vetëdijshëm se prej librave që kishte botuar para çlirimit po ushqej një aradhë e tërë shkrimtarësh



Nga Roland GJOZA

Nuk e di ç'më kishte shkrepur të merresha me shkrimtarët minorë të viteve 30-të. Aty përfshihej dhe Mitrush Kuteli. Prej tij, pikërisht prej Kutelit e zgjodha atë temë. S'ke për të marrë notë të mirë, më tha profesori i letërsisë së huaj, nuk ke shumë të dhëna për ta, s'ke ç'thua. Pra, Kuteli përfshihej te shkrimtarët minorë. Kjo më habiste, madje më trondiste fund e majë, më dukej si një keqkuptim i qëllimshëm. Ashtu ishte. Hiq dorë nga kjo temë, ose të paktën me Mitrush Kutelin mos u merr, ai ka qenë ushtar në armatën e Urdhrit të Hekurt. Ç'ishte ky Urdhër i Hekurt? Dhe këtë ma thonte fare hapur një profesor i dëgjuar i gramatikës historike. Ai mbahej hijerëndë, të ngelte në klasë, udhëtonte shumë jashtë. Vetëm një profesor më buzëqeshi dhe më ra supeve: Mitrush Kuteli është më i madhi, për këtë shkak është i dënuar. Ka atë cenin në biografi, që është i sqaruar njëfarësoj. Po vazhdon të harrohet padrejtësisht. Ky ishte Nasho Jorgaqi që e vuante ndëshkimin e madh të Mitrush Kutelit.

Atalanta Pasko, vajza e tij, një pinjollë e denjë e estetikës së tij në kuadrin filmik, (ishte njështrre montazhi dhe regjisorët "grindeshin" për ta patur në filmin e tyre) i ngjante të atit, nuk donte të dukej. Unë e hetoja në rastet kur më lidhte puna me të; një fytyrë e imët me hir aristokratik, një ndrojtje diskrete, një humbje me dashje për të mos rënë në sy, një arratisje edhe kur flitej për të, që zërat të binin në vesh të shurdhër, sepse ajo ishte vërtet një nxitje, po veç e pyetjeve pa përgjigje. Atalanta, i thoja, babai yt më pëlqen shumë. Po pse? Ishte një pyetje aspak sfiduese, po edhe e mençur, sepse ajo kërkonte të dinte atë që s'dinte vetë. E shikojta në sy, më lidhej gjuha, kuptoja me njëfarë paniku se idetë e mija për të i kisha të pasistemuara. Kam një baxhanak orëndreqës, i thashë duke përdorur një metaforë, gjyshi më kishte lënë kujtim një sahat, ia çova për ta parë, ai më tha se ishte i rrallë, tejet i shtrenjtë, i gjithi flori. E ruaj edhe sot si një relikte të përditshme, shpresoj t'ia le trashëgim vajzës. Po pse? Përsëriti ajo pyetjen. Sepse ai e rigjeti gjuhën. Ajo qeshi me njëfarë djallëzie, ose ashtu m'u duk, më tha se shiu kishte pushuar dhe iku. "Xha Brahua i Shkumbanores", "Vjeshta e Xheladin Beut"... të paktën t'ia kisha përmendur si tituj, po pse iku ashtu? Nuk e kuptova

kurrë. Edhe në temën e diplomës kisha marrë tetë, jo dhjetë, siç shpreheja, sepse kisha ngritur lart vlerat e Mitrush Kutelit, madje kisha guxuar të theksoja se, siç kishin dalë nga "Manteli" i Gogolit shkrimtarët e mëdhenj rusë, po ashtu kishin dalë prej "Vjeshta e Xheladin Beut" shkrimtarët e mëdhenj shqiptarë. E kisha tepruar? Jo, aspak, po të mendosh se ai kishte krijuar kryeveprën, një nga majat e pakta të letërsisë shqipe, "Tat Tanushin". Pandi, i biri, mbante çelësin e sëndukut ku ishin dorëshkrimet e shkrimtarit. Do të dalin, Roland, nuk janë pak, ke për të parë së shpejti një kryeveprë. (E kishte fjalën për Tat Tanushin). Pënim kafe në këmbë dhe ai, tejet i qetë dhe i dashur, gati i pajfalë, më shpjegonte shkurt me një emocion si të fshehur, pa e përmbajtur një lot në sy, se babai kishte ikuur thuajse i detyruar. E bija e tij, Atalanta bënte pyetjen: Po pse? ndoshta e tejmanhatur me një prozë që vuante një dënim dhe ende nuk po i shpaleshin vlerat, po përkundrazi, lihej pothuaj kinse në harresë. Ajo, nga bijë e djegur për babanë, që e la të vogël, kishte kaluar në lexuese, nga lexuese në kritike, nga kritike në një Akademi që e kishte emrin Mitrush Kuteli. Në këtë Akademi i kishte mbetur të bënte punën e ruajtës së përkorë dhe ishte bërë e mbyllur, skrupuloze, aspak nervoze, adhuruese brenda saj dhe gati armike jashtë saj, përtej, me botën e heshtjes. Dhe unë naivi, ai gjytyrimi i 8-ës në diplomë, i paralajmëruar për humbjen, po i pabindur prej inkurajimit që më jepte zëri i dytë besnik, nuk u hyja shkaqeve përse Kuteli, ky shkrimtar i madh mbahej ende në karantinë. Sapo që dikush si puna ime i afrohej dhe madje guxonte ta nxirrte prej andej, ndëshkohej. Ishte leximi i Tat Tanushit (në botim "E madhe është gjëma e mëkatit") që më bëri të interesohem për fatin e jashtëzakonshëm të këtij shkrimtari. Ç'kishte ndodhur? I kishin shkuar një ditë në shtëpi dhe i patën thënë: Në emër të popullit je i arrestuar! S'kishte ironi dhe cinizëm më të hidhur t'i thoje një shkrimtari të madh se, populli, pra, personazhet e librave të tij, të gatuar prej dashurisë, qenë ngritur të lidhnin autorin e tyre, po prej dashurisë. Se kështu u tha, gjithçka bëhej që ai të pastrohej nga e kaluara e errët dhe gabimet e rënda që i kishin kushtuar atdheut të punës mjaft telashe me vëllezërit jugosllavë. Kishte qenë aleat me gjermanët dhe armik i tyre, pastaj armik i jugosllavëve. Asgjë s'merrja vesh. Vetëm

diçka të mjegullt dija qysh nga ajo kohë kur, unë, një student i vitit të fundit të Gjuhë - Letërsisë me temën time të diplomës doja t'i hiqja Mitrush Kutelit cilësorin ideologjik që e klasifikonte shkrimtar minor. Jeta ikën shpejt dhe moda flakërin si fushqetë marramendëse nga mëngjesi në mbrëmje dhe ti pret që ajo të shuhet, po ajo është e përditshme për fatin e talenteve të vegjël. Sërisht humbi shkrimtari im i dashur, s'përmendej asnjëherë, nuk botohej, veç rrallë, gazetat dhe TV-të mbusheshin ngjeshur me politikë, politikë dhe sërish politikë. Sikur demokracia të kishte ardhur vetëm për politikën.

Shpërtheu me fanfarë festive, me një reminishencë topash lufte raca e politikanëve që u shumua kaq shumë, sa shtëpitë tona u bënë të vockla dhe ne u shndërruam në thërime, ndërsa hapësirat jetike i pushtoi madhërishtëm si piramidat e Gizës, Parlamenti, Kryeministria, Presidencia. Në këtë atmosferë tejet mbytëse për artin e papëfillur unë mendoja e mendoja me vuajtje për shkrimtarin tim të dashur. Sa herë shkoja në Pogradec dhe xhiroja dokumentarë pyesja për shtëpinë e tij. Ajo e Lasgushit ishte shitur për një krodhe bukë, ndërsa ajo e Mitrushit nuk gjendej, megjithëse unë u enda për kohë e kohë të gjata në kalldrëmet e qytetit të vjetër në kërkim të një shtëpie tipike pogradecare që kishte këmbë dhe bariste me një shkop sokakëve ku molloisnin plaka me të zeza. Ai pak qëndroi në shtëpi se ishte i ikuur. Bukuresht. Student në Ekonomi. Atje zuri brumët e atyre plakave të sokakëve, e atij liqeri blu me koran e belushkë, e atyre maleve me borë, e atij malli të ngrysur, e udhëve vetmitare me nga një diell në cergë e hënë të fjetur në gjurmët ajrore të nositit, me kisha ku dylli i qirinjeve në kalldrëmet e plasura vinte nga çdo shtëpi. Brumi erdhë e u fry, u poq e doli, po ai e dinte se nënë Elena me nam për brumërat e saj ishte ku e ku me të, prandaj s'u ndje, po sa herë kthehej në qytetin me ujë, i vinte veshin kallëzimeve, si shqiptoheshin, ç'lezet u kish akcila fjalë, se edhe fjala kishte shpirt dhe shpirti i fjalës duhej kuptuar, po me vuajtje e më durim, veç nga herë me dëshirë e punë që të pajtohej kallëpi i shpirtit me fjalën e sokakut. Këtë bëri dhe fare s'u ndje gjer në mbyllje të qepallës me vetëdijjen se nënë Elena ishte ku e ku me të. Janë ato plaka sot e nesër s'reshitin së dali para portave herë me petë të tëhollura hollë nëpër duar, herë me kaçamakun e miturakut qepur pas fustanit të zi pahitur me pak mielli. Ato s'dinë asgjë se si mund të jenë aq tërheqëse për një që kthehet me qillota e kapelle xhentëlmeni nga Bukureshti. Ai i shikon e u thotë ta përsëritin atë fjalë që shqiptuan, po ato si të llastuara e të gabuara përsëritin gjetet e vajzërisë, aq i ëmbël e miklues është ai zë. Flasin e flasin dhe s'e kuptojnë si ai djalë aq i pashëm e i urtë, u vë veshin llomotitjes së tyre që del prej asaj goje të vënë, si i shkëlqejnë sytë e u përhin atë djaloshin tebdil të asaj kohe që u mori mendjen e iku në mërgim. Kështu iknin djemtë, po ky ishte ndryshe, veç u zgjonte kujtime të moçme me atë afrim dhe mahnitje që tregonte, po dhe i zhgënjente sapak, se ai s'kërkonte atë që ato pandehnin, peng i mbetur hidhur prej motmotit, po luste fjalën e tyre, atë rrëfimin popullor, thurur me penj të artë. Secila prej plakave kishte ndonjë xhevahir për të nxjerrë dhe ai u ofronte një guaskë që e mbante në pëllëmbë të dorës dhe kur ato mbaronin ai mbyllte kapakët e asaj guaske vezulluese e shkonte, ikte i bekuari dhe ai në kurbet. Po s'qe si të tjerët, jo, qe ndryshe, u merrte

fjalën, ja, kaq. Ata, mavritë, ata të tjerët, të merrnin zemrën dhe hiç, s'u bëhej ta kthenin. Plakat e sokakëve s'e kuptonin, korbat, që zemrën e paskeshin patur te fjala dhe vjedhësi pat qenë ai i Paskove, ai që e mbanin për deli djalë. Kështu kish ngjarë me Mitrushin, kishte pasur shtëpi të gjitha shtëpitë me sokak të Pogradecit ku dilnin plakat me të zeza. Po këtë nuk e tha. S'kish si ta thoshte. E pse ta thoshte kur s'ia kaloi e s'ia kaloi dot Elenës. E pati dhe ai një më të madhe se veten. Po t'ia thonin Elenës këtë thagmë, ajo do të qeshte me gaz e s'do të pushonte së qeshuri, se s'do t'i besohej kurrsesi të ishte më e madhe se Mitrush Kuteli i librave të shtypur të lidhur që kishin nga pas dhe atë çmimin sa një buke dyzeçe, se aq kushtonte një libër i trashë sa Xinxifillua. E, sa e koklavitur kjo puna e librit! E shkruan dhe ke brenda jetën e tjetrit treguar nga një tjetër.

Ai Xheladin Beu aty në sokak në ndajnatë ndanë liqenit bëri këmbë nga goja e mëmë Jorgjicës e u shtua prej ndrikullë Anës, që e pat dëgjuar nga e veja e Paput, po edhe ajo se kish patur me tamam, se e veja e furrxhiut, Kulja, e dinte ndryshe fundin e beut dhe e rrëfeu, po u kundërshtua me bubutimë nga mëmë Sofika, që qeronte patate në sokak dhe nuk mënoi të përshkruante natën e parë të beut me Sheqeren dumbushqerre më parë se ai të binte në jatak me atë të brydhtënt virgjëreshë, çupkë e bardhë borë, e plotë, pa fare naze e zjarr të ndezur, krejt e pa vënë dorë, si ajo kukulla e mbyllur në kuti. Një version rrëzonte tjetrin, po të gjithë ishin art i pasitur, krunde plot, guricka e barishte, po ama miell, miell nga ai lloj që bëhet bashbakllava e dasmave dhe ato bukët me zemër brenda që i jepeshin pa gdhirë bashkë me një copë kartë atij tebdilit allafërnga që nisej sërish për kurbet. E dija këtë ecejake të Mitrushit nëpër portat me llamburitje të dridhshme liqeri, nëpër portat e drunjtave me shkurre trëndafilash e kalldrëmet me kisha të vogla dhe më vinte të thërrisja: o, po ku është shtëpia e Mitrushit? Askush s'ta tregon, sikur harresa të jetë shtrirë prej zakonit dhe mbi shtëpinë e tij të lindjes. Kjo duket kaq poetike sa s'ke ç'mëson më tepër. Po veç një gjë duhet të dimë, se ai mori stilin e të rrëfyerit të sokakëve. Mund ta quajmë stili i sokakëve. E mori me vete në Bukuresht, se atje nis të shkruajë prozë, pikërisht ditën që e veshën ushtar, merrni me mend, një student i thirrur me urdhër ushtar në armatën e Urdhrit të Hekurt të mbretit rumun, që për fatin e tij të mbrapshtë ishte e inkuadruar si aleat në ushtrinë gjermane. E çfarë pastaj? Ai luftonte për Rumaninë dhe s'i interesonin aleancat. Këto i mësona në arkivin e Ministrisë së Brendshme. Një dosje e hollë, ku më tërhoqën vëmendjen tre fakte. Në kohën e pushtimit gjerman Mitrushi punonte në bankë. Kundërshtoi grabitjen e arit dhe u përndoq për t'u vrarë. Tema e diplomës që kishte mbrojtur në Bukuresht për doktoraturë në Financë ishte rreth 400 faqe. Në kohën e Partisë së Punës ishte kategorikisht kundër që dinari jugosllav të shkëmbehej me ar. Në qeli, krejt i paqartë për motivet e akuzës, ose më mirë krejt i bindur për absurditetin dhe keqkuptimin, në rrethanat e asaj kohe kur ai që futej në burg mernte më qafë familjen, preu damarët e duarve që të vdiste. Këtë e bëri që të shpëronte gruan dhe fëmijët nga turpi, poshtërimi, ndalimi i të drejtave, arsimimi, uria, e ardhmja e errët. Ndërkohë që bënte vetëvrasjen e sigurt, një nga rojat i solli ushqimin një orë përpara, ngaqë atë ditë ishte festë, dhe ai nuk bëri sikur s'e vuri re qëndrimin e tij të çuditshëm: i ulur në gjunjë, i mbledhur kruspull, i verdhë dyllë



në fytyrë e me sytë lart, ndoshta duke lëshuar një lutje të fundit drejt atij tavani të qelbur për t'ia përcjellë qiellit. Rëndon në këto raste njeriu që po ikën bëhet i ngjashëm me frikën që na pushton herë-herë kur vdekja na vjen si parandjenjë. Ndoshta kjo arsye mund të qe njëra nga ato nxitje vullnetare që e kaplojnë njeriun për veten, po në raste të tilla për tjetrin. Ky keqkuptim nganjëherë është shpëtimtar. Roja e pikasi me vërejtje dhe zbuloi gjakun që i rridhte poshtë. Mitrushi shpëtoi. Po asgjë nuk ndryshoi, mendimi i parë i vetëvrasjes veçse u shty në kohë. Atë e lanë të përkthente, vetëm të përkthente dhe urdhri i pashpallur ishte të mos shkruante e botonte libra origjinale, veç rrallë e në kohë oportune.

Proza e tij shkëlqente në sënduk, ai ishte i vetëdijshëm se prej librave që kishte botuar para çlirimit po ushqej një aradhe e tërë shkrintarësh. Heshnja për këtë nga vetja, pak zhurmë andej nga përkthimi ku ai dilte me emrin e vet, Dhimitër Pasko, si për t'iu thënë se aty ishte i vërteti. Gjysma reale e sëndukut u mbyll me kyç dhe kyçi iu dha djalit. Merre, bir, ndonjë ditë hape dhe kujdes, shumë gjëra ndoshta nuk janë thënë mirë, kanë nevojë dhe për një dorë... Unë e di si po iki pa i parë vetë... po jam i sëmure... dhe... Këtë të fundit nuk ia tha. Po veç miqve me një gjysmë zëri. Ai ishte vërtet shumë i sëmure, më tepër prej heshjes e harrimit. I përkorë dhe skrupuloz si për vete dhe në përkthim: "Shpirtra të vdekur" e "Tregimet e Petërburgut" të Gogolit, "Rruga e Mundimeve" trilogji të Aleksej Tolstojit, "Kujtimet e një gjahtarit" të Turgenievit, "Tregimet" e Gorkit, "Vërshimet e lumenjve" të Paustovskit, "Zotërinjtë Golloviove" të Shçedrinut, e shumë e shumë të tjerë për të siguruar bukën e gojës në një vetmi e izolim prej murgu. Nuk duhej as të shfaqej. Në një kohë kur asgjë s'po ecte në familjen e tij, po vetëm pengesa e kufizime pafund, ai e kuptoi me intuitën e shkrintarit të madh se qenia e tij ende e gjallë, ishte pengesë e pakapërcyeshme për fëmijët. Merreni me mend çfarë tragjedie: një njeri kaq i ditur, një shkrintar i përjetshëm, një shpirt i vuajtur gjeniu, i detyruar të jetojë në harrim dhe i pëshpëritur të ikte e të humbte në harrim të harrimit, pra, i përfolur kaq shumë për ekzistencën e tij fizike, merrte sinjale e mbushej me parandjenja se në këmbim të familjes, të një dritëze për ta, duhej të sakrifikohej përfundimisht. A mund të besohet? Kurrsesi. Po sigurisht që besohet. Ky antagonizëm i përçudshëm ishte vetë koha. E di dhe berberi i tij, Faja i Broduejt, i asaj rrugës që kishte një pikë te Xingoni dhe një pikë tjetër te këndi e pazarit të vjetër. Aty vërtiteshim në ditët e tij të fundit. Faja e dinte, se atij i hapeshin të gjithë, ishte një burrë i madh i bukur si ato personazhet e "Tre shokë", të Remarkut, shumë i trishtuar, shumë i sëmure, më tha se më linte peng flokët e fundit. Kur le flokët, le fuqinë. Duhet të largohem përgjithmonë, Faje. Faja nuk fliste, shprehja e fytyrës së tij shprehte shumë, sipas gjendjes, ajo ishte ngushëlluese, ironike, dashamirëse, po gjithmonë besnike. Nuk më la bakshish. Ishte hera e parë që nuk më la bakshish. E kishte humbur. E kuptova që s'do ta shihja më. Po unë nuk e dija rëndësinë e tij, po veç e ndieja se më ngjallte shumë respekt. Pastaj Faja më kishte treguar diçka tjetër që më bëri përshtypje: Faje, më tha, po ecja në rrugën time, ra errësira dhe dola, frymëmarrja po më mundonte, isha shumë i trishtuar, kur një njeri ndaloi, më ndoqi dhe më pëshpëriti: Akoma gjallë je ti? Dhe skërmimi dhëmbët. Turpi ishte gjëja e parë që ndjeva, ai më vriste më shumë, turpi. Është viti 2010-të, kaloj nëpër Nju Jork me tren, me autobus, me makinë, më këmbë, Mitrush Kuteli është shkrintari që më vjen më pranë, e ndjej më shumë, them me bindje të plotë se ai më tepër se kudo ndjehet dhe shijohet plot e përplot në mërgim. Nuk di si ta shpjegoj, ndoshta kjo ndodh nga malli, se ai është shkrintari i përjetshëm që di të përshkruajë mrekullisht Shqipërinë e përjetshme, për të cilën ne nganjëherë na zë frika se mos e harrojmë.

Nju Jork 2010

## Shqyrtime

# UNIVERSI POETIK POPULLOR

**Nëse Homerit do t'i duheshin 24 këngë dhe rreth 15 mijë vargje për të lartuar dhe gdhendur bukurinë e Helenës, poetit tonë popullor i janë dashur vetëm tri vargje**

### Majlinda Nana RAMA

Nga buronjat e pashtershme të gurrës popullore, si gurë mademi e hejbe të rënda, rrjedhin vargje e këngë të ndezura prush. Ato s'janë gjë tjetër, veçse trashëgimi elitare e thesareve tona me rrënjët në popull. Të tilla janë vargjet:

Hanko mos kalo mbi varre se të vdekurit i ngjalle të gjallët i vdiqe fare.

Nëse Homerit do t'i duheshin 24 këngë dhe rreth 15 mijë vargje për të lartuar dhe gdhendur bukurinë e Helenës, poetit tonë popullor i janë dashur vetëm tri vargje. Dhe, sikur edhe Hanka të përvijohet në po kaq vargje sa Helena, për të do të hynte në luftë jo Evropa me Azinë, por një botë e tërë! Në një luftë të pasosur në kërkim të pronësisë të Hankos. Po ç'ishte kjo Hanka? Një Hanka Tepelene, Përmeti? Vlore? Cila ish kjo magji që "mbyti" bukuroshët dhe trimat e çartur që s'u ndahej kënga buzës? Për origjinën e Hankos ne nuk dimë asgjë, por, padyshim që çdo zonë jugore do të donte ta kishte të vetën. Ajo, Hanka, që shkonte e vinte nëpër varre, ajo që vdiste të gjallët që e shihnin në çdo copë dheu e toke. Po kush ishte kjo grua? Ç'qenka kjo Hanka që zhbilancën botën, përmbys rende, ngjall të vdekur e vdes të gjallë? Eh, ku shkelte këmbë e saj! Këto janë vetëm tri vargje, por mbajnë brenda tyre një oqean plot margaritarë. Vështirë se mund të gjejmë një të dytë me një harmoni të tillë! Në këtë trivargësh, kemi vetëm një Hanka të papërcaktuar. Ç'thuhet për të? Si i kishte buzët, flokët? Po qerpikun, dorën, po syrin? Asnjë grimë fjale për të. Por ama, vargjet na lënë shumë pak vend të për të pritur përcaktimin, klasifikimin e Hankos si kulmin hieror të bukurisë

femërore. Ajo, edhe pse në asnjë vend nuk thuhet, vjen gjithë sharm dhe nur, dhimbjebukur, shpirt i valë dhe ulërimë. Ajo del mbi nimfat, mbi vitat, mbi peritë. Autori popull paralajmëron qysh në hyrje, tekta shfaqet si një klithmë e thekshme, për të zbritur pastaj në intonacionin gati përlutës, pjesëza "Mos!": Mos! Mos u bëj e marrë të çmendësh gjithë botën. Mos lësho pé nga hiret e tua!

Hanko mos kalo mbi varre...

Një tabelë që "ndalonte" vetëm hyrjen e Hankos. Mendoni një çast: Ndalohet kalimi vetëm për Hankon! Duhej të ndihej e diskriminuar Hanka, apo...? Po ç'donte kjo bukur "vrasëse" në territore të pushtuara nga shpirta pa trup? Pse ekzistonte kjo frikë? Ajo mund të ecte me hapin aristokrat në qytet, në trotuare dëshirash, ku t'i ngashënjente tejpërtej të gjithë, pa përjashtim: të rinj e pleq, zeshkanë e biondë, burra e djelmoha. Cili ishte pengi i saj i mbetur kopshtit të përhershëm njerëzor? Ndonjë i afërm i iku, ndonjë familjar apo ndonjë i ri që i kish cekur zemrën thellë dhe e kish lënë të shënjuar? Cilado qoftë arsyeja, Hanka ishte rrezik evident të shkelte në varreza; ajo rrezikonte ta pushtonte armatën e të heshturve, t'i ngrinte që aty e t'i skaliste me dëshira të valëta, për t'i kthyer në ëndërrimtarë të flaktë e për t'i spërklitur me aromë bukurie. E, natyrshëm, pasi jepet paralajmërimi, vjen shpërthimi i frikës si epidemi shoqërore që rrezikonte të mos nginjej me këtë dukuri femërore të pashoqe.

...se të vdekurit i ngjalle!

Ah, sikur! Hanka duket se ia dinte sekretin këmbës së saj, ia njihhte skutat e zjarra hapit të

saj. Ajo ishte e vetëdijshme për pushtetin mbi këtë territor si plantacion lulesh, qëndisur me gur varresh për prehje nën kokë. Cilët ishin ata? Kalorësit e rënë në luftë? Ishin ata që vijin në gjumin e vashave? Po Hanka përballë tyre? E rrezikuara? Imune? Cili do të ishte fati i mëpastajmë i saj? Në mbyllje, krijuesi do të na sjellë ata. Ata që mund ta preknin këtë bukuri përrallore. Ata të rinj poterexhinj e gazmend që fshiheshin pas perdeve, pas pemëve, pas ndërtesave për të parë pakëz Hanka.

...të gjallët i vdiqe fare!

Buçimë shpirti... Po, i vdiqe fare?! Ç'është ky varg pleonazmik, me këtë përmbyllje brilante përmes "i vdiqe fare"? Mirë që paskan vdekur, po paskan vdekur plotësisht, fare, fare. Hata e ardhur nga një Hanka. Ç'qe kjo gjëmë?! Por, me gjithë "kobin", kalimtari i fundit që do të shkante asaj ane, i gjalli mbi dhé, do të psherëtinte në formën e një amaneti:

Hanko syrin vetëtimë, më vdis, në dhé të gjallë, shtirmë!

Sepse për Hankon ndërronin stinët, dimri bëhej maj, magjishëm nga pluhuri i këmbës së saj. Pikërrimë! Ishte ajo që vdiste të gjallët e ngjallte të vdekurit... Poeti popullor nuk mund të jepte më shumë, tekta përgjonte hapat e saj fërfërimë, që e vdisnin për t'u ngjallur sërish kur ajo të kthehej. Asnjë varg më tepër! Të gjithë e dëshironin këtë invers, këtë vdekje-ngjallje. Të gjithë e dëshirojnë edhe sot. Hanka është nënëri i çdo vajze, brenda psherëtimit: "Ah, sikur të isha një Hanka!". Jehona e Hankos mbetet si një legjendë në repertorin e artë të folkut tonë. Nuri i kësaj bukurie udhëton në shekuj.



# HISTORIA SHQIPTARE SI DILEMË EKZISTENCIALE


(Përkitazi me romanin, "Ismaili, një histori shqiptare" të Gëzim Ziles)

Nga Lazër STANI

E çliruar nga diktati i skemës së realizmit socialist dhe aparatçikët e sistemit të censorëve, letërsia shqipe e këtyre shtatëmbëdhjetë vjetëve, në përpjekje për të refuzuar turpin e kompromisit të vet me regjimin dhe ideologjinë e tij, si një refuzim ndaj vetvetes dhe asaj që konceptohet si traditë, zgjodhi dy rrugë për rimëkëmbjen e vet: një grup autorësh në moshë relativisht të re rendën pas shkollave moderniste letrare, me shpresë se kështu do të afirmojnë vetveten ndryshe, duke mohuar çdo lidhje me realitetin shqiptar; grupi i tjetër ndoshta më i paktë në numër iu ri kthye realitetit të mohuar, duke përshkruar me nota të ashpra e dramatike. Ky grupim autorësh krijoi një lloj realizmi tjetër, realizmin demokratik, që në vetvete ishte realizmi socialist i kthyer me kokëposhtë.

Në të shumtën e rasteve të dyja tendencat u përcollën me dështime, sepse letërsia në asnjë rast nuk është një makinë që herë ngitet në krahun e majtë e herë në të djathtin, dhe as një biçikletë cirku me të cilin mund të prodhohet një spektakël ekzotik. Në këtë kaos të vlerave dhe brenda kësaj çoroditjeje eksperimentale dhe konceptuale, herë pas here autorë të veçantë arritën të krijojnë vepra letrare të mbresëlënëse, në poezi dhe prozë, duke shfaqur secili një individualitet të vetin, shpesh larg syve të publikut dhe të medias, por gjithsesi tërheqës e befusues dhe njëkohësisht sfidues për një kohë, kur pak kush e ka mendjen të letërsia. Dhe një ndër befusuesit e bukura të këtyre kohëve, ka qenë leximi i romanit të Gëzim Ziles "Ismaili, një histori shqiptare", një libër që përveçse e kam lexuar me një frymë, më ka futur në mendime për një kohë të gjatë.

"Ismaili" i Gëzim Ziles, është një libër që lexohet me një frymë, është rrëfim për jetën njerëzore në njërin prej momenteve më të brishta dhe formuese të saj, rrëfim për kapërcyellin ndarjes nga fëmijëria dhe ardhjen nervoze të rinisë së parë, një histori e rrëfyer rrjedhshëm, me një gjuhë të pastër e të pasur, plot densitet dhe tension dhe mbi të gjitha është një histori e mirëfilltë shqiptare. Ismaili, personazhi kryesor i këtij libri, është një fëmijë shqiptar si shumë të tjerë, energjik dhe i etur për aventura, guximtar dhe inteligjent, kureshtar dhe i pabindur, nxënësi i pasionuar dhe fëmijë i rrugës. Ai është plot jetë, trupi nuk i zë vend dhe mendja e tij ka një fantazi të papërbalueshme, por gjithçka zhvillohet brenda një territori të kufizuar, jo thjeshtë në hapësirë fizike, por në mundësi dhe liri. Dhe mbi të gjitha, në këtë hapësirë ku çdo dëshirë shtypet nga një "Jo" ose "Mos" kërcënues, shtrihet hija e një dhunës, që nuk është thjeshtë vizorja e mësuesit apo një pëllëmbë e babait, por një e keqe shumë më e madhe që qëndron në sfond si një re e zezë, e gatshme të gëlltitë secilin veç e veç ose të gjithë së bashku. Kjo hije dhune që gjithnjë ndihet e pranishme si sfond, që në fund të fundit është një dhunë shtetërore e padukshme, por njësoj kërcënuese dhe e frikshme, i ka tkurrur të mëdhenjtë, i ka bërë ata të heshtur dhe fjalëpakë, ndërsa fëmijët i ka privuar nga dashuria e prindërve dhe mundësia për të gëzuar një fëmijëri normale. Ismaili, nuk është as më i mirë e as më i keq se të tjerët, sepse në fund të fundit, edhe ata që do të bëhen, vjedhës, vrasës, kontrabandistë, kriminelë, të gjithë kanë lindur fëmijë dhe njeriu, siç shkruante Balzaku, "nuk lind as i mirë dhe as i keq. Ai lind me instinkte dhe aftësi". Ismaili është njëri nga këta fëmijë që, siç e përshkruan autori, "me një çantë të vogël



prej robe të qepur nga e ëma, Labikja dhe pantallonat e shkurtra dalëboje, nisej çdo mëngjes për në shkollë, i ndjekur nga shokët e shumtë që nuk i ndaheshin. Nuk ishte veshur asnjëherë në jetën e tij prej 12 vjeçari pantallona të gjata".

Që në faqet e para të libri Ismaili na shfaqet si një fëmijë lider, që gëzon besimin e të tjerëve, për guximin, ndershmërinë, shpirtin e aventurës dhe vendosmërinë, tipare të një karakteri të fortë në formim, të një arketipi të lirë, që edhe në konfrontohet me dhunën e vazhdueshme nuk nënshtrohet, po udhëhiqet nga impulset e tij të brendshme që e nxisin për aventura, mbrapshti, kokëshkrepje që për ambientin janë të papranueshme dhe të ndëshkueshme. Po kaq të pafajshëm dhe aventurierë, duken edhe bashkëmohatarët e tij Ristua, Gjoshja, Lalani, Fatriu, por edhe vajza që i shkaktoi emocionin dhe hutimin e parë instinktit të tij prej mashkulli, Tatjana, çapkenia e hedhur e mospërfillëse. Edhe pse paguan vazhdimisht për aventura e tij prej vagabondi të vogël dhe pa të keq, ai asnjëherë nuk nënshtrohet, përkundrazi një aventurë, si futja e hardhucave në çantën e bukurshes Tatjana, ndiqet nga një aventurë tjetër, si grabitja e pjeshkave të fermës, apo grabitja e ndonjë fruti në kopshtijet e lagjes, atje ku pleq të sertë e të xhindosur ishin të gatshëm të hakmerres-

hin me një dhunë shtazarake. Por, Ismaili në vetvete nuk është i keq, nuk është i padrejtë dhe mbi të gjitha nuk ndërton marrëdhënie të dyshimita me moshatarët. Kjo e bën atë të dallueshëm prej të tjerëve, një rast të veçantë, që herë e bën ta quajnë vagabond, e herë ta shikojnë si një fëmijë të dalë duarsh, që herët e vonë do ta paguajë me shpinën dhe kokën e vet.

Autori nuk ndalët të bëjë analiza të momenteve psikologjike të zhvillimit të personazhit, por ai vetëm rrëfen ngjarjet, duke ia lënë lexuesit të receptojë dhe të interpretojë, sepse siç shkruan Keith Çesterton shkruantari i mirë gjithmonë na rrëfen të vërtetën rreth heroit të tij. Por nga kjo e vërtetë e rrëfyer pa paragjykimë ne gjejmë një Ismail, i cili duke jetuar në një realitet të vrazhdë përballet me dilema të thella, që në shumë momente e bëjnë ekzistencën e tij dramatike: është momenti kur ai nga një histori në tjetër mësion të vërtetën e hidhur të jetës, brutalitetin dhe egërsinë e saj, pabesitë dhe marrëzitë, pasionet dhe epshet, shturjet dhe degradimin, kompromiset e vogla dhe dinakëritë, që të mbledhura së bashku krijojnë sfondin mbyttës të qytetit ku atij i ka takuar të jetojë. Por,

, energjik dhe plot jetë siç është Ismaili, nuk ka kohë të dëshpërohet. Ai kalon nga një aventurë te tjetra me një guxim prej të

marri, i gatshëm të ndeshet çdo ditë me rrezikun për të sfiduar atë që është e ndaluar, atë që qëndron prapa çdo kufiri të vendosur dhunshëm. Dhe në këtë klimë shtypjeje dhe dhune, zgjohet edhe ndjenja e hakmarrjes, kur Ismaili në prag të burrërimin, vendos t'i vërë zjarrin gjithë lagjes "për inat të prindërve që i rrihnin fëmijët, për çdo të keqe që ata bënin". Dhe pas këtij akti aventuresk vjen edhe akti e parë të burrërimin, kur Ismaili shpall kërcënueshëm vendimin e tij të parë prej burri: "Nuk dua të më prekë më njeri më dorë". Me këtë frazë dramatike mbyllet edhe ky roman i Gëzim Ziles, një roman që të fut në mendime të thella. Sigurisht që për frymën totalitare dhe të dhunshme të një shoqërie dhe për traumat që ajo krijon të anëtarët e saj është shkruar shumë. Moris Dryon pati shkruar se një shoqëri nuk mund të jetë e lumtur kur disa nga anëtarët e saj vuajnë. Për shkrimtarin kjo vuajtje nuk është statistikë, ajo është fati ose më mirë të thuash, fataliteti i një individi të vetëm.

Duke lexuar romanin, njëkohësisht lexuesi ndërmerr një udhëtim eksplorues brenda një shoqërie, që është tipike për qytetet shqiptarë të viteve pesëdhjetë. Nëpërmjet leximit ne njihemi me fatin kolektiv të një shoqërie mbi të cilën shtypja dhe varfëria thellohen çdo ditë dhe ku ankthi i mbijetesës, ankthi i ekzistencës, e shton edhe më shumë shtypjen e vet. Kjo i ka çuar drejt ndrydhjes totale edhe ndjenjat më të thella njerëzore, siç është dashuria e prindit për fëmijën. Një prind, siç është rasti i Kasemit, babait të Ismailit, që robtohet në punë për të siguruar mbijetesën e familjes, nuk ka kohë të japë dashuri, jo pse ai nuk e ka këtë ndjenjë brenda vetes, por sepse kjo ndjenjë është e rrezikshme. Fëmijët e rritur me lirinë që jep dashuria, do të përfundojnë në individë të rrezikuar në të ardhmen. Për të siguruar mbijetesën, që është instinkti bazë i çdo qenieje të gjallë, ai duhet të rritet i privuar nga kjo liri e dashurisë, sepse vetëm kështu individi i ardhshëm do të jetë i modeluar sipas rregullave të kohës.

Kjo logjikë e imponuar nga rrethanat dhe mentaliteti i një shoqërie konservative, ku liria ka munguar pothuajse gjithmonë, e ka bërë baballarët të ashpër dhe brutalë me fëmijët. Kjo është edhe linja kryesore e konfliktit Ismail-Baballarë, ose fëmijë prindër, që në rastin e Ismailit nuk arrin të gëlltitet dhe provokon rebelimin e vazhdueshëm ndaj rregullave dhe kufizimeve të kohës.

Në tërësinë e vet romani i Gëzim Ziles, "Ismaili, një histori shqiptare", është një vepër provokuese për dilemat më të thella që ekzistojnë brenda qenies sonë, për udhëkryqet që vazhdimisht na shfaqen në jetë, dhe në në secilin rast vuajmë pasigurinë e zgjedhjes, por edhe për trishtimin dhe vuajtjen e udhëkryqit të katër rrugëve qorre, prej nga nuk ka rrugëdalje. Me gjuhën e tij të pasur me shumë nënshtresa kuptimore dhe i rrëfyer me një stil narrativ të gjallë e plot jetë, ky libër arrin të zgjojë brenda nesh historinë e secilit, e cila në vetvete na ndjek gjatë gjithë jetës dhe na shtyn të arsyetojmë mbi ekzistencën tonë. I shkruar me një dashuri të thellë për Vlorën, për Skelën, njerëzit e saj, për detin dhe për dhembjen njerëzore, romani i Gëzim Ziles, varfërohet duke u interpretuar. Bukuria, thellësia, dashuria dhe ndjenja e tjera njerëzore, bëhen të pranishme dhe perceptohen vetëm duke e lexuar këtë libër, kaq të freskët dhe të vërtetë, sa menjëherë na bëhet pjesë e historisë sonë shpirtërore.




# ANATOMIA E VETËDIJES BRENDA TEKSTIT POETIK

(Mbi vëllimin me poezi "Noah" të Sabit Bajraktarit, botuar nga ShB "Rozafa")

## Zyrafete SHALA

Edhe pse autor i disa librave seriozë në poezi e prozë, Sabit Bajraktari nuk është nga ata krijues që i ndeshim shpesh nëpër faqe revistash, portale, intervista apo takime krijuesish, megjithatë, kjo nuk ishte pengesë që vëllimi i tij i fundit me poezi NOAH, botuar nga ShB "Rozafa", të shpërblehej nga MKRS me çmimin Ali Podrimja, si vepra më e mirë në poezi për vitin 2022. I vënë nën thjerrëzë e analizës estetike e letrare, vëllimi Noah shfaqet si një vepër e pasur, e punuar me përkushtim dhe që meriton vëmendje të veçantë nga kritika letrare. Madje, ende pa u zhytur brenda universit poetik dhe zbërthimit të shtresave kuptimore që ndërtojnë vargjet e poezive brenda tij, është titulli i librit dhe parateksti, ata që na intrigojnë për të kërkuar kahun nga duhet orientuar leximin. Dhe, sapo e marrim këtë informacion, e gjejmë veten duke shtegtuar nëpër stinët e jetës së poetit; jo vetëm për faktin që vargjet e tij vërtet na sjellin copëza që e përbëjnë unën e tij lirik dhe personalitetin human, por ngase stinë i emërton edhe ciklet në të cilat ndahen poezitë e këtij vëllimi: Stina e ikjeve, Stina e kujtimeve, Stina e mjegullave dhe Stina pa ngjyra. Pavarësisht nga motivet që trajtohen dhe tonit që karakterizon vargjet e secilit cikël, si njësi tematike, të katër këto cikle korrespondojnë mes vete në aspektin semantik. Fillimisht shfaqet ikja - si akt që determinohet nga rrethana të caktuara, por që rezultojnë të jetë i domosdoshëm, pastaj vijjnë kujtimet - si e vetmja formë që arrin të mbajë pashkëputshmërinë me vendlindjen, mjegulla - si shënjeshtëri i mjedisit ku dominojnë kaosi, paturpësia e makutëria dhe, së fundi, kur të gjitha mbishtresohen në plagët e dhimbjet e luftës, e kthejnë jetën në një stinë pa ngjyra.

Titulli i librit, Noah, pashmangshëm na shpie në terrenin biblik, më saktësisht te përmbytja e madhe, ku krahas mundësisë për të shpëtuar diçka nga një botë po rrënohej, shpërfaqen edhe veset e virtutet e njeriut, kësaj qenieje kokëfortë, me prirje të theksuar për vetë-shkatërrim. Edhe pse poezia me të njëjtin titull mbase na ofron edhe mundësi të tjera interpretimi, është parateksti (i shkëputur nga krijimtaria e Ragip Sylajt) që na mban në terrenin fillestar: E mori poezinë në dorë si një shkrim të shenjtë dhe tek e lexonte, e intrigonte patjetër dilema, se si do të fliste ajo me njeriun e sotëm e të nesërm, sepse në art edhe nesër është sot... Poeti përveç që na sugjeron t'i qasemi poezisë si një shkrim të shenjtë, duke na dhënë në dorë vëllimin e tij poetik Noah, na krijon aluzionin se është duke na ofruar barkën e tij të shpresës, ku i ruan të gjitha ndjesitë, ëndrrat, gëzimet, zhgënjimet, dhimbjet, pengjet e kujtimet që jeta ia ngarkoi. Ai është i vetëdijshëm se këto përjetime nuk mund të jenë individuale, përkundrazi janë plagë edhe të bashkëkombësve të tij, prandaj mëton t'i përçojë edhe te lexuesi, pavarësisht se cilës kohe do t'i takojë ai. Sepse të jetosh në një botë ku lirisë ia zë vendin djallëzia, ku jeta bëhet urë heshtjesh që lufton me stuhitë, ku të vidhet ëndërr dhe akuzohesh për plagjiaturë, ku luftëtari i lirisë shpallet tradhtar... nuk të mbetet tjetër pos të shpresosh se pas një përmbytjeje



të madhe do të lind një botë më e drejtë. Nga temat që dominojnë në këtë vëllim, padyshim është tema e mërgimit, me tërë spektrin e motiveve që ndërthuren me të, si: zhgënjimi me atë që solli zhgëndrra, ndarja nga trangu, ikja, ëndrrat e braktisura, kujtimet që zhbëhen, pritjet që mbajnë vullën e ikjes, e mbi të gjitha me ndarjen e qenësisë në dy botë. Është pikërisht kjo skizmë që e bën mërgimtarin të ndjehet i huaj në të dyja polet e ekzistencës së tij dhe të cilën poeti Bajraktari e kthen në klithmë, në thirrje për ata që ende nuk e kanë bërë këtë hap: Ikja të bën gur që s'e pranon asnjë themel... / Të sheh dielli dhe nuk të ngroh / të prek dashuria dhe s'e ndien /... Sërish të lutem / Mos ik (Mësim i vonë, f. 10). Edhe pse mërgimi është temë e njohur në letërsinë tonë dhe është trajtuar pothuajse në të gjitha periudhat letrare, mirëpo në secilën prej tyre ka marrë tipare të ndryshme të dhimbjes, ashtu si në poezitë e këtij vëllimi ku para së gjithash, përjetohet si ikje. I parë nga ky këndvështrim, largimi nga atdheu e bën subjektin poetik të lëshohet në zemërimin, i cili, brenda sistemit poetik, arrin të formësohet në akuzë të ashprë ndaj realitetit kosovar: Kam ikur prej helmit tim / Nga gurët që hidhja në qiell / Prej erës së fortë që futej dritareve të thyera / Nga flaka e tradhtisë që mbiu në kopsh-tin tim / Prej emrit të ri që nuk munda kurrë ta pranoja / Nga njeriu që m'i bëri lëmsh stinët rrugët / Prej Zotit që nuk e njihje / Nga inati që më shtrëngonte në qafë / Prej errësirës dhe grindjes ika bre / Ika prej himnit të ri pa fjalë pa emocion

(Dialog, f. 13). Toni i tillë revoltues, që i përshkon poezitë me temë të mërgimit në këtë vëllim, është një tipar që i karakterizon në përgjithësi poezitë me këtë temë, të botuara pas luftës së fundit në Kosovë. Mirëpo, i gërshetuar me përjetimet dhe ndjesitë individuale të secilit krijues, gjithnjë merr konotacion të ri. Tema e kujtesës, e portretizuar në poezitë e vëllimit Noah nga subjekti poetik i mërguar, shërben në radhë të parë si mbrojtje nga dhimbjet e ankthit të ndarjes, por edhe si mundësi për ruajtjen e identitetit individual e kulturor. Janë një varg formash të semantizuara që poeti i hedh në trajtë spirancash për të mos u shkëputur nga trualli i të parëve. Prehri i nënës, si metonimi e shtëpisë dhe vatrës, na shfaqet në poezinë Nëna dhe shtëpia: Kishte shije parajse prehri i nënës / Kur i këndonte këngët e Nexhmi-je Pagarushës / Dhe thurte çorapë me majë të kuqe / Me trikot e shtrembëruara (Nëna dhe shtëpia, f. 46). Imazhi i përsosur i fëmijërisë së lumtur plotësohet më tej me figurën e babait, si personifikim i sigurisë e ngrohtësisë: Ai ishte si shtëpia / Na mbante ngrohtë / Na ushqente... me ëndrra / Që të rriteshim si në përralla / Edhe pse jeta i ngjante një filmi / Mbështjellë me tym e ikje ardhje (Po aty, f. 46). Edhe pse kujtimet janë shumë selektive dhe ripërtëritja e tyre potencialisht duket se i favorizon kujtimet e bukura, duke i mohuar ato të pakëndshmet, ky proces shpeshherë ia del t'i devijojë linjat e kësaj skeme, si në vargun: Na ushqente... me ëndrra. Retiçenca që e ndërpret mendimin i

kumton lexuesit një të vërtetë tjetër nga ajo që shpërfaq litota në përmblyje të vargut. Megjithatë, kur bëhet fjalë për fëmijërinë, kujtesa e zemrës, siç do të thoshte G. G. Márquez: Eliminon të keqen dhe zmadhon të mirat, dhe falë kësaj artifice ne arrijmë të durojmë barrën e së shkuarës.

Absurditetet e botës shqiptare shërbejnë si burim frymëzimi për një varg poezish që si strumbullar kanë zhgënjimin dhe revoltën. Në poezitë: S'është çudi, Kosova pronë e të gjithëve, Liria po kundërmon, Vendlindja po zvogëlohet, Makutët e pasluftës e disa të tjera poeti sjell tablonë e deformiteteve që tash e më shumë se dy dekada me radhë po e ngulfasin lirinë. Skenat që e materializojnë imazhin e errësirës në të cilën është zhytur atdheu, janë po ato që e kanë sflitur edhe subjektin krijues: E dogjën timen jetë si me zjarr vullkani / Më janë thinjur ëndrrat / Më janë shterur fjalët / Kam harruar fytyrën e ish së dashurës sime (Kosova pronë e të gjithëve, f. 28). Ndjesitë e tilla i bëjnë edhe më të dhimbshme përjetimet e hidhura të luftës që nuk reshtin së qeni vatra prej nga buron dhimbja dhe gjithashtu, vatra gjeneruese të makthit pa fund: S'e di nëse njerëzit që mbetën pa të dashurit e tyre / A e kanë pranuar lirinë që po e shohin me sytë e mi / S'e di nëse e ka larë dheun shiu nga gjaku i freskët (Vendlindja po zvogëlohet, f. 67). Prej këtu merr kuptim edhe më të thellë dikotomia ëndërr / zhgëndërr që në vargjet e këtij vëllimi sugjeron një marrëdhënie absurde, sepse: Është e vështirë të jetosh në zhgëndërr / Po nuk pate një ëndërr e cila të bën të fluturosh (Po aty, f. 67).

E shikuar në totalitetin e saj apo e ndarë në njësitë kuptimore të veçanta, vepra Noah e Sabit Bajraktarit vjen si një si tekst poetik brenda të cilit shfaqet anatomia e vetëdijes së kohës sonë, gjegjësisht e vetëdijes së njeriut tonë. E atij njeriu të cilit, forcat tronditëse të traumës së përjetuar në kapërcyellin mes dy shekujve i shpërfaqen ëndrrat dhe e vunë përpara dilemave të reja. Prandaj edhe konfiguracioni i hapësirës poetike është i ndërtuar kryesisht mbi kuptimet që ndonjëherë vijnë si përpjekje për t'u kthyer në ëndërr, herë të tjera si domosdoshmëri e përballjes me zhgëndërrën, e më shpesh si refleksione ndaj realitetit; megjithëse, poezia e Sabit Bajraktarit përmban edhe motive e ide që i tejkalojnë preokupimet e sipërpërmendura. Veçori specifike e poezive të këtij vëllimi mbeten narracioni, krijimi i imazheve apo fotografive emocionale subjektive, figurshmëria e racionalizuar, në kuptim të eliminimit të figurave dekorative, komunikimi, si dhe marrëdhënia e theksuar midis fjalëve, cilësi kjo vetëm e poezive të arrira. Reminiscencat që aty - këtu vijnë në trajta sentencioze të shprehjes flasin për lidhjet intertekstuale të kësaj poezie ndonjëherë me traditën dhe kulturën tonë, e më shpesh me letërsinë dhe kulturën e përbotshme. Si e tillë, poezia e Sabit Bajraktarit është një individualitet poetik që intencë ka mesazhin poetik, ndërsa vëllimi i tij Noah sjell në letërsinë e sotme shqipe një propozim estetik të veçantë, i cili, e pranuar ose jo, doemos e ka lëvizur rendin e hierarkisë së veprave të botuara.



# TA NDIESH SHIJEN E SUBLIMES ESTETIKE

Sh. Beqiri "Muzeu i mërzisë" (The museum of Boredom), botoi Shtëpia Botuese "Faik Konica" Prishtinë, 2023

Kemajl ALIU

Poeti Sh. Beqiri në librin e tij më të ri "Muzeu i mërzisë", që shquhet për leksikon, figuracionin dhe sintaksën e tij, ka arritur nëpërmjet figurave stilistike si: metafora personifikimi, komparacioni, kontrasti e mbi të gjitha me metaforën dhe metoniminë e tij, të shpërfaqë bindshëm gjuhën e tij të individualizuar poetike.

Në këtë gjeografi poetike të atmosferës së zymtë me ngjyrimet dhe nuancat karakteristike, lëvizin subjektet që nga tragjikja dhe situatat dramatike e deri nëpër dilemat situatore skajshmërisht të polarizuara, duke e bërë rrugëtimin e tyre, deri në gjetjen e qeniesimit të vet.

Libri ndahet në shtatë cikle poetike. Është përzgjedhje si dhe përmban edhe poezi të reja. Por, edhe pse ato janë të periudhave të ndryshme kohore, kjo nuk e bën librin aspak një përmbledhje poezish apo të fragmentarizuar. Përkundrazi, ai është i standardizuar në libër tipik poetik, që është unikat si për nga gjuha, mjetet shprehëse, figuracioni, stili, përmbajtja poetike dhe në fund mesazhi.

Për nga përmbajtja tematike, libri "Muzeu i mërzisë", është libër i fatit individual të integruar në fatin e përgjithshëm, apo në fatin e kolektivitetit nacional njerëzor, ku historia është boshti gravitues rreth të cilit përqendrohet i tërë mozaiku artistik, i epokave dhe fateve me imanencën e përplasjeve mes tyre, sepse fati-jeta është e determinuar pashmangshmërisht nga dyndja e hordhive;/...Dhe ndërrohen mbretëritë /Përditë o zot përnatë.../ Çdo gjë del në breg/... /Po asgjë s' duket nga hija e një shkabe/."Dyndja e hordhive" Fq. 27.

Dyndja e hordhive në tokën e vogël të arbrit ku s'mbetet asgjë nga hija e një shkabe, sugjestionon përshkallëzimin në përmasë dramatike, prandaj edhe ligjërimi poetik merr një intensitet ankthi në vazhdimin e mëtejme ligjërimor mbi situatat ngjarjet dhe përmbajtjet pasuese në vijim, ku ankthi i shpërfaqur në trajta të shumëfishuara, e tërheqë lexuesin në akt leximi të pashkëputshëm.

Vërejmë se autorit nuk i mungon aspak historia, si lëndë poetike. Bile, kjo tematikë është dominante në pjesën dërrmuese të librit "Muzeu i mërzisë". Por, falë gjuhës së tij simbolike, atij jo vetëm që nuk i ndodh deskripcioni e aq më pak deklarativizmi, por ai shmangë suksesshëm madje çdo formë apo trajtë të "poetizimit historicist". Kjo qasje dhe frymë e pastër e shprehjes puro artistike, mbase i ka mundësuar poetit të depërtojë deri në përmasat e thellësisë së tragjikes dhe të dramacitetit njerëzor. Përpara subjektit të tij tani shtrihet hapësira e trisht dhe pafundme, hapësira dhe koha e fjalëve të pathëna dhe



e heshtjes, ajo heshtje, zëri i së cilës nuk arriti kurrë të bëhej zë kohe dhe të flas: /Nëse heshtjen e bëjmë të flas si historia/ Ndodh e ngjallemi për fjalën që se thamë /"Kthetra mesnate"(Beqiri Musliu) fq. 43

Ky është piedestali i gjakimit të poetit, ëndrra më e lartësuar të ndodhë Rilindja.

Në vazhden e kërkimit të qenësisë nacionale dhe njerëzore, autori do të vazhdojë kalimthi me provokimin sugjestionues të imagjinatës së lexuesit (Cikli: Para se të fundosej Atlantida), duke filluar me poezinë "Ilirishte" ku poeti thotë: /Ja e njëjta rrënjë/ Pas kaq mijëra vjetësh/, Dheun ta ruan nën këmbë/..po aty, fq. 59.

Konsideroj se çdo varg, çdo fjalë në vazhdim të ligjërimin artistik do ta zvetënonte jo vetëm këtë varg, por do ta reduktonte kuptimisht, përmbajtësisht dhe estetikisht madje gjithë poezinë. Prandaj këtu vërejmë se poeti Sh. Beqiri përpos që e ka vargun e ekonomizuar dhe konciz, gjithashtu edhe mesazhet i transmeton përmes simbolikës metaforike, duke ia lënë mundësinë kredos imagjinatave vetë lexuesit mbi Atlantidën dhe përmbysjen e saj si dhe mbi Ilirinë./ Që ruan drejtpeshimin/ E valës dhe bregut/. Po

aty, fq. 59

Poezia e Sh. Beqirit përpos që ka shtrirje të gjerë imagjinatë, karakterizohet edhe me guximin e theksuar intelektual, për thyerje të tabuve, deklivitizim formash, si dhe riformulim perceptimi. Kjo vërehet qartë në poezinë "Përshkrimi i ankthit", (fq. 215, 217), ku ai fokusohet në rrugëtimin e poetit, i cili gjithmonë ecë /Nëpër perin kahe të këputur/ Nyjave ku lidhet e pazgjdhura/. Fq. 217. Ai është në përballje imanente me njeriun ideologjik, kundërshtarit të vargut /Që jeton përtej epokave të arta/ fq. 217, sepse si i tillë ai paraqet një herezi.

Një karakteristikë tjetër që duhet vënë në pah është qasja e poetit Sh. Beqiri lidhur me faktorin kohë. Kalendarit i kohës nuk është i objektivizuar në materien poetike të tij, siç ndodhë në poezinë tradicionale, gjegjësisht klasike, e cila konceptin kohë e realizon në njëfarë kronologjie tablore, gjegjësisht suksesiviteti, ndërsa te poeti Beqiri koncepti kohë është i determinuar në mënyrë simultane. Ai i shmanget në plotni konceptit të suksesivitetit kohor-tablove kronologjike, duke e inkuadruar hapësirën dhe subjektin në konceptin e kohës simul-

tane e cila subjektivizohet në përmasën imagjinatë të mendimit artistik. Psh: /Do të vish patjetër ti / Të lidhësh plagën që kullon/ Ndërmjet ashtit tim e hapit tënd/ Pas të pesëqindënjëzetekatërtës verë/ "Ninulla e gurtë (Bijës sime, Albulenës) fq. 79. Është e tashmja e cila qenësinë e saj që e kishte dikur para pesëqindënjëzetekatër viteve do të ripërtërijë në hapin e ri.

Hapi i ri, mbase do t'ju takojë një ditë të tjerëve, por jo poetit. Atij i duhet të takoj xhelatin e tij të ngopur, me të cilin, siç thotë: /Shpiknim kupat me verë qindvjeçe/ Për luftën që do të bënim nesër/ Deri në të mbramën pikë të gjaku/, "Xhelati im i ngopur", fq. 207/

Xhelati është fatkeqësi e tre brezave, të cilët tashmë janë të shkapërderdhur metropoleve: Babai, biri dhe nipi. Përderisa babai jeton nën kthetrat e vetmisë vrastare dhe të pafundme, i biri do të rrugëtojë në natën me njëmijë sy, ku dita e nesërme që do ta gdhijë birin e tij është ditë e flatrave të tija të gjymta. Prandaj, poeti thotë: /Hapma derën të thashë / Se s'po më nxë hapësira Përjashta./: "Dera e mbyllur" (Nipit tim, Bujarit). Është simbolika për mungesën e dheut hapësirave ku endet ai. Aty ku përfunduar atdheu i tij, në ato hapësira përfundon edhe frymëmarrja e mjaftueshme...

Prandaj, ai gjithnjë është në kërkimin - jetësimin e qenësisë së vet, qoftë si rrugëtim apo madje edhe si fund: /Ai nuk ecte sipas yjve as erës/ Vërtitej pas gurit të vet/ Që e mbante pezull/ Midis vetëtimash/ "Rrënja e dhembjes", Fq. 271

Poeti gjithmonë do të ballafaqohet me mungesën e Lirisë. Ajo mbetet e përhershme vetëm në ëndrrat dhe të kërkuarit të tij nëpërmjet botës së artit. Ky zaten është misioni i artit, i poezisë: /Të tri motrat gjeniu i ri i ka paraqitur si tri lule /Lidhur në një zinxhir pran-gash të praruara/ "Ekspozita e parë në mërgim"(Birit tim, Agonit), fq. 255

Poeti dhe kritiku R. Musliu, në një rast, duke folur për poezinë e Sh. Beqirit, thotë: "...kjo poezi është tepër elitare, vetëm për ata që nga poezia kanë kërkesë të qartë: të ndiejnë shijen e sublimes estetike".

Krejt në fund, duke pasur parasysh se libri "Muzeu i mërzisë", jo vetëm për faktin se përmbledhë në njëfarë mënyrë gjithë përvojën e tij krijuese poetike, por për shkaqe kryesisht estetike, konsiderojmë se është një nga ato libra që nuk përfundojnë me një lexim. Në raftet e bibliotekave janë disa libra që edhe pas leximit mbahen afër vetes për rikthim, rilexim të përsëritshëm: sikur bie fjala "Trungu Iliir", (S, Hamiti), "Bukuria e Zezë", (B. Musliu), "Në zemrën e gjërave" (R. Musliu) etj. Aty duhet të vendoset edhe vëllimi poetik "Muzeu i mërzisë" i poetit, Sh. Beqiri.



# NDËRTHURJA E TRAGJIZMIT DHE FATALIZMIT

(Rreth romanit "Bolero në vilën e pleqve" të Fatos Kongolit)



Xheni SHEHAJ

Romani "Bolero në vilën e pleqve" i Fatos Kongolit ngërthen ngjarje të dy kohësive, të cilat vijjnë si kronikë e rrëfimtars. Parashqevia, me profesion infermiere, 30 vjeçare, është rrëfyesja e ngjarjeve. Ajo i shfaqet lexuesit që në krye të herës si një njeri i rëndomtë, i parëndësishëm dhe i padukshëm. Duke pasur një orientim seksual ndryshe (ishite lezbike), ajo ndjente mbi vete paragjykimet, gjykimet, e neverinë e të tjerëve. Të qenit "ndryshe" e kishte bërë Parashqevinë ta ndjente veten të huaj, të mallkuar, të dënuar. E, për më tepër, bota përreth nuk e ndihmonte aspak, por ia shtonte morinë e kompleksëve e pasigurive. Duke tentuar të bëhej e padukshme, të ecte si hije, të mos ndihej prezenca e saj, Parashqevia kishte krijuar te kolegët e te të tjerët përshtypjen se ishte njeri mediokër, me shkallë zero të zhvillimit mendor. "Për koleget e mia, në përgjithësi për këdo që hynte e dilte në pavijon, unë kam qenë gjithmonë një send i dekorit. Një qenie në nivelin zero të zhvillimit mendor. Më urdhëronin të gjithë dhe unë u bindesha të gjithëve."

E megjithatë, ajo kishte mbaruar studimet për infermieri me një mesatare të kënaqshme, ishte e zonja në punën e saj, por "fatkeqësia" që i kishte rënë për hise e kishte ndrydhur deri në pikën që nuk mundohet t'i bindte të tjerët se ajo vlente shumë më tepër sesa e vlerësonin. Ngjarjet rrokullisen dhe marrin drejtim tjetër kur Parashqevisë i vjen një ofertë pune. Doktorit i spitalit ku ajo punonte e rekomandon tek miku i tij biznesmen, për t'u kujdesur për prindërit e moshuar të këtij të fundit. Pas disa mendimesh e stërvollimesh vet me vete, Parashqevia pranon ofertën e punës. Në një farë mënyre ajo pranon të izolohet, të largohet nga jeta e jashtme për t'u mbyllur në një vilë me dy pleq të sëmurë e tekanjor. Izolimi, bashkëjetesa me çiftin e pleqve krijon idenë e dorëzimit, shkëputjes e vetëdënimit të saj. Parashqevia mendonte se bota atje jashtë nuk kishte vend për njerëzit si ajo. Ishite një grua e vetmuar, e mbyllur në vete, e trazuar nga kujtimet e së shkuarës dhe nga traumat e lindura nga ngjarjet që kishte përjetuar.

Kongoli nuk harron të paraqesë ngjyrimet kryesisht gri në të zezë të shoqërisë shqiptare. Ai e ka sjellë shoqërinë në dy kohë; viti i tmerrshëm 1997 dhe disa vite më vonë. Viti 1997 shfaqet në tërë egërsinë e tij. Shqipëria është tërësisht nën komandën e bandave. Depot e armëve janë boshatisur dhe populli është i armatosur. Shqiptarët kanë nisur të lajnë hesapet me njëri-tjetrin

dhe nuk ka ditë mos të ketë ekzekutime, shpërthime, grabitje e përdhunime.

"Ishite një natë marsi, e atij marsi njerëzishëm 1997, dhe logjika ta donte të rrija brenda. Kështu vepronin të gjithë njerëzit e arsyeshëm, sapo niste të ngrysej dhe krismat e armëve dhjetëfishoheshin, mbylleshin brenda. Me t'u ngrysur, rrugët pushtoheshin nga qenëria... Krismat rreth e rrotull dhe dyndjet e njerëzve në spital, që sillnin të afërm të plagosur dhe u rrinin mjekëve me kallashnikov në kokë për t'i mjekuar, ishin të zakonshme."

Ky ishte pasqyrimi i shoqërisë shqiptare përgjatë vitit 1997. Rrëmbimet, përdhunimet, larjet e hesapeve, skafet me refugjatë për matanë detit, vijinë e shpalosen dora - dorës gjatë rrëfimit të Parashqevisë, si për të mos trazuar kujtimet e një kohe të cilën njerëzia kërkon ta lërë në harresë. Por, as koha në të cilën gjallojnë personazhet e romanit nuk duket më e butë. Shoqëria paraqitet e shthurur. Autori pikturon një tablo mjerane të shoqërisë në të cilën ka fëmijë që i lënë prindërit në duart e dikujt tjetër, martesat të prishura, lidhje paralele, hipokrizi, shtirje e falsitet. Një shoqëri e degraduar, e prirur drejt së keqes, drejt veseve. Ky është ambienti ku bashkëveprojnë personazhet e romanit.

## Përsëritja

Një nga teknikat e përdorura nga Kongoli është përsëritja e situatave. Kjo jo për të krijuar monotoni, por: - herë për të ndryshuar ritmin e ngjarjeve si p.sh: (ardhjet e doktorit një herë në muaj tek vila për të vizituar pleqtë, komedia që luante me zotin Irfan, ngacmimet për gjininë femërore). Gjallëria që sillte doktorit, humori dhe të qenit i paskrupullt ndryshonte për pak ritmin monotoni të vilës e banorëve të saj, - herë për të ngjallur kuriozitetin si p.sh: (kur zonja Firdus i dërgon për herë të parë të shoqit letër të hapur në mënyrë që ta lexonte dhe Parashqevia, e zoti Irfan bën të njëjtën gjë). Kjo sigurisht ndjell kuriozitetin tek lexuesi pasi më në fund ai mund të njihet me përmbajtjen e dy letrave, - herë për të mos humbur vëmendjen e lexuesit si: (përsëritja e së njëjtës frazë prej Dirinës "të luash mendsh" sa herë ngecte në trafik në rrethrotullimin e Zogut të Zi). Lexuesi duke u ndeshur disa herë me këtë përsëritje në vend që t'i humbasë vëmendja, i rritet përqendrimi pasi pret të lexojë reagimin e Parashqevisë. Përgjatë romanit, autori bën të mundur që edhe Parashqevia në duelin me veten përballë pasqyrës të përsërisë të njëjtat fjalë: "shëmtirë", "e neveritshme", "qene", e për disa herë të ndjehet si një qese plastike e mbushur me plehra.

## Elemente si ura lidhëse mes së shkuarës e së tashmes

- deti; në vepër ai luan rolin e një ure lidhëse mes së tashmes e së shkuarës së Parashqevisë. Sapo atje tej u duk deti vajzës iu mblodhën kujtimet e një jete të shkuar, në një tjetër qytet, me të tjerë njerëz.

"...Derisa u shfaq deti. Sigurisht deti do të shfaqej dhe unë nuk mund të shtangesha nga ky fakt. Fajin për atë ndjesi të beftë, - po e quaj shtangje, në vend të s'di ç'fjalë tjetër më të përshtatshme, - e pati deti. Kam lindur në një qytet bregdetar, jam rritur atje. Është një qytet-port ku unë s'kam shkelur prej vitesh, qysh se u largova dhe s'kam parë më as detin e tij, as qytetin, as njerëzit. Dhe nuk kam dëshirë t'i shoh." Kështu nis filli i kujtimeve të Parashqevisë për të shkuarën e saj. Prej detit, prej pranisë së tij, asaj i vinte në mendje ngjarja e hidhur që kishte përjetuar. Në breg të detit

atë e kishin përdhunuar gjashtë djem me maska. Për ta lënë të vetme, në të ftohtë, të përgjakur e të poshtëruar pranë detit.

"Më urdhëruan të zbrisja me ta nëpër rrëpirën e kodrës, në një gji deti. Ata më përdhunuan të gjashtë, me të njëjtin stil. Nuk kuptoja më asgjë. Nuk ndieja më as duhatat e tyre me alkool e duhan përzier, as shfryrjen "shkërdhatë", as shpërthimin e shkullmeve të tyre. Ndieja vetëm një dhimbje të tmerrshme nën vete. Shqyerjen e buzëve. Dhe zhaurimën e detit. Deti shtrihej i zi."

- fjala "shkërdhatë"; në një nga daljet e saj në dyqanet e lagjes, Parashqevia e pakujdesshme rrezikoi të përplasej me një makinë. Shoferi teksa shfrynte e shante ndër të tjera e quajti edhe "shkërdhatë". Fjala e goditi vajzën fuqishëm e kjo jo vetëm për shkak të domethënies, por kryesisht për rizgjimin e kujtimit të hidhur. Teksa të gjashtë trimoshat e maskuar e përdhunonin njëri pas tjetrit, nuk përtonin ta quanin "shkërdhatë", fjalë kjo që u ngulit në mendjen e viktimës e nuk shkulej më.

"Fjala shkërdhatë u rikthye. Mbi të gjitha, mendova, të mbledh veten, ta heq nga truri fytyrën e zezë dhe fjalën "shkërdhatë". Ia dola, por tek prisja në radhë, në vend të tyre më sulmoi një natë e errët, në breg të detit, me zhaurimë valësh."

- ëndrrat; janë paralajmëruese të ngjarjeve që mund të ndodhin. Parashqevia sheh në ëndërr zonjën Firdus, e cila aso kohe ishte gjallë, e kjo i thotë njësoj si dikur e ëma në ëndërr: "Po vdes, lutu për mua!". Përmes këtyre elementeve, autori ndihmon Parashqevinë të bëjë lidhjen e së tashmes me të shkuarën.

## Erotika në roman

Në roman nuk mungojnë pasazhet me përmbajtje erotike. Duke filluar që nga batutat e doktorit me zotin Irfan mbi seksualitetin e këtij të fundit, masturbimet e pafundme të Parashqevisë, e deri tek mendimet e saj erotike në lidhje me Dirinën. Nëpërmjet situatave të ndryshme ku përmenden tematika seksuale duket sikur autori do të godasë shoqërinë, e cila duke mos pasur edukimin e duhur seksual e për pasojë duke mos e parë seksin si një proces normal e mbivlerëson atë dhe i jep pushtet më të madh sesa ka duke e përdorur herë si dënim (djemtë që "ndëshkuan" vajzën duke e përdhunuar vetëm se kjo ishte lezbike dhe e lidhur me motrën e një të "forti"); si kapadaillëk (rasti i doktorit që mbante dashnore edhe pse ishte i martuar); si shenjë pushteti (rasti i Nardit i cili duke qenë i pasur ishte martuar me një grua më të re se vetja); si shenjë rinie (rasti i zotit Irfan, të cilit tashmë i kishin rënë dhëmbët dhe gjithë ç'i mbetej ishin fjalët e batutat); dhe si burg apo makth për personazhin e Parashqevisë (ajo e traumatizuar nga përdhunimi, e pazonjë të pranojë vetveten ashtu siç është nuk kërkon realisht të gjejë një partnere por mjaftohet duke ëndërruar e duke masturbuar). Seksi shfaqet jo vetëm në mendimet e dëshirat e personazhit kryesor, por edhe në situatat e krijuara mes personazheve të tjerë. Doktorit ka rolin e një Don Zhuani dhe në çdo takim me infermierën e zotin Irfan lëshon batuta e pyetje të drejtpërdrejta për jetën seksuale të dy personazheve. Pas ardhjes nga Parisi, ai nuk ngurroi t'i sillte dhuratë Parashqevisë një lodër seksuale, të cilën kjo e fundit e pagëzoi me emrin Adam. Një nga momentet e nxehta në roman është skena kur Parashqevia masazhon trupin e Dirinës. E skllavëruar nga trupi i saj, e etur për të, ajo përfundon duke e dreqosur raportin shoqëror me Dirinën. Në mungesë të një partnereje, Parashqevia masturbohet rregullisht.

"Skena e masazheve në sallon më përndiqte kudo, më shtrëngonte kraharorin, më zinte frymën. Nuk gjeja prehje përveçse duke u masturbuar. Gjatë atyre tri ditëve u masturbova çmendurisht." Rol të posaçëm përta i përket anës seksuale në libër, autori i ka dhënë grupit të djemve që qëndrojnë për çdo darkë në bordurat e lagjes. Vajza që shërbente para Parashqevisë te vila, ishte mpleksur me njërin nga grupi i djemve të lagjes. E ata vijonin të rrinin në pritje me shpresën se shërbyesja e re do t'ua varte.

## Letërkëmbimi

Kur filloi të punonte në vilën Voga, Parashqevia ende nuk e dinte se zonja Firdus dhe zoti Irfan, edhe pse jetonin në një shtëpi, i shkruanin letra njëri - tjetrit. Në një vëzhgim të parë, sekush mund të mendojë se ç'broçkulla mund të shkruajnë dy të moshuar të rrëgjuar e me një këmbë në botën tjetër. Parashqevia edhe pse ndjehet kurioze të lexojë letërkëmbimin e çiftit, nuk hap kurrë asnjë letër. Nga fundi, ajo tenton në mënyrë amatoreske të marrë nga plaku letrat, por nisma nuk i ecën. Pas vdekjes së zonjës, bashkëshorti fillon një tjetër "lojë", atë të ëndrrave e fanepsjeve. Faktikisht e fillon Parashqevia duke i treguar një ëndërr që kishte parë me zonjën Firdus, dhe plaku nuk vonon ta kthejë në diçka të zakonshme. Ai nis e tregon çdo mëngjes se e shoja "erdhi mbrëmë", u shfaq, i buzëqeshi, i ndenji ftohtë, nuk iu afrua, etj. Një ditë plaku ishte tejet i shqetësuar dhe i trishtuar pasi në ëndërr e shoja nuk e kishte lejuar që ky ta përqafoje. Duke u bazuar në shpjegimin e ëndrrave, Kongoli i mëshon faktit se nëse i gjalli përqafoje të vdekurin, ky i fundit e merr. Zonja Firdus që nga përtej varrit e dinte se nuk kishte ardhur ende koha e të shoqit. Ndaj dy herë radhazi ajo ia refuzoi përqafoimin. Zoti Irfan e kishte zakon që sa herë grindej me të shoqen, ulaj e luante në piano. Idhulli i tij ishte Chopen, fotografinë e të cilit e mbante në dhomë. Në takimin e parë kur gruaja i refuzoi përqafoimin, zoti Irfan i dëshpëruar e pasi kishte kaluar një parainfarkt, vuri në sfond Boleron e Ravelit. Edhe në refuzimin e dytë, u përsërit e njëjta muzikë. Derisa, një mëngjes korriku, adoleshenti i përjetshëm, zoti Irfan, u bashkua me zonjën e tij.

"E gjeta në shtat, në shpinë, symbyllur, gojëmbyllur, me çarçafin që e mbulonte nga mesi e poshtë. Në fytyrë i kishte rënë një qetësi qiellore. Ajo e kishte lejuar ta përqafoje. Ai e kishte përqafoje."


Pas vdekjes së plakut, puna e Parashqevisë në vilë përfundon dhe ajo kthehet në apartamentin e saj. Merr një qen për t'i bërë shoqëri dhe e quan Adam. Shtëpia tashmë është vendstrehimi i dy Adamëve dhe një Eve. Kongoli e mbyll romanin me vetminë e Parashqevisë, e cila bashkë me Adamin qen sheh një film. Duke e mbyllur personazhin në burgun e saj, autori krijon përshtypjen se individët janë të burgosur në fatin e tyre sado që mundohen ti largohen atij. Parashqevia i largohet qytetit të saj me det dhe detin e gjen prapë, i largohet qytetit ku njerëzit e neveritnin dhe i gjen sërish me të njëjtën dozë neverie, i largohet djemve përdhunues dhe gjen djem të tjerë të cilët e vetmja gjë që i dallon nga të parët është pamundësia për të kryer krimin e përdhunimit.

Parashqevia la pas një vend ku ndjehet e vetmuar dhe e braktisur për të gjetur të njëjtën vetmi e braktisje në një tjetër vend. Personazhet e Kongolit janë të destinuar të jetojnë një jetë mediokër, në të cilën tragjizmi dhe fatalizmi ndërthuren për të shënjuar deri në fund jetën e personazheve.



# UDHËTIMI NËPËR KOHË

(Rreth romanit "Ashensori" të autorit Ferid Selimi)



Skender LATIFI

Romani "Ashensori" i autorit tanimë të dëshmuar preshevar, Ferid Selimi më ktheu për disa vjet pas apo thënë më qartë në fëmijërinë dhe rininë e hershme. Si fëmijë, ndodhte jo shpeshherë që të familjarët tanë më të moshuar të na merrnin me vete kur ata shkonin t'i vizitonin të afërmit e tyre apo të qëndronin si mysafirë për dy apo tre ditë radhazi larg vendlindjes sonë Preshevës, sidomos në "kohët shterpa", siç quheshin

ditët e pas përfundimit të punëve sezonale bujqësore. Dhe me të arritur në ato shtëpi të të afërmit tanë, më së tepërmi më binin në sy arkat e mëdha apo baullet, ku ruheshin sendet me vlerë të shtëpive ku qëndronim ne. Nuk di as sot se si ndodhte që çelësat e baulleve në të shumtën e rasteve i mbanin nënat apo zonjat e atyre shtëpive, përkundër që të zotët e shtëpive ishin burra hijerëndë, që prisnin e përcillnin me përzemësi mysafirët e tyre, por që lehtë ktheheshin në burra fjalëpak kur ata ktheheshin në atmosferën intime familjare! Pasi vetë i përkas brezit që ishim dëshmitarë të ndryshimeve të mëdha socio-ekonomike të gjysmës së fundit të shekullit të XX-të, romanin "Ashensori" unë e kam konceptuar si "Baulja e shtëpisë" që rrethanat bashkëkohore e kanë shndërruar në "Ashensor". Pra, autori na sjell në këtë libër kujtime për njerëz, ngjarje, vende me të cilët ai ka udhëtuar dhe do të udhëtojë tërë jetën e tij, sa herë që ai ka nevojë për shoqërimin e tyre. Por, edhe për lexuesit ky udhëtim do të jetë sfidues dhe mbresëlënës, sepse në librin e Ferid Selimit ata do të gjejnë episode ngjarësh, emra vendesh e njerëzish që fatkeqësisht tanimë nuk janë në mesin tonë. Edhe pse autori ka qenë modest në përshkrimin e detajeve rreth çështjes së të

besuarit të çelësit të "Baulles së shtëpisë", vërehet qartë se edhe në shtëpinë e tij të lindjes ai çelës iu ishte besuar zonjës së shtëpisë, apo së ëmës së autorit. Duke e njohur për së afërmi atë grua fisnike, nuk mund të heshti e të mos i them disa fjalë për të. Në sytë e mi të një fëmije apo të riu, ajo grua në çdo çast e dëshmonte një shkallë të lartë të vetëbesimit, diçka të pazakontë për bashkëmoshataret e saja që jetonin midis terheqshmërisë dhe gjysëm-heshtjes. Prandaj vetëm ajo mund t'i besonte të birit çelësin e ruajtjes së kujtimeve dhe vetëm ata dy mund ta dinin se si pse kishte ngjarë kështu, duke e pasur parasysh se në shtëpi kishte edhe fëmijë tjerë. Pa një besim dhe guxim t'i gëzonte fëmijët e lagjes. Në udhëtimin nëpër kohë, anekënd vendbanimeve të Preshevës, në faqet e librit autori balancon midis nostalgjisë për të kaluarën e vendlindjes së tij, për dhembjen për ata që i ka njohur edhe nuk janë më në këtë botë, për rrugët e sokaqet që siç e përmenda më lartë nuk janë më ashtu siç kishin qenë dikur dhe që

autori sikur me dëshirë kërkon që së paku për disa çaste asfaltin e rrafshët të vendlindjes ta ndërrojë me pluhurin dhe gurët e dikurshëm mbi të cilët bashkëqytetarët e tij dhe ai vetë hodhën hapat e parë të fëmijërisë dhe të rinisë. Në fund mund të them se në "Ashensorin" e Ferid Selimit nuk mungon guximi, sepse ai në "udhëtimin" e tij iu ka bërë vend edhe atyre personaliteteve e figurave të Preshevës dhe rrethinës së saj, që ishin të pastrehë apo me zhvillim të vonshëm mendor dhe gjithnjë ishin në kërkim të këndit të tyre të rehatshëm të nënqiellit preshevar. Guximi i autorit nuk ka munguar edhe në të deshifruarit e shprehjes së njohur "a pate apalaç pahiri", me të cilën shprehje thuhetse amnistoheshin të gjithë ata bashkëvendës të autorit që e pinin duhanin tinëz... "Baulja e shtëpisë", e cila dikur qëndronte në një pjesë gjysmë të errët të shtëpisë dhe dera e së cilës hapej edhe mbyllej rrallë, e shndërruar në "Ashensor" nga Ferid Selimi për lexuesit do të afroje një udhëtim mbresëlënës duke kujtuar detaje, personalitete, vende të përcjellë me një dozë jo aq të përbalueshme nostalgjie, por edhe me një shpresë për një mihje edhe më të thellë të kujtesave tona për një të kaluar jo aq të largët, jo aq të pasur por të dëshiruar dhe të përbalueshme.

## Shënime letrare

# KUR SHKRIMTARI HAMDI MEÇA SHKRUANTE LETËRSI PËR FËMIJË...

Hamdiu, në krijimtarinë e tij, i ka mëshuar dhe i ka besuar detajit poetik. Në poezi, në poema e në fabulat (në prozë) gjen shembuj dhe faqe të tëra, ku mbizotërojnë detajet poetike



Xhahid BUSHATI

Hamdi Meça është njëri nga shkrimtarët më interesantë të letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj. Po t'i hedhim një sy procesit historik e letrar të rrugëtimit të letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj, shkrimtari Meça, në vetvete, është një 'Shkollë', kjo e lidhur me profilin që ai na ka ofruar me krijimtarinë e tij në disa gjini të lëvruara e cilësore. Qëndron denjësisht pranë disa 'Shkollave' që krijuan disa shkrimtarë të shquar të kësaj letërsie, si: Odhise K. Grillo, Bedri Dedja, Xhevat Beqaraj, Adelina R. Mamaqi, Tasim Gjokutaj, Agim Deva, Rifat Kukaj, Rexhep Hoxha, Gani Xhafolli, Fejzi Bojku, Rahman Dedaj, Anton Pashku, Ymer Elshani, Xhevat Sylja, Xhevahir Spahiu, Moikom Zeqo, etj. Kur themi 'Shkollë', e shohim të plazmuar me gjinitë, që shkrimtari Meça

ka lëvruar, si: poezinë, poemën, tregimin në vargje, tregimin, legjendën, fabulën, romanin, etj. Po mundohemi të zbulojmë disa nga këto dukuri gjatë studimit të kolanës letrare të shkrimtarit Hamdi Meça. Hamdi Meça, ndoshta është nga shkrimtarët më të veçantë, ku Historia e Vendlindjes është e pranishme dhe pasqyrohet, si: shqotë, puhizë, amanet, ëndërr... e vazhdon si një diell, mik e bashkudhëtarë i shkrimtarit. Po ku konsiston veçantia? Epoka kruetane është si të thuash Epoka e Skënderbeut. Brenda profilit jeton historia me përmasat e saj, ku Liria dhe Ekzistenca, Dheu dhe Ëndrra mbeten shtyllat kryesore që kanë ngritur këtë 'ngrehinë' përmes një rrëfimi filozofiko-poetik. Hamdiu, në krijimtarinë e tij, i ka mëshuar dhe i ka besuar detajit poetik. Në poezi, në poema e në fabulat (në prozë) gjen shembuj dhe faqe të tëra, ku mbizotërojnë detajet poetike. Abstragimi i detajit ruan gjithnjë konkretësinë reale. Ky raport i kujdesshëm nga ana e autorit, mbarat imazhe dhe ngjyra të lloj-llojta me kraheëndrash dhe fushash të pafund imagjinatë. Shkrimtari Meça, në krijimtarinë e tij letrare shfaqet me 'një poezi', ku epika ndërthuret me lirikën. Edhe atëherë ku lirika është mbizotëruese nuk e

përjashton epikën, ajo është diku zgjuar në një kënd të shpirtit të shkrimtarit. Po t'u referohesh tregimeve, me të gjithë komponentët që kërkon kjo gjini e kanë një adresë moshore (nuk ka hallakatje) dhe e përligjin bukur artistikisht atë (moshën). E, Hamdiu për vetë natyrën krijuese në raport me lexuesin, ka një harmoni dhe një sublimitet. Autori e njeh këtë psikologji. Kjo është arsyeja që, tregimet të rrëmbejnë që në leximin e parë. Diku subjekti më i plotë (në kuptimin pozitiv: me ndërtim kompozicional të kësaj gjinie), diku bulëzim subjekti, diku, edhe me një rrëfim paksa tradicional. Tregimet e shkrimtarit Meça i lidh POETIKA. Konceptualiteti i kësaj POETIKE, lëvizja dhe dinamika e saj zhvillimore, arrijtet e saj, fushëpamja, etj., - flasin për një vështrim horizontal e vertikal të botës së fëmijëve, të njohjes në vazhdueshmëri të saj. Në dialogët e veprimet e personazheve, në gjestet e psikikën e tyre, po ashtu edhe në portretin detajues është e pamundur të mos vësh: pafajsinë dhe kureshtjen, imagjinatën përrallore, lojën dhe çiltërsinë e tyre, etj. Dhe të kuptohemi... ka një të vërtetë: Shkrimtari Hamdi Meça është mjeshtrë në rrëfimin e tij edhe si tregimtar! Një rrëfim gjithë poezi brenda "trungut" subjektor, dhe hapësinor

drejt livadheve të gjelbra ëndrrakërkuese. Poetikisht, Hamdiu në krijimet e tij "ulet njësh me personazhet dhe lexuesit". Shumë nga tregimet e disa vëllimeve që në titull cilësohen me emër personazhi (kanë jetë dhe ngjarjen e tyre), edhe pse në dukjen e jashtme janë format i vogël; të shijojnë, të rrëmbejnë, të emocionojnë, të bëjnë për vete. Autori i ka besuar subjektit në ngjarjen e ndodhur, ngaqë e ka mirëmenduar. I ka besuar, gjithashtu, ruajtjes së frazës, e cila është plot ngjyrë, intensitet dhe mendim. Duke futur në "lojë" POETIKËN e tij përmes detajeve të gjetura të saj, ka përfutur disa shtigje frytdhënëse, ku duhet ta kërkojmë individualitetin e Hamdi Meçës, krahas vjershës edhe në gjininë e tregimit të shkurtër. I thamë këto fjalë për këtë autor të talentuar, pasi nga vëzhgimet tona konstatojmë se autori i është përkushtuar një letërsie tjetër, larg asaj për fëmijë e të rinj. Me këto botime që bën autori Meça, na bën të mendojmë se... sikur e ka mbyllur këtë proces letrar. Gjithsesi kurrë nuk është vonë të rikthehesh te letërsia shqipe për fëmijë e të rinj, aq më shumë kur je i talentuar.

(Shkodër, tetor, 2023)



**MË THUAJ, DALLËNDYSHE**

Më thuaj, dallëndyshe, ku të ngre fole  
që terr i zi të mos hyjë ndër kashtë  
që mos të çelin pikëllime të reja  
as të riçel një mërzitje e lashtë?

Më thuaj dallëndyshe si ta bëj gjumin?  
Kur ëndrrat bien llahtarshëm nga sytë  
dhe fjalët e thëna në makth kthehen  
e një britmë e çjerrë mbetet në grykë.

Në cilën majë mali të ngjitem harlisur?  
Kur një zog krahëthyer në mua zbret.  
Cili krua freskon një zemër të grisur?  
Kur një etje të shuhet ka kohë që pret.

Si ta fikë një zjarr që përkaj më djeg?  
Si ta ndalë një ikje që lë mërzitje t'urryera?  
Më thuaj dallëndyshe vetëm një herë  
Si fluturohet me krahë të thyera?!

Përgjatë kohës gjegjen në heshtje  
gërryerjet në palcë e sjellin brengë.  
Më thuaj dallëndyshe si të ik nga netët  
që kala malleth në mua ngrenë?...

**KTHEHU PËR HATËR T'HANËS**

Me netë t'tana nuk po flen rahat hana pa neve rojtarët e saj,  
s'po bjen n'herezi ma e m'sheft mas reve  
tinëz t'lumtun me na pa  
veç hajde e shihe prej ktu se si asht ba, asht dremmit...

Mu malli po m'rigon si shi e po rri mas grilave,  
n'andrrat syqel t'mesnatës n'apogjeun e rremë po luhatna  
po s'po asht boll,  
durt mikluese me përvinu kadal ftyrën tane  
nuk po munen me durue duerkryq.

Natë orgjie po baj n'nimfen teme  
sarhosh n'theqafjet drejt mirazhit tan po eci  
tafti-bafti! edhe t'koft zgrip i jetës,  
imazhi yt joshes po m'babëzit teslim po bahna  
se m'asht sekrecion i trupit,  
menzi hana po m'nal vikamen harbute kur po shuhesh si meteor  
pa mujt me t'nanurisë si du unë.

Kallamishte jam ba pa ty, kurm  
suvalë kujtimesh që po m'marrin...  
tangjent që m'prek n'pikën tem t'dobt, n'ty.

E vetmja hana po kuis kit eremit naiv e as nuk po kotet,  
po m'ep stërkalë shpresash që kem me ken bashkë  
tymtajë po ma ban menen  
shtërzime pa dobi, për mu t'pashpresë!

S'di edhe sa do mahet stoik ky shpirti jem maraz  
pa ba naj hata prej mungesës tane napalm...  
Mos e shti n'mëkat hanën me ba alibi t'rreme për mu  
kthehu për hatër t'saj.

**VEÇ NJI HERË**

Bahu veç një herë emni jem  
dhe shih cila baladë mesnate ndanë hanën në dysh  
kush ma vodhi qetësinë e mbramjeve, që e kisha ka herë

shih sa dashuni kanë lutjet që gatohen për ty  
sa t'çmenduna janë andrrat dhe si i ruj,

shih si pranvera e nalë kangën kur nin' zanin tand t'ambël,  
si e nalë lulimin kur sheh tandin nur!

Bahu veç një herë emni jem  
shih me ç'shpresë rrojnë ndjenjat që s'përfillen,  
si ngryset dita pritjesh për një fjalë  
me britma t'pafre t'dhembjes e t'heshtjes.

Si ravijëzohet mirazhi yt mendimeve mjegull  
shih patjetër,  
si suvala përpin' shpirtin  
edhe pse asht i qetë deti.

Bahu, emni jem, veç një herë  
shih sa shtirë e baj vet t'plotë hanën  
kur i mungon pjesa tjetër.

**S'MUNDENA ME T'URU MIRËSEARDHJE NATË**

S'mundena me t'uru mirëseardhje natë,  
qiell i veshun me t'zeza  
se ti vret me t'kast  
tremb me pamjen tande pa fluturime zogjsh.

Je shtiake,  
me yje ban veç f'tyrë t'rreme..

Mashtrueshëm  
i bjen n'menje kujtimet eremitit  
copë-copë si pasqyrë e thyeme.

Mirazh t'nji dashnie t'trisht i bjen,  
e shushat,  
i jep tallaz shtërzimeve t'tij kot,  
e marron..

Dashnia te ti s'peshon as një okë  
shkëput yjet pa u puth',  
ia kujton dhimbjet  
plagos andrrat  
se ai ia din mirë  
vujtjen - buzëve t'pauthuna,  
angështinë - fjalëve t'pathana.

Natë, s'mundena me t'uru mirëseardhje  
je llahtari,  
vikamën, sëmbimin, ngërçin e shfaq n'shpirtin e vetmuem...

Kot thuren lutjet me fill prej teje  
i humb rrugëve tua t'errta papërfillshëm  
i braktisë.

Ti mat veç dhimbjen  
shtrihesh mi zemrën eremit si tragjedi  
muzgut - n'aktin e fundit  
e çon deri n'zgrip t'jetës orgjive...

S'mundena me t'uru mirëseardhje, natë,  
qiell i veshun me t'zeza,  
veç lutena: ardhsh e bardhë najherë..!

**I PANJOHUN**

M'fal, i panjohun  
s'kam menu që zemra s'ka me ditë m'u mbrojtë  
e dashnia ka me fillu me pulsu  
veç prej një casti që t'pashë  
I panjohun,  
unë patjetër që duhet me majt' n'krahë një mëkat  
ferri s'djeg ma shumë  
se që po djeg kjo ndjenjë mrena trupit  
je dashni e dëshirume  
neps i madh që du me shujt  
buzë për buzë  
trup për trup  
le t'më dënojnë e marrojnë Perënditë;  
po nëse dashnia asht mëkat  
atëherë njeriu vet asht mëkati ma i madh...  
Menoj me vete:  
kush s'dëshiron me kanë e vetmja dallëndyshe n'sytë e tu  
që i ke si një hark ylberi e qielli vet?!  
M'fal, i panjohun  
po fluturat që po çmendën n'bark  
ma nalin frymën  
dhe... edhe në u qujt mëkat kjo dashni, do mëkatoj patjetër  
ndiej që s'kam frymë që m'ban t'plotë pa tanden  
dhe as s'kam andërr me lan' përgjys..



# TIRANA

Sonja AZIZAJ

Na ishte njëherë Tirana me një Teatër Kombëtar, vila të vjetra të ndërtuar nga italianët që të binin në sy gjatë shetitjeve me biçikletë dhe një shesh i madh quajtur Sheshi "Skënderbej", i cili prej një viti funksiononte si kantier ndërtimi. Tiranën e njihja gjithashtu edhe si Tirana ngjitur me të cilën ishte Kamza. E fundit si një satelit i papërfillshëm tranzit me rrugë të tilla si: Rruga Rejkjavik, Milano, Napoli, Alaska, Bukuresht, OSBE, Bavaria, John. F. Kennedy, NATO dhe Toni Bler. Përpara se të lija Tiranën një ditë ose kur ëndërroja për jetën jashtë kufijve shtetërorë, mendoja se hapësira pas tyre do të ishte e tillë, me emra të plotë edhe tërheqës.

\*\*\*

Kohët e fundit kur kaloja në Konstablerwache për të marrë metronë U7, më kujtohej aroma e pashmangshme e pishave të largëta, peshqirëve të tharë të bërë kore prej diellit, me erë të rëndë detergjenti dhe krem dielli të skaduar përzier me aromë kamerdaresh të sapoblera. Në ndryshim me aromën e quajtur "herët në mëngjes në plazh", Konstablerwache është akoma bosh, sipër në kuadratin e gurtë, por nëntokë në B-Ebene kanë filluar të shiten fruta: qersh, mango, banane. Tre njerëz me maska presin në radhë për të blerë kafe takeaway.

\*\*\*

Me prindërit kur niseshim herët për në jug, gjithmonë duhet të kontrollojmë disa herë bagazhet. Babai im duhet të kontrollonte gjithmonë nëse kishte paketuar syzet e diellit, mamaja ime paketonte dhe dy kremëra të tjerë dhe disa libra me vete, vëllai im do të paketonte syze nënujore, por nga ato që nuk kishin mbrojtës për hundën, të cilat çdo verë do harroheshin në ndonjë shpellë a gropë gurësh në jug. Unë tashmë pas disa vitesh nuk më kujtohet më se çfarë merrja me vete, por vetëm se ishte herët, makina ishte bërë gati dhe për pak do të ndihej aroma e pashmangshme e pishave të largëta, peshqirëve të tharë të bërë kore prej diellit me erë të rëndë detergjenti dhe krem dielli të skaduar, përzier me aromë kamerdaresh të sapoblera.

Në brigjet jugore të Shqipërisë do të shkonim gjithmonë në Borsh, një fshat i vogël pamjen e të cilit e lidhja gjithmonë me skelete betoni të papërfunduara brenda kornizave ullishtore, qenë të egër që lehnin në mesnatë dhe lopë e dele të cilat shpesh herë pasditeve i shihje afër çadrave prej kashte ku pushonin plazhistët. Në Jugun e Shqipërisë ekzistonte një Shqipëri me lokale e bare si: Beach Boomerang Bar, Paradise, Oasis Bar, madje ndonjëherë edhe Havana, por gjithashtu edhe Shqipëria Jugore e lokaleve me emra si: Noli, Adriatik, Jon, Pirro, Skela edhe emra të një kategorie tjetër. Këta të fundit ishin një relike e një tjetër kohe, një kohë në të cilën emrat perëndimorë ishin të ndaluar edhe fjalë të mirëfillta të gjuhës shqipe do të ishin të modës.

Kohë kjo e emrave si Tomorr, Lule, Lumtur apo Ylli, por mbi të gjitha koha në të cilën njerëzit ëndërronin të ndaluarën. Ende nuk do të dinin se një ditë në afërsi të Tiranës, do të blinin kokoshka në rrugën "Demokracia", mandarina në rrugën "Vodafone" edhe xhinse në bulevardin "Donald J. Trump". Prindërit e mi kishin vendosur atëherë të quanin vëllain tim Jon, ashtu si deti Jon. Për

detin flitej shpesh. Babai im tregonte sesi me një gomone të vogël me disa vetë të tjerë, pat kaluar Adriatikon e errët natën drejt Italisë. E kujtoj sesi do të ma tregonte shpesh historinë, sa herë do të shihte sipërfaqen e errët e cila ndriçohet vetëm nga hëna natën. Për në Greqi, do të detyroheshin të kalonin disa herë malet.

Me malet lidhja Shqipërinë e malësorëve edhe shtojzovalleve, ama kufijtë nuk kisha arritur t'i perceptoja mirë. Kufijtë misteriozë i lidhja me vija të bardha avionësh që fluturonin larg, reflektuar si figura në tokë e orë të tëra kontrollesh pasaportash, radhë pritjeje në ambasadë, kufij emocionalë, të cilët perceptoheshin vetëm kur më në fund u largova dhe unë. Si fëmijë emigracioni i shëmbëllente një misteri të vërtetë. Pyesja veten shpesh herë, se përse çdo familje shqiptare mbarte grimca emigracioni dhe në sallon pritjesh do të kishte gjithmonë foto të fëmijëve vendosur mbi çentro të bardha mbi televizor: fëmijë të emigracionit.


Dikur madje - madje, i pata lidhur këto figura me fantazma, njerëz të familjes të cilët për shumë vite nuk i kisha njohur por ishin prezentë në shtëpitë tona. Daja G., tashmë i quajtur Kostandinos jeton prej disa vitesh në Athinë. Daja E. jeton në Romë edhe ishte i vetmi nga familja, i cili me një mundësi të ligjshme, siç do të ishte të studiuarit, u largua. Ligji i më të fortit zbatohet: fantazma më e mirë ishte ajo që nuk kthehej pas ose nëse ishte larguar ilegalisht, nuk zbulohet. Izolimim e lidhja me Tiranën e Komunistit, një Tiranë që nuk e njihja vetë, por e cila gjendej gjithashtu si hije në figurën e qytetit, personalitetin e saj dhe paranjojen kolektive të një populli që akoma mbante mend dhe shtypte kujtime të tjera.

\*\*\*

Na ishte njëherë Tirana me një Teatër Kombëtar, Hotel Dajtin, prej disa vitesh të boshatisur, ish-ambasadën jugosllave në Rrugën e Durrësit, Piramidën që gjithashtu para disa vitesh diskutonin ta shembnin, Kinostudion, Kafe Flora dhe dikur kioskat e shumta në brigjet e Lanës. Tirana me Sheshin Skënderbej si kantier ndërtimi vitin kur lashë Tiranën akoma me një Teatër Kombëtar, atëherë kur u largova të nisja studimet në Gjermani. Në Berlin kisha miq të cilët më flisnin për festa, për drogë, për Kreuzberg, Späties, dyqane Döneri edhe muze të shumta. Dekadencën në Tiranë e lidhja me shkatërrimin, me moralin, me bipolaritetin e një qyteti me shumë fytyra. Më të vjetrit tregonin sesi kishin rrezuar bustin e Enver Hoxhës në protestat studentore, mamaja më tregonte, shumë e bënin prej hidhërimit e të tjerë nga frika se jo-hidhërimi mund të ishte i rrezikshëm. Sot tregohen më shpesh histori të tilla. Shumë patën ndaluar së kujtuari. Askush nuk kishte më kohë të mendonte mbi të shkuarën e parëndësishme. Të vjetrit luanin domino në parqe a në stolat e lagjes, prindërit shkolin në punë, fëmijët filluan të merrnin smartphone dhuratë dhe ne si adoleshentët pinim përzierje pijesh me raki.

\*\*\*

Pllaka e parë e bardhë e gurit në ndërtesën e Operës është vendosur nga Nikita Khrushchev. Biblioteka Kombëtare me aromën e veçantë të dyshemesë prej druri, kartelave të vjetra, gazetave të vyshkura dhe solucionit larës, është përbri. Një vit pasi isha larguar, më kishin treguar sesi kishte rënë zjarr e një pjesë e madhe e librave ishte djegur. Mbi



Pallatin e Operës, në tarracën e gjerë ishte krijuar një bar "trendy" me platformë të madhe rrethore si hënë që ndriçonte mbrëmjeve në skenë, qiell i ngrohtë, cocktaile me raki, muzike e mirë elektronike e ndenjës të vjetra kinemaje në të cilën fundosesh në ulje, skeleti i metalit e të cilave kërciste lehtë ndër biseda. Pata takuar një grup të rinjsh nga Berlini pasi dëgjova gjermanisht, të cilët më pyetën vetëm dy gjëra: "Në doja edhe unë ekstazi?" edhe "Pse drejtin jetoja në Darmstadt?". Përgjigjem se është rastësi që jetoj në Darmstadt. Në fillim nuk e dija ku gjendej në hartë. Në Google Maps shoh se në Tiranë katrorët e kantierëve të ndërtimit, janë shtuar, thua se ishin elemente të një fushe shahu. Disa nga ndërtesat që kam adhuruar janë shembur.

\*\*\*

Mamaja më tregonte gjithmonë histori të shumta për njerëzit e persekutuar gjatë komunizmit të cilët njihje, radioja me muzike italiane e cila dëgjohej fshehurazi, historia e Teze Y. e cila donte të bëhej këngëtare operash para se të largohej për në Greqi, ku edhe e pati harruar gjuhën. Frika ime më e madhe ishte të harruarit. Më kishte mbetur në mend, ashtu si një rrëfim zhytur brenda trupit tim, thua ishin duart e statujave të Giacomettit që kërkonin të futeshin brenda meje. Pamjet e kinemasë në mendjen time shkëmbehesh shpejt e lëvizin shpejt e më shpejt. "Pushtimi" i ambasadës gjermane, Korrik 1990. Anija Flora me njëzet mijë shqiptarë drejt Italisë, 1991. Kaos, 1997, thua anarki në Shqipëri.

Kishin filluar të flisnin se Teatrën Kombëtar do e shembnin. Në fillim vërtitej vërdallë në rrjetet sociale si një legjendë urbane fantazmagorike, shpërndarë në facebook së bashku me shkrime që e dokumentonin. Akoma s'kishte ndodhur gjë. Marr vesh vetëm në një mëngjes, një javë më vonë, prej mesazheve të një mikeje prej Tiranës, që gjithashtu jetonte në Gjermani. Ekranin e vogël i celularit ndriçonte: "E KANË! E KANË VRARË TEATRIN NATËN!" m'ekziston gjithashtu një shprehje në shqip "Të vret natën e të qan ditën".

E diel, 17 maj 2020. Lexoj në Taz.de: „Schock in Albanien. Am frühen Sonntagmorgen kamen die Polizei und die Bagger: Der Abriss des Nationaltheaters in Tirana begann. Protestierende Mängjesi i të hënës ishte si një mëngjes i gabuar. Dy feta buke të thata bërë kore

në pjatë, kafe me qumësht jo të shkuar mirë. Disa përpjekje për të pushuar së qari e së pari të të njëjtës video. Tetëdhjetë e një vite histori, të hedhura në asfalt të ftohtë bashkë me ëndrra politike. Përpjekja t'i tregojta E. se nuk ishte hera e parë që ndodhte diçka e tillë dhe nuk do të ishte as e fundit.

"Çdo gjë mund të ndodhë, jetojmë në Tiranë", qesh kryebashkiaku i atëherëshëm, basketbollist, artist i dikurshëm, njëri që pati ngjyrosur muret e parafabrikateve në Tiranë, tashmë kryeministër i Shqipërisë. Së bashku me çunat e grupit Hip-Hop "West Side Family" këndonte në vitet 2000 për Tiranën, qytetin tonë kaotik. Si fëmijë e adhuroja atë këngë. Më pat mbetur thellë në kujtime. Në gjimnaz mendoja: Tirana vjen prej "Tiran". Një qytet tiran: Zhurmë, shumë zhurmë sa zhurmë.


Kjo është Tirana jonë, Tirana e kontradiktës, E luftës e paqes, E errësirës dhe e dritës, Mashtrimit të vërtetës Shpifjes, interesit, E qejfit dhe e stresit, E ahengut dhe biznesit.

Dredh një cigare. Sytë e mi janë të kuq, si atëherë kur zhytesha në ujin e pastër kristal të detit Jon për të gjetur guaska a yje deti. Shija kishte mbetur e njëjtë: e njihja kripën, por hidhësia ishte e re. Pyesja veten nëse prindërit e mi ishin atje, mes valëve të njerëzve që protestonin. Më kthejnë përgjigje shumë orë më vonë. Im atë më tregon se mamaja ime kishte qenë atje. Mamaja, me zërin sfumuar pas lidhjes së keqe telefonike, rrëfente se ishte shumë mirë që nuk do mund të isha atje. "Veç do ishte mërzhitur. Rri aty ku je!"

Na ishte njëherë Tirana me një Teatër Kombëtar, vila të vjetra të ndërtuar nga italianët që të binin në sy gjatë shetitjeve me biçikletë të cilat më kujtoheshin. Që prej kohës që jam larguar, është luftuar e protestuar për Teatrën e ai prapë nuk është më. Disa flasin për korrupsionin, për demokracinë jo-funksionale, për emigrimin, për një teatër të ri, mbi mbetjet e të vjetrit, për një Shopping-Center a gjashtë kulla që do të ndërtohen afër, për kulla të reja në Sheshin Skënderbej. Shoh prej ekranit të vogël të celularit një livestream. Lajmet i lexoj më vonë, por njoh fytyrën e një mikut tim R. në një nga videot, në krahët e gjashtë policëve. Njerëzit e ri bërtasin, disa gazetarë qajnë. Largesa më thyen, siç thyhen dallgët brenda meje.



# Charles Bukowski



## URIA

kam qenë i uritur shumë herë  
por kjo për të cilën e kam fjalën  
tash  
ka qenë në Nju-Jork Siti,  
nata po ia fillonte  
e unë qëndroja përpara  
vitrinës me fletë xhami të  
një restoranti.  
e në atë vitrinë  
ishte një derr i pjekur,  
pa sy,  
me një mollë në gojë.  
derr i mallkuar e i shkretë.  
unë i mallkuar e i shkretë.  
përtej derrit  
aty brenda  
njerëzit  
rrinin në tavolina  
bisedonin, hanin, pinin.  
unë nuk isha njëri prej atyre njerëzve.  
ndjeva një ngjashmëri me derrin.  
neve na kanë zënë në vend të  
gabuar  
e në kohë të  
gabuar.  
e paramendoja veten në vitrinë,  
pa sy, të pjekur, me mollë në  
gojë.  
kjo do ta afronte turmën.  
"hej, s'paska pasur vithe fare!"  
"duart i paska tepër thatane!"  
"mund t'ia shoh brinjët!"  
u largova nga vitrina.  
shkova në dhomën time.  
ende kisha dhomë.  
derisa shkoja te dhoma ime  
fillova të hamendësoj:  
do të mund të haja pak letër?  
pak gazeta?  
bumballa?  
mbase do të mund ta zija ndonjë mi?  
mi të gjallë.  
t'ia rrjep lëkurën,  
t'ia heq të përbrendshmet.  
t'ia heq sytë.  
të heq ngapak nga koka, bishti.

jo, ngase do të vdisja nga  
ndonjë sëmundje e tmerrshme minjsh!

vazhdova të ecja.  
isha aq shumë i uritur saqë çdo gjë  
dukej e ngrënëshme:  
njerëzit, hidrantët, asfalti,  
orët e dorës...  
ripi im, këmisha ime.

u futa në ndërtesë dhe  
ngjita shkallët për në dhomën  
time.

u ula në karrige.  
nuk e ndeza dritën.  
u ula aty dhe pyesja veten se mos jam  
i krisur  
ngase nuk bëja gjë  
që t'ia dilja në ndihmë vetes.

atëherë më pushoi uria  
e unë sall rrija aty.  
e në atë çast e dëgjova:  
dy njerëz në dhomën fqinje,  
kopulonin,  
mund t'ia dëgjoja sustat e krevatit  
dhe ofshamat.

u çova, dola nga  
dhoma e u ktheva në  
rrugë.  
por kësaj radhe ecja në drejtim  
tjetër,  
ecja larg derrit  
të vitrinës.  
por mendoja në derr  
dhe vendosa se më parë do të vdisja  
se të haja atë  
derr.

ia pat filluar të binte shi.  
shikova lart.  
e hapa gojën dhe i lashë do pika  
shiu të futen... supë nga qielli...

"hej, shikoje atë dai!"  
dëgjova dikë të thoshte.

bij bushtrë të budallallosur, mendoja,  
bij bushtrë të buda-  
llosur!

e mbylla gojën dhe vazhdova të  
ecja.

## NJU-JORK, NJU-JORK

ai ishte në telefonin e korridorit  
duke thënë, "e dashur, nëse nuk më  
kthehesh, do të vras  
veten!  
po të betohem!"

e kalova rrugës për  
në dhomën time, e cila gjendej  
lart.  
ai ishte poet fqinj.  
mbante një shall mëndafshi, dhe  
beretë,  
mbante mjekëz çjapi dhe  
bishtkali.

ishte 9 në mëngjes  
ama veç isha  
i lodhur.  
u ngjita në dhomën time  
dhe u shtriva në  
shtrat.

aty ishte një njeri që donte  
të vriste veten po qe se  
femra e braktiste.  
s'kisha pasur femër  
se tri vjet dhe  
isha  
24 vjeç.

kujtoja, diçka nuk po më  
përputhet këtu.  
atëherë u çova nga shtrati,  
shkova deri te komodina  
dhe e çela një shishe  
verë.  
e mbusha një gotë  
përplot.  
e piva,  
e lashë mënjanë shishen,  
shkova deri te  
dera, e kyça dhe dola  
dhe  
u lëshova teposhtë  
shkallëve.

ai njeriu më s'ishte  
aty.

Qëndroja dhe shikoja  
telefonin.

dola prapë në  
rrugë.  
ishte përplot  
derisa njerëzit shëtisnin  
poshtë e  
lart.

zgjodha një drejtim  
dhe ecja në atë  
drejtim.  
u futa në barin e parë  
që hasa,  
u ula,  
porosita birrë,  
piva një gllënjë  
dhe befaz më ra  
ndër mend:  
ai njeri nuk ka folur  
me askë  
në telefon.  
nuk e di si e  
dija këtë  
ama e  
dija.

qen bir qeni,  
kujtoja, më duhet të  
ikja nga Greenwich Village  
para se të bëhem si  
ai!

dhe ika.

## FILL I VETËM NATËN E KËRSHËNDEL- LAVE

fill i vetëm, natën e kërshëndellave  
në dhomë moteli  
bri bregdetit  
buzë pacifikut -  
a e dëgjoni?

u përpoqën ta rregullojnë këtë vend  
si spanjollët, këtu janë  
tapiceritë dhe llambat, edhe  
nevojtorja është e pastër, kanë edhe  
toptha të vockël sapuni të  
trëndafilte.

këtu s'do të na  
gjejnë:  
barakudat a damat a  
idhujtarët e  
idhullit.

atje në qytet  
janë të dehur dhe të frikësuar  
ngarendin nëpër dritën e kuqe të sema-  
forit  
i thyejn kokat  
në lavdi të ditëlindjes së  
Krishtit. fort mirë.

së shpejti do ta thaj këtë shishe  
rumi portorikan.  
në mëngjes do të vjell dhe do  
të bëj dush, do të kthehem  
mbrapa, do të ha një sanduiç rreth orës  
1 pasdite,  
do të kthehem në dhomë deri në  
2,  
do të shtrihem në krevat  
duke pritur që të cingërojë telefoni,  
por s'do të lajmërohem,  
festa më është  
shmangie, arsyetim  
jo.

**Përktheu: Fadil Bajraj**



Në veten e parë

# MUND TË JETOJA EDHE NË ANËN TJETËR TË MURIT

Unë jam plotësisht i bindur se dikur i gjithë arti do të zhduket. Por piktori do të mbetet dhe jeta nuk do të jetë "fushë e artit", por vetë arti, pasi të ketë zëvendësuar vendosmërisht një herë e përgjithmonë me vetveten, atë që i përket artit


Henry MILLER

Për mua kanë thënë se jam revolucionar, por nëse është kështu kjo ka ndodhur jashtë vullnetit tim. Unë nuk ngrihem kundër botës ekzistuese. Vetem time mund ta karakterizoj me fjalët e Blez Sandrarit: "Unë revolucionarizoj". Por kjo nuk është e njëjta gjë me qenien revolucionar. Unë do të mund të jetoja edhe në anën tjetër të murit, që ndan pozitiven me negativin. Në përgjithësi më duket se jam ngritur mbi ndarje të tilla dhe po krijoj njëfarë harmonie të këtyre dy fillimeve, të shprehur në mënyrë plastike, por jo në kategoritë e etikës, të asaj që shkruaj. Mendoj se është e domosdoshme që të qëndrosh jashtë sferës së artit dhe jashtë ndikimit të tij. Arti është vetëm një nga mënyrat e jetës, kurse jeta është më bujare se ai. Dhe në vetvete arti nuk është jetë që e tejkalon jetën e zakonshme. Ai vetëm sa tregon rrugën, por këtë gjë shpeshherë nuk e kuptojnë jo vetëm spektatorët, por as vetë piktori. Duke u bërë qëllim, ai e tradhton vetveten. Kurse piktorët më shpesh e tradhtojnë jetën me përpjekjet e tyre për të dalë mbi të. Ata e copëtojnë atë, që duhet të jetë një e tërë, si një vezë.

Unë jam plotësisht i bindur se dikur i gjithë arti do të zhduket. Por piktori do të mbetet dhe jeta nuk do të jetë "fushë e artit", por vetë

arti, pasi të ketë zëvendësuar vendosmërisht një herë e përgjithmonë me vetveten, atë që i përket artit. Duke folur për thelbin, natyrisht që ne akoma nuk kemi filluar të jetojmë. Tashmë nuk jemi më kafshë, por, pa dyshim, akoma nuk jemi bërë njerëz. Që nga koha kur ka lindur arti, këtë gjë na e ka pohuar çdo piktor i madh, fare pak ishin ata që e kuptonin atë. Sapo arti fiton njohje të vërtetë, ai zhduket. Ai është vetëm një zëvendësim, një gjuhë simbolesh, nëpërmjet të cilit rikrijohet ajo që ne nuk jemi në gjendje ta shprehim drejtpërsëdrejti. Por që të kryhet kjo, duhet që njeriu të bëhet me të vërtetë fetar: jo besimtar i një sekti, por në të vërtetë një bartës i fesë, i Zotit të vërtetë, pa asnjë lloj metafore. Dhe, në fund të fundit, ai do të bëhet pashmangësisht i tillë. Por nga të gjitha shtigjet, të cilat e nxjerrin në rrugën kryesore, arti është më i rëndësishëm, i hapur në drejtimin më të besueshëm dhe më shumë se të tjerët ia shpërblen udhëtarit.


Piktori, i cili me të vërtetë e ka kuptuar misionin e vet, për këtë arsye pushon së qeni piktor. Dhe të gjithë anojnë drejt faktit se duhet të arrihet ky kuptim, kjo shkëndijë që arrin të ndriçojë vetëdijen tonë, se në jetën e sotme, duke përfshirë madje dhe artin, asgjë nuk është e aftë që të lulëzojë.



Fjala e shkrimtarit

## MEGJITHATË, NA PËLQEN TË MASHTROHEMI

Ka popuj në botë që rrojnë nëpër pyje, nuk kanë ligje, hanë morrat e tyre, por e duan lirinë. Këta ne i quajmë barbarë. Kurse ne, që rrojmë në qytetin më të bukur, që kemi Ligjin më të urtë në botë, nuk hamë morra, por megjithatë i duam mashtuesit e maskarenjtë, që na rrjepin përditë



Kostas VARNALIS

Trupi im (kockat e kërmat) nuk barazohen në kandin e drejtësisë me të njëmijë e pesëqind vetat që u vranë prej tiranëve. Por ajo që rëndon më tepër është emri dhe shpirti im! Edhe sikur të viheshit ju të gjithë bashkë me të njëqind brezat e ardhshëm në njërin anë të peshores, propë ajo do të anonte nga ana ime. Mbas disa vjetësh do të dalin shumë dishepuj të mi, por edhe mohues, edhe këtej nga ky qytet, edhe nga vende të huaja, edhe bashkëkohës, edhe nga brezat e ardhshëm, të cilët do të bëjnë një zhurmë të madhe rreth vdekjes sime. Do të më quajnë si "njeriun më të mirë midis grekëve", "bilbilin e

Muzave"; do thonë se kam qenë "njeriu më i drejtë e më i urtë", "stolia e Greqisë". Djemtë tuaj do të ndërtojnë për mua një tempull, që do të marrë emrin e Sokratit, dhe çdo vit në pranverë do të bëjnë kurbanë për kujtimin tim... Do të më bëjnë perëndi e do të falen në emrin tim, megjithëse ju nuk më lejuat të mbaja asnjë gram nga "demoni". E përse do të bëhen të gjitha këto? Të parët do të kenë qëllim të përfitojnë nga emri im, të ngjitin emrin e tyre pranë timit dhe, bashkë me mua, të fitojnë famë e lavdi. Kurse të dytët do të duan të tregojnë se, po të jetoja në kohën e tyre, do të më kuptonin e do të më nderonin... Punë boshe! Që të dy palët do të më ngrenë më lart nga sa vlen me të vërtetë lëkura ime dhe do të bëjnë një padrejtësi karshi jush. Do të përhapin gënjeshtër dhe do të besojnë në gënjeshtër. Ju dhe ligji juaj kenë kryer detyrën tuaj. Por të merremi vesh. Ju nuk më dënuat sepse kam shkelur Ligjin, por sepse u tregova i paafët të shkelja mbi të e të kaloja më tutje... E dini si duhet të ishte formuluar akuzat kundër meje? Jua them unë, dëgjoni: "Sokrati është fajtor, mbasi ka qenë i pafuqishëm e njeri fukara. Prandaj të dënohet me vdekje."

Po të më kishit gjykuar veças e një e nga një, me siguri që do të më kishit nxjerrë të pafajshëm. Tani që jeni kaq shumë, nuk mundeni. Sa më tepër njerëz si ju të bashkohen midis tyre e të përbëjnë një turmë, aq më tepër humbasin gjykimin dhe shtojnë ligësinë. Edhe sikur të ishit bash-

kuar pesëqind të mençur të zgjedhur (të themi pesëqind Sokratë), nuk do të vlenit as sa gjysma e një budallai. Pa mendoni tani që jeni grumbulluar pesëqind budallenj me brirë! Turma, opinioni publik nuk është tjetër veçse një qen i zgjebosur, i lidhur me një hu në mes të diellit. Ky qen gjithë ditën fle, kruan zgjeben dhe vërsulet i tërbuar kundër çdo njeriu që orvatet ta shpëtojë nga veset e t'i zgjidhë zinxhirin, me të cilin është i lidhur. Ashtu edhe ju, menjëherë sapo nisën të më akuzonin se po prish Fenë, djemtë e arsyen, brofët përnjëherësh më këmbë dhe hapët gojën sa një kamare që të më përpinit të gjallë. Po të gllabëroja gjëra të ndezura flakë, thika e shpata, siç bëjnë fakirët nëpër panairë, nuk do të çuditeshit as dhe një grimë, pse do të shikonit me sy të mbyllur se me të vërtetë po gllabëroj shpata, thika e flakë. Dhe, po të isha ndonjë fallxhor që do t'ju jepja për shërim bajga e shurrë sa të ngopeshit, atëherë do të besonit se ju kam shpëtuar jetën. Sigurisht, do të më kuptonit e do të më paguanit. Por e vërtetë është se kushe-di sa herë më keni dëgjuar duke thënë "Unë di një gjë që s'di gjë fare!" Nuk di gjëkafshë... këtë s'e kuptonit dot. Atëherë unë jam padyshim drejt vetë. Dhe nga një njeri i tillë mund të pritët çdo gjë.

Si, si? Kam qenë i rrezikshëm për Republikën! Unë i rrezikshëm, dhe ju Republika vetë. Por njerëzit e rrezikshëm, o qytetarë të Athinës, nuk i gjykojnë. Këtyre njerëzve

ose u puthin këmbët me servilizëm, ose i vrasin pabesisht. Dhe gjithë ata, që populli i do dhe që mund të bëhen një ditë të rrezikshëm, ju bëni çmos dhe arrini t'i syrgjynosni pa një pa dy. Po të isha i rrezikshëm, do të kishit paguar dy-tre njerëz të afionizuar që të më thernin me thikë, ose do t'u jepnit ryshfet akçinjve të shtëpisë sime që të më hidhnin helm në gjellë, në verë apo në kafe. Një njeri i rrezikshëm as që gjykohej dhe as që ka nevojë të bëjë apologji. Ai fiton pozitën, gjykon të tjerët dhe i dënon me vdekje, për arsye se mban pushtetin në dorë. Dhe vetëm po të humbasë pushtetin, atëherë mundet që ju ta vini në bankën e të akuzuarve, po që se do të guxonit... e po që se do të arrini ta shtini në dorë.

Jo, pra! Ju nuk u frikësuar nga Sokrati, por me vdekjen time kërkoni të frikësoni të tjerët. Republikës suaj po i rrëshqet toka nën këmbë... Kurse vegjëlja rri në mes dhe paguan dëmet. Ajo njëlloj vuan edhe nën regjimet legale, edhe nën ato ilegale, edhe kur pushteti quhet tirani, edhe kur quhet demokraci. Dhe që të mos kuptojë e të mos rezistojë, e hutoni me gënjeshtër dhe e terrorizoni. Ka popuj në botë që rrojnë nëpër pyje, nuk kanë ligje, hanë morrat e tyre, por e duan lirinë. Këta ne i quajmë barbarë. Kurse ne, që rrojmë në qytetin më të bukur, që kemi Ligjin më të urtë në botë, nuk hamë morra, por megjithatë i duam mashtuesit e maskarenjtë, që na rrjepin përditë.



# NË BURGUN E MENDJES ASKUSH NUK E DI SA ËSHTË ORA!

(Mbi shfaqjen e Teatrit Kombëtar të Kosovës, "1984" të George Orwell. Regjia Igor Mendjisky. Luajnë: Adrian Morina, Arta Selimi, Basri Lushtaku, Edona Reshitaj, Flaka Latifi, Shpëtim Kastrati, Xhejlane Godanci, Ylber Bardhi)



**Nga: Agron Gërguri**

Hija e stalinizmit, së cilës iu ka frikuar Orwell a po na kërcnon edhe sot me shenjat "premtuese" që diçka e tillë të aplikohet tek ne. Fundja, pse do duhej inskenuar këtë tekst nëse hija e atij rreziku nuk është, hajti po themi, mbi Ballkanin ku mentaliteti i turmës shpesh është kriter për të drejtën e sundimit që emërtohet qeverisje. Më e keqja është se duke shtuar dozën e veprimeve "për inat të nuses më vdektë djali" po dëgjojmë thirrje-konstatime "mirë e ka pas Enveri" si deshprim-zhënjim që do të thotë se ne nuk marrim vesh ndryshe, përveçse forcës e cila, siç ka thënë Noli, duhet ta shoqërojë të vërtetën. Dhe për të kapur frikën instalohet një sistemi i vëzhgimit, i cili vigjilon përhershëm përmes gënjeshtërisë si "ministreshë", e cila kujdeset që të gjitha të vërtetat të pajtohen me versionin zyrtar të partisë, vëllait të madh apo babës.

Gjithandej e këndej po i vjen era sundim e jo qeverisje, një mentaliteti i cili ka predispozita që edhe demokracinë ta pronësojë apo trajtojë vetëm si aplikacion për ushtrimin e pushtetit. Ballkani ynë i trazuar gëlon nga këto tendenca, të cilat në planin evropian e botëror janë mbuluar me saçin e globalizmit që do të thotë heqje dorë nga veçantitë individuale e përbashkëta që identifikohet me konsumin, e ku identitetet kulturore, mbase edhe njerëzore, po shpërfaqen. Derisa autokratëve të vegjël u lihet hapësirë të ushtrojnë pushtet me numra, çështja po bëhet Orwelliane.

Këtë problematikë, përafërsisht e tematizoi shfaqja "1984", sipas George Orwellit, në regji të regjisorit francez, Igor Mendjisky, realizuar në Teatrin Kombëtar të Kosovës, duke e akcentuar marrëdhënien dashurore e cila kontrollohet nga pushteti. Gjethet vjeshtore nëpër skenë apo stina e vjeljeve nga policia e mendimit për t'i shtrydh e ndrydhë derisa t'ua nxjerrë "tamlin e nanës" të gjithë atyre që të vërtetën duanë ta prekin e nuk kanë vesh ta

dëgjojnë çka thotë altoparlanti i pushtetit. Narratori (Adrian Mprina) si një deus machina, në shfaqje karakterizonte fuqinë e vëllait të madh, i cili po instalonte një pushtet ku liria është skllavëri, lufta është paqe e padituria fuqi!

Personazhi i Winstonit (në interpretim të angazhuar të Ylber Bardhit) gjendet midis dashurisë dhe partisë, sikur midis të vërtetës dhe pushtetit, aty ndihet i humbur pavarësisht se dashuria i duket rruga e duhur për atje ku dëshiron të shkojë, edhe pse nuk e dimë a do vërtetë të dalë diku apo thjeshtë të jetojë, e ky fakt pastaj e bën situatën edhe më dramatike kur kupton se pushteti po ngrre sistemin që do të kontrollojë njeriun, përkatësisht njerëzoren, duke instrumentalizuar (lexo industrializuar) edhe dashurinë në funksion të arritjes së kontrollit. Për ta arritur këtë qëllim, faza e populizmit është aleat, siç është krijimi i fjalorit të ri të thjeshtëzuar deri në fjalë që janë urdhra të pushtetarit dhe pohime nënshtruese të masës. Kur dashuria e Winstonit me Julian (Flaka Latifi) bëhet argument i jetës së tyre të dëshiruar, partia nxjerr antidopingun shantazhues se Julia ka bërë dashuri me shumë anëtarë të partisë, sepse ajo nuk dashuron, por thjeshtë e adhuron artin e të bërit dashuri. Duke e trajtuar dashurinë si industri të prodhimit të kënaqësisë mashtruese, partia me syrin vëzhgues nga studio e big brother e shndërron atë në akt politik apo metodë politike të kontrollit.

Në dilemën a mjafton të jemi gjallë apo duhet të jemi njerëz, Julia e heq kostumin e partisë, sepse e do dashurinë si prodhim ndjenjash e jo urdhër partie. Po ku të lë partia të jesh vetvetja. Ajo jo vetëm që shfrytëzon të gjitha vrimat e zëza në biografine e anëtarëve, por edhe i krijon ato ngase nuk lejon ëmbëlsimin e jetës së askujt, përkundrazi ua vjedh edhe kujtimet.

**Errësira e errësirës dhe mendja intelektuale**

Urdhret duhet zbatuar pa pyetur pse. Të

lidhur përmes idesë së pashkatërrueshme të dashurisë për një të ardhme që ndoshta nuk vije kurrë. Policia e mendimit interferon vazhdimisht duke sajuar dosje të zëza me premisa ideologjike që depërtojnë thellë në sferat më të errëta të territ, që pastaj me vetëm një shkrepje drite të fitojnë respektin shpëtimtar. Në shfaqje herë - herë si marrëdhënie transcendentale inkuadrohet autori si qenie intelektuale e munguar (lexo frikësuar), që do duhej të denoncojë një gënjeshtëri përmes shkrimit. Akti i shkrimit bëhet subjekt që për pushtetin totalitar konsiderohet rrezik dhe kështu instalohet auto-censura si një burgim i mendjes, ku askush nuk e di sa është ora. Pyetja që bëhet çështje, është çka do të bëjnë pushtetarët kur të ngopen me pushtet, nëse ngopen, pasi që proleve (proletarëve) dje, e elektoratit sot, do t'ju kenë shkatërruar unin për t'i shpëtuar nga vetvetja, siç proklamoi ministria e dashurisë, "do t'ju zbrazim e do t'ju mbushim siç duam", thonë ata, duke pasur qëllim pronësimin e të vërtetës, në instancë të fundit kontrollin mbi masat duke e pezulluar edhe Zotin.

Referencialisht sot po jetojmë në ambientin e këtyre tendencave. Qeverisja po përkthehet në sundim të kulluar, ku turma e unifikuar njëmendimshme me vrull thuaja inertiv e përqafon gënjeshtërinë, e cila në kuzhinën e politikës transformohet në të vërtetë dhe bëhet pronë e pushtetit.

**Estetika e idiomave teatrore apo bretkosa në ujën që ngrohet suksesivisht**

Gjuha teatrore e shfaqjes është përdorur herë - herë me sens tejet estetik, siç ishte skena e torturimit, kur torturuesi i ministrisë së dashurisë, në vend të dhunës fizike agresive, thjeshtë e përlyen personazhin me duar të përgjakura dhe efekti skenik puqet me qëllimin, duke krijuar një idiomë të bukur teatrore. Në përgjithësi temporitmi dhe dinamika e realizimit të skenave është organizuar mirë në funksion të karakterit të

shfaqjes.

Procesi i ngrohjes graduale të ujit derisa bretkosa është aty, tregon mënyrën se si pushteti vepron me Winstonin dhe Julian, të cilët në basenin e ndjenjave ndjehen gjithnjë e më ngrohtë në raport me intensitetin e dashurisë. Kur ajo kulmon, uji tashmë ka vluar dhe dalja bëhet e pamundur dhe kështu pushteti inkason rezultatit mashtrues nga dashuria e djegur.

Ky lloj sistemi partiako-pushtetar, gënjeshtërinë e shndërron në të vërtetë në bazë të qëllimit, duke i shkërrmuar deri në plakje banorët e klasës së ultë - prolet (lexo: fansat, elektoratin) - që do të thotë nënshtrim deri në pikën e topitjes së potencës së mendimit: "kur plakesh, e mira e pleqërisë është se më nuk ke nevojë për gra". Pra, vdes motivi i dashurisë dhe për pasojë demotivohet jeta. Paralajmërim i tmerrshëm që po troket në derën e njerëzore! Karrigia është rekuizitë e patejkalueshme në teatër, por në rastin e shfaqjes "1984" regjisorit e përdor edhe për të miksuar skenat. Zhvendosja e shpesh të mizanskenike e tyre, të jep idenë e mosrahatisë si strategji pushtetit, ku askush nuk ndihet i sigurt të qëndrojë gjatë në një pozitë apo thjeshtë në një vend pune, në një gjendje pasigurie. Përdorimi i video kamerës, video-fotografisë dhe mikrofonëve është në funksion skenik dhe kontribuon në shtruarjen e temës, në theks të së cilës është vëzhgimi permanent i secilit dhe kontrolli i gjithçkasë. Ndriçimi sado i integruar në idenë e shfaqjes, megjithatë në disa skena ku loja është miniaturore, do duhej të kishte volum më të lartë..

**Paralajmërimi i Orwellit, a e ndalon atë që po na kërcënohet!**

Shfaqja të lë një të vërtetë, por assesi nuk të shtynë në veprim, e mbase dikë në reflektim, siç ndodhi në reprizën e dytë, ku dy tre veta, mbase të revoltuar, e lëshuan sallën pa e parë finalen "aplikimin e demokracisë përmes dhunës", si proces i stopimit apo përjashtimit të mendimit

E pushtetet, edhe ato më të buta, këtë punë nënshtruese e bëjnë derisa të edukohet vota apo të shpikët një sistem i ri që e kthen njeriun te vetja. Sepse, aktualisht po merr mot i keq në natyrën njerëzore dhe sa herë që ndodhë kjo, njeriu është humbës. Ndoshta nuk është e rastësishme që produkti i big brother në Shqipëri nxori filmën "Në kuadër të dashurisë", sepse edhe dashurinë dikush po e pronëson për ta dhënë pastaj me recetë pushtetare. Teatri, si gjithë, mundohet të vëmendësojë rrezikun, i cili po na vjen dhe se beteja jetike është si t'i ruajmë thellësitë e zemrës të paprekura nga dhunimi i interesit të pushtetarëve dhe që megjithatë dashuria të triumfojë.

**Akrimi i realizuar**

Akrimi ishte i realizuar, sidomos te personazhet që interpretonin, Ylber Bardhi, Flaka Latifi, Adrian Morina, Gjejlane Godanci, Basri Lushtaku, Shpëtim Kastrati, te të gjithë pa dallim shijë se i ishin dorëzuar konceptit regjisorial dhe loja e tyre e disiplinuar manifestohej me një precizitet estetik në secilin veprim skenik.



NUMRI I ARDHSHEM ME 10 NENTOR

# HEJZA

29 TETOR, 2023

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**

Drejtor: **Genc Halimi** (genc@takat.tv)

Rruga e Kaçanikut nr. 208, Shkup, 1000